Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 3 (119). MARS 2016. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394



Musa Riçku, "Qytetar Nderi" i Dibrës

Tre gëzime në një ditë është e rrallë të ndodhin, por për Musa Riçkun tre të tilla u bashkuan më 20 mars në Tiranë. Familjarë, miq e bashkëpunëtorë të tij u mblodhën në Hotel Tirana për të festuar 60 vjetorin e lindjes, përurimin e monografisë kushtuar tij, si dhe titullin "Qytetar Nderi" dhënë nga Këshilli Bashkiak i Dibrës.

Të pranishëm në veprimtarinë e organizuar nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë ishin deputetët Ulsi Manja, Sherefedin Shehu, Përparim Spahiu dhe Sadri Abazi, kryetari i Bashkisë së Dibrës, Shukri Xhelili, kryetari i Bashkisë së Dibrës së Madhe, Ruzhdi Lata, kryetari i Bashkisë Bulqizë, Melaim Damzi, kryetarja e Këshillit bashkiak Lulzime Dani, prefektja Donika Hyseni, miq e bashkëpunëtorë të Musait në vite, familjarë e bashkëfshatarë, etj...

Njeriu i ndershëm i punës!

Nga **Prof. EDLIRA HAXHIYMERI**
Kryetare e LID

Është kënaqësi për të gjithë ne, të mblidhemi sot këtu së bashku e të ndajmë gëzimin për tre momente të shënuara për Musain, bashkëshorten, fëmijët dhe të afërmit: Përvjetorin e lindjes së Musait, Promovimin e librit kushtuar jetës dhe aktivitetit të tij "Musai – portreti i njeriut fisnik", përgatitur me dashuri e profesionalizëm nga zoti Shaqir Skara, si dhe nderimin që i bëri Musait Këshilli Bashkiak i Dibrës, duke i akorduar titullin e lartë "Qytetar Nderi"

SPECIALE NE FAQET 9-14

aktualitet

E meritojmë Rrugën e Arbrit sado të kushtojë!
FAQE 5

reportazh

Vlesha, katundi që ka bërë emër
NGA prof. **HAJRI SHEHU** - FAQE 6-7

profil

Kaloshët e Kandrrit, një histori suksesi mes traditës dhe punës
NGA **OSMAN XHILI** - FAQE 8

botime

"Ankthi", një libër me shumë vlera
NGA **XHAFER MARTINI** - FAQE 19

"Pas shiut" dhe "Zjarri është blu", dy libra të rinj nga Fatmir Terziu
NGA **LUAN DEDA** - FAQE 20

Vazo të thyera
Tregim nga **ARTAN GJYZEL HASANI** - FAQE 22

REPORTAZH / Çfarë ndodh në fshatin buzë Drinit të Zi, aty ku ujërat e HEC-it Katundi i Ri do t'i përmbytin që ditën e parë të punimeve?

Në Selane, aty ku përmbyten shtëpitë



Katundi i Ri nuk gjendet në Google Map, por kjo lagje e Luznisë, këtij fshati të njohur për alegorinë therëse ne Dibër, ia ka dalë të trazojë jetën e banorëve dhe ambientalistëve në dy krahët e Drinit të Zi. Qeveria shqiptare ka njoftuar hapjen e një tenderi për HEC-in e Katundit të Ri dhe kjo ka ngjallur reagimin e opozitës dhe banorëve në të dy anët e Drinit. Disa anëtarë të shoqërisë civile janë përpjekur të bëjnë disa protesta pa ndikim në organet vendimmarrëse, megjithëse herë pas here kanë pasur edhe mbështetjen e vakët të opozitës. "Katundi i Ri" ia ka arritur që të bashkojë së bashku dy grupime ekstreme, me qëndrime krejtësisht të kundërta përsa i përket hec-eve mbi Drin; atyre që nuk duan asnjë hidrocentral dhe atyre që duan një Skavicë në kuota maksimale, që e përmbyt gjithë luginën e Drinit të Zi.

NGA **BUJAR KAROSHI** - FAQE 2-3

Pse mos **ta mbysim Dibrën** profesor Bunguri?

NGA **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 4

KNAUF
Bashkëpunon me komunitetin
www.knauf.al

cyan magenta yelloë black 1

“Nuk ka ardhur asnjë njeri i qeverisë të na takojë për këtë çështje, që nga administratori lokal, kryetari i bashkisë, deputeti apo njerëz të qeverisë”, - thotë njëri prej tyre. Nuk dimë se çdo bëhet. S’kemi asnjë informacion, asgjë!”, - thonë ata të irrituar.

Posta e Rruga e Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 3 (119). 1 - 31 Mars 2016

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.

Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më **datë 20** të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të rregullt.

Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN “ë”.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:
Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Korrespondentë të përhershëm:
Sashenka NDREKA
Hysen LIKDISHA
Abdurahim ASHIKU

Kontribuan për këtë numër:
Osman XHILI
Hajri SHEHU
Edmond HASANI
Edibe Selimi OSMANI
Xhafer MARTINI
Luan DEDA
Ilmi DERVISHI
Artan GJYZEL HASANI
Emrie SKUKA
Zaim ELEZI
Dionis Xhafa
Edison BALLA
Halil RAMA
Lavderim SHEHU
Bedri TAHIRI

Fotoreporter: Fehmi Lleshi

Falenderojmë z. **Sadik H.Lala** për donacionin e dhënë për botimin e këtij numri të gazetës. Gjithashtu, falenderojmw edhe znj. **Ferzileta Xhika** dhe z. **Defrim Methasani** për kontributin e dhënë në ndihmë të botimit të gazetës.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**
Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.
Pajtimet në gazetë mund t’i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>
Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.
Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t’i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:
Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit
Nr. llog. në lekë: 4700036640
IBAN: AL90202112190000004700036640

Adresa e gazetës:
Rr. “Zenel Baboçi”,
Pall. “Ferar”, Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Nga **BUJAR KAROSHI**

Një vizitë mes njerëzve të izoluar, 7 km larg qytetit të Peshkopisë, që natën flenë me jehonën e ujërave të Drinit, ndërsa ditën jetojnë me lajmet mbi përmbytjet që pritet të ndodhin shumë shpejt

Çfarë ndodh në fshatin buzë Drinit të Zi, aty ku ujërat e HEC-it Katundi i Ri do t’i përmbytin që ditën e parë të punimeve. Jeta në izolim në lagjen pa rrugë, ku dora e shtetit ndjehet vetëm me frikë...



Në foto: Gjuri, Xheladin, Lulzim dhe Nazif Murrja, familjet e të cilëve do të shpërngulen. Shtëpitë e tyre përmbyten nga HEC i Katundit të Ri. Foto: B.Karoshi

Katundi i Ri nuk gjendet në Google Map, por kjo lagje e Luznisë, këtij fshati të njohur për alegorinë therëse ne Dibër, ia ka dalë të trazojë jetën e banorëve dhe ambientalistëve në dy krahët e Drinit të Zi.

Qeveria shqiptare ka njoftuar hapjen e një tenderi për HEC-in e Katundit të Ri dhe kjo ka ngjallur reagimin e opozitës dhe banorëve në të dy anët e Drinit.

Disa anëtarë të shoqërisë civile janë përpjekur të bëjnë disa protesta pa ndikim në organet vendimmarrëse, megjithëse herë pas here kanë pasur edhe mbështetjen e vakët të opozitës. “Katundi i Ri” ia ka arritur që të bashkojë së bashku dy grupime ekstreme, me qëndrime krejtësisht të kundërta përsa i përket hec-eve mbi Drin; atyre që nuk duan asnjë hidrocentral dhe atyre që duan një Skavicë në kuota maksimale, që e përmbyt gjithë luginën e Drinit të Zi.

Për publikun që qëndron me pult në dorë para televizorit apo para profileve të rreme në rrjetet sociale, çështja e hidrocentraleve mbi Drin duket më shumë si mediatike dhe politike, por në të vertëtë, në terren, ndërtimi i HEC-it Katundi i Ri krijon probleme. Studimi i qeverisë i bërë publik nga Ministria e Ekonomisë thotë se nga ndërtimi i HEC-it Katundi i Ri do të shpërngulen 150 persona. Por a është e vërtetë kjo shifër dhe çfarë mendojnë ata që do të shpërngulen?

NË FSHATIN QË ZHDUKET NGA HIDROCENTRALI

Selania është fshati i parë, një pjesë e të cilit do të përmbytet nga Hec-i Katundi i Ri. Fshat është rreth 7 km larg nga qyteti i Peshkopisë. Aty ndodhen 6 shtëpitë e para që do të përmbyten nga ujërat e hidrocentralit dhe për të vajtur te ato familje duhet të ecësh edhe 1-2 km më shumë në këmbë.

Fshati ka aktualisht 55 shtëpi, me rreth 300 banorë. Sapo marrin vesh se një gazetar është në fshat, disa prej banorëve ikin për pak minuta nga një vdekje që ka ndodhur aty. Një shi i lehtë fillon të bjerë dhe banorët hapin një nga klasat e shkollës fillore - të mobiluar shumë keq, ku mblidhen për pak minuta. Banorët janë të shqetësuar dhe këtë e vë re te përpjekja e tyre për të folur. Dhe kur flasin, vetëm nga luhatjet e timbrit të zërit mund të dallosh inatin me qeverinë, ndërsa gjërat që thonë janë pothuajse të njëjta.

“Nuk ka ardhur asnjë njeri i qeverisë të na takojë për këtë çështje, që nga administratori lokal, kryetari i bashkisë, deputeti apo njerëz të qeverisë”, - thotë njëri prej tyre. Nuk dimë se çdo bëhet. S’kemi asnjë informacion, asgjë!”, - thonë ata të irrituar.

“I vetmi informacion janë televizionet dhe gazetat, - thotë një banor i fshatit. - Këtu nuk është bërë asnjë takim. I vetmi takim që duhet të kishte nisur këtu, është zhvilluar në Katund të Ri, katund ku nuk përmbytet asnjë pëllëmbë tokë”, - thotë Gjuri Murrja. Ai është njëri prej gjashtë familjeve që i përmbytet shtëpia dhe toka. “Gjithçka kam”, - thotë ai.

Kur i pyet banorët se sa shtëpi dhe tokë përmbyten, nuk janë në gjendje të thonë një inventar të saktë, por janë në gjendje të përmendin emër për emër se kujt i përmbytet toka dhe kujt shtëpia.

Sipas Xheladin Murrës, një ish mësues, tani në pension, “gjashtë familjeve u përmbyten shtëpitë dhe rreth 20 troje, kryesisht banesa të braktisura, do të përfundojnë nën ujërat e HEC-it Katundi i Ri. Ndërsa më shumë se gjysma e fshatit, rreth 40 familje, preket direkt nga ndërtimi i hidrocentralit, pasi tokat e tyre përmbyten”.

“12 familjeve u përmbyten tokat në mbi 70%, - thotë Xheladini, ndërsa 35 familje nga fisi Murra u përmbyten tërësisht shtëpitë dhe pjesa më e madhe e tokës”.

Fisi Murrja është më i prekuri në këtë fshat. Shëpitë e tyre buzë Drinit shpejt do të bëhen çerdhe për peshqit. Anëtarët e këtij fisi kanë dëgjuar se çfarë kanë ndodhur edhe me të shpërngulurit e Bovillës apo Kukësi, dhe nuk duan që një gjë e tillë të ndodhë edhe me pronat e tyre.

Një shtëpi e vetmuar është si shenjë se deri kur ujërat e liqenit do të vijnë kur hidrocentrali të ndërtohet. Dhe si për t’i shprehur kundërshtinë, hyrja e shtëpisë është nga lindja, duke i kthyer shpinën asaj që do të ndodhë në të ardhmen.

Kur u thua banorëve se shtëpitë e tyre do të bëhen më të bukura në breg të liqenit dhe se turizmi këtyre anëve do të lulëzojë, ata të marrin për të marrë...

TË SHTËPITË QË PRESIN PËRMBYTJEN, MES BANORËVE QË DO TË SHPËRNGULEN

Shtëpitë e pakta që mbyten në Selane janë buzë Drinit. 7-8 shtëpi janë krjtësisht të izoluara nga pjesa tjetër e fshatit. Një rrugë e ndërtuar me punë vullnetare të banorëve është prishur nga reshjet gjatë dimrit, ndërsa një urë e vogël e ndërtuar po vullnetarisht prej tyre ka përfunduar në lumë pas reshjeve të rrëmbyeshme muajin e shkuar. Një urë teli, e ndërtuar në kohën e komunizmit, që lidhte katundin Selane me Hoteshin, fshatin në anën tjetër të Drinit, e kanë prishur vetë banorët.

“Nga ura vinin e na vidhnin”, - thonë shoqëruesit tanë nga fisi Murra; Xheladini, Lulzimi, Nazifi dhe Gjuriu.

Gjuri Murra është njëri nga banorët që me ndërtimin e HEC-it “Katundi i Ri” i duhet të braktisë pasuritë, tokat dhe shtëpitë. “Nuk dua asnjë kompensim”, - thotë ai. Çdo lloj kompensimi nuk ma shlyen pasurinë time, tokën dhe shtëpinë.

Gjuriu, ashtu si shumë banorë të këtyre anëve, të vetmen mjet mbijetese kanë tokën, të cilën e mbjellin kryesisht me jonxhë, misër dhe kohët e fundit me pemëtari. Gjuriu ka mbjellë 3,5 dynim dardha, rreth 330 rrënjë, dy dynym ftonj, rreth 110 rrënjë. Ata i ka në vitin e dytë të prodhimit dhe prej tyre ka mundur të sigurojë rreth 60 mijë lekë të ardhura, që i kanë mjaftuar për të siguruar disa produkte ushqimore bazë për familjen e tij prej gjashtë anëtarësh. Gjuriu ka edhe 60 rrënjë arra në tokat e tij. Ai ka gjithsej 15 dynymë tokë trashëguar prej të parëve, por vetëm 5,5 ka të regjistruar në kadastër. “Gjithashtu, unë kam hapur edhe tokë të re, - thotë ai, - që nuk është e regjistruar askund.

Xheladini ka investuar në frutikulturë. Ai ka një parcelë me mbi 180 rrënjë me qershi. Ka mbi 10 dynymë pemëtore dhe 1 dynym vresht. Pesëmbedhjetë vite më parë e ka nisur investimin në frutikulturë, duke mbjellë mollë. Sot ka mbi 200 rrënjë mollë me kurorë të madhe dhe rreth 300 të tjera vegjetative. Këtë vit ka prodhuar rreth 200 kuintalë, por vetëm 30 kuintalë ka mundur të shesë, kryesisht te të njohur të tij në Tiranë. Pjesa tjetër ose është kablur ose është kthyer në ushqim për bagëtitë.

“Nuk kam marrë ansjëherë asnjë ndihmë nga qeveria për këto investime, - tregon Xheladini. - Kam në shtëpi një dosje gati për të marrë ndihmë nga shteti, por nuk kam mundur të përfitoj nga donacionet”.

Shtëpia e fundit në fshat, ajo e Nazif Murrës, është krejtësisht e izoluar. Ajo është ndërtuar pak metra buzë Drinit, rreth 500 metra nga shtëpia më e afërt e fshatit. Familja e tij është prej katër anëtarësh dhe të vetmen pasuri që kanë është toka rreth shtëpisë, përafërsisht 10 dynymë, megjithëse ai nuk e di saktësisht.

“Nuk e di sa dynym është, por kjo është e vetmja gjë që kam”. Shtëpia e tij është e vendosur përballë kullës mesjetare të shekullit XVII, e cila ka shërbyer si pikë kontrolli e feudalëve të kohës. Rrënojat e kullës i vizitojnë ndonjëherë turistët e vetmuar që i çon aty rrjedha e Drinit, sidomos verës, ku vitet e fundit ka filluar të përdoret sporti i raftingut.

Nazifi ndjehet krejtësisht i pambrojtur. Shteti, i cili duhet ta kishte takuar të parin atë, pasi shtëpia e tij është më afër digës dhe e para që përmbytet, nuk është asgjëkundi. I vetmi që e ruan dhe e mbron është qeni i shtëpisë, me të cilin duhet të jesh shumë i kujdsshëm. Ndërsa ne jemi në oborr, ai leh dhe është gati të këpusë zinxhirët. Nuk ka faj, kurrë nuk ka parë të jenë 6-7 burra në oborrin e tij...

QEVERIA ZHVILLON KONSULTAT ME PUBLIKUN, ATY KU NUK KA PËRMBYTJE

- A jeni të gatshëm ta bisedoni me qeverinë ose investitorin këtë çështje? - i pyes unë?

- Jo, thonë ata me një zë. Ne nuk kemi dalë në shitje!

Megjithëse me fjalë thonë “JO”, ata duket se janë të gatshëm ta bisedojnë me përfaqësues të qeverisë. “Por këtu, thonë, jo në Katund të Ri! Katundi i Ri nuk përmbytet”.

“Përfaqësues të Ministrisë se Energjisë kanë zhvilluar një takim në Katund të Ri, por atje nuk përmbytet asnjë pëllëmbë tokë, - thotë njëri prej anëtarëve të fisit Murrja. - Takimi duhej të ishte bërë këtu, jo atje, megjithatë ne u njoftuam nga shoqata që po mbron të drejtat tona dhe shkuam dhe e thamë zërin tonë në atë takim”.

reportazh

HEC i Katundit të Ri do të ketë një volum prej 12.4 milionë metër kub ujë dhe do të përmbytë mbi 87 hektarë në fshatrat Selane, Hotesh, Gradec, Kovashicë, Topojan e deri në Fushë të Gjoricës.

"Ne kemi thirrur në protestë të gjallë e të vdekur", - thotë me ironi Drizi, por duket se deri më tani vetëm të vdekurit po vijnë, pasi të gjallët janë të frikësuar nga kërcënimet e pushtetit".

Në Selane, aty ku përmbyten shtëpitë

Banorët kanë firmosur edhe një peticion me 160 firma, që ia kanë çuar shoqatës që ka marrë përsipër të mbrojë të drejtat e tyre, e cila nga ana e saj po përgatitet të përballet me qeverinë për ta bindur atë që të mos vazhdojë me projektet hidroenergjetike mbi lumin Drin.

Nazmi Drizi, kryetar i Shoqatës "Për mbrojtjen e Pellgut të Drinit të Zi", thotë se shoqata ka vite që po proteston kundër ndërtimit të Skavicës dhe çdo lloj hidrocentrali mbi Drin. Më 5 mars 2016 ata organizuan një forum të organizatave joqeveritare në Peshkopi dhe kanë vendosur që të protestojnë vazhdimisht kundër HEC-it Katundi i Ri dhe çdo versioni të Skavicës. Por protestat e tyre kanë qenë të vakta dhe me shumë pak njerëz.

"Të shtunën, më 26 mars, në protestën e zhvilluar te Ura e Topojanit, ishin rreth 150 vetë", - thotë Drizi.

"Ne kemi thirrur në protestë të gjallë e të vdekur", - thotë me ironi Drizi, por duket se deri më tani vetëm të vdekurit po vijnë, pasi të gjallët janë të frikësuar nga kërcënimet e pushtetit".

"Protesta e radhës është parashikuar të dielën e parë të prillit në bulevardin e Peshkopisë, por duket se pjesëmarrja do të jetë sërish e vogël".

Drizi ka vërejtje për vëmendjen e pakët të medias ndaj këtij problemi si dhe vëren një përfaqësim të dobët në këtë çështje të shoqërisë civile.

"Krahas protestave të vazhdueshme, - thekson ai, - në jemi duke kërkuar mundësinë e zhvillimit të një tryeze të rrumbullakët mes anëtarev të shoqatës sonë dhe qeverisë si dhe praninë në këtë debat të mediave qendrore, në mënyrë që publiku të njihet me qëndrimin e palëve".

"Ne kundërshtojmë ndërtimin e çdo lloj hidrocentrali mbi Drin, por në qoftë se shteti na bind se ndërtimi i tyre është në interesin kombëtar, atëherë të ndërtojmë një Skavicë të madhe, që e zgjidh përfundimisht çështjen energjetike në vend", - thotë ai.

PRONËSIA E ZGJIDHUR MES BANORËVE, E PAZGJIDHUR ME SHTETIN

Njëri nga problemet që mund të krijojë tensione në të ardhmen është mungesa e dokumenteve të pronësisë.

Toka që kanë në shfrytëzim banorët nuk është marrë sipas ligjit 7501, ashtu siç ka ndodhur në vendet e tjera. Toka e bukës, trojet dhe pyjet janë shpërndare sipas trashgimnisë së të parëve të tyre.

Kjo është një çështje që ka të zgjidhur problemin e konflikteve mes banorëve, por kjo nuk është e vërtetuar tërësisht me pronësinë sipas dokumenteve ligjore dhe kjo mund të sjellë në të ardhen problem në kompensim dhe sorollatje në zyrat e shtetit.

"Nuk kemi certifikatë pronësia as për tokën, as për shtëpitë, as për pemtoret", - thotë Nazmiu, tokat e të cilit nuk përmbyten nga Katundi i Ri, por nga hidrocentrali i Skavicës.

Xheladini thotë se nuk kanë mundur të mësojnë për shpronësimet e tokave dhe trojeve të tyre prej askujt, as prej qeverisë dhe as prej medias. "Ne nuk kemi parë asnjë ekip në terren të shohë dhe verifikojë as tokat, as pemtoret, as trojet", - thotë ai.

Një fletëpalosje që është shpërndarë ilegalisht në fshat, në vend që të informojë banorët, i ka bindur ata se qeveria nuk e ka marrë seriozisht çështjen.

Në fletëpalosje shkruhet se njëri nga ndikimet do të jetë "humbja e tokave bujqësore, pemëve dhe të mbjellave", për të cilat do të merren masa e "kompensimit me kosto të plotë". Gjithashtu, edhe për çështjet e zhvendosjeve fizike të njerezve, humbjes së banesave etj, shpjegimi është krej amatoresk.

"Nuk ka kërkund në fletëpalosje një ligj, një nen, ku të shpjegojë se çfarë përfitojmë, mbi çfarë ligji dhe mbi çfarë shume, gjithçka kuturu", - thotë Xheladini.

Nazmi Drizi, përmes një bisede telefonike, tha se çmimet e shpronësimeve janë nga 120 deri në 180 lekë metër katror. Shumë pak.

Ndërsa një banor tjetër i fshatit në Selane thotë se ai kishte dëgjuar se toka bujqësore do të shpronësohej me 170 lekë m2, dhe kjo është shumë qesharake.

BASHKËPRONËSIA, NJË ÇËSHTJE QË UL PALËT NË BISEDIME

Bashkëpronësia në hidrocentral është një çështje që do t'i kishte ulur palët në bisedime. "A do të ishte zgjidhje bashkëpronësia në HEC?", - i pyes katër anëtarët e fisit Murrja, ndërsa shihnim mendueshëm Drinin ujëshumë që vazhdonte rrjedhën.

Banorët shohin njëri-tjetrin dhe e mohojnë. "Kjo është një çështje që nuk është shtruar në diskutim. Me ne nuk ka diskutuar kush, atëherë çfarë të themi në përgjigjen tonë, llafe pazari?"

"Për çfarë e bën shteti dhe firma këtë hidrocentral? Për të fituar? - thotë Xheladini. - Por përderisa shteti dhe firmat nuk vijnë ta diskutojnë problemin me ne, pse ne duhet të kemi besim tek ata? A i kompensojnë ata edhe mungesën e prodhimit si shkak të ndryshimeve klimatike?"

Një problem shqetësuar është edhe toka që do të mbetet jashtë përmbytjeve. A do të jetë më ajo e vefshme për bujqësinë apo për frutikulturën, ku banorët kanë investuar shumë vitet e fundit?

FLETËPALOSJA PA INFORMACION QË I HEDH "BENXINË" ZJARRIT

Një fletëpalosje e hedhur për të informuar banorët, duket se i ka bindur ata se qeveria i është futur një procesi për të cilin nuk do t'i pyesë as 150 banorët që shpërngulen dhe u përmbyten banesat dhe as qindra të tjerëve që u përmbytën tokat dhe burimet e vetme të të ardhurave.

Fletëpalosja mban si datë printimi muajin shkurt 2016.

"Ata janë tallur me këtë fletëpalosje. Gjysma e fletëpalosjes është me informacione që nuk kanë asnjë lidhje me problemet tona, nuk informojnë asgjë dhe vënë në dyshim inteligjencën tonë", - thonë banorët.

"Çfarë është një hidrocentral?, nis me pyetje fletëpalosja dhe më pas jepet përgjigja: Hidrocentrali është centrali me ujë, i cili prodhon energji elektrike nga lëvizja e ujit".

Më pas tallja vazhdon me përfitimet që vijnë nga hidrocentrali, historiku i tyre në Shqipëri dhe avantazhet që sjell, mes të cilave, një nga pikat kryesore është "ulja e emetimit të karbonit në nivel lokal dhe global".

Sipas informacionit në fletëpalosje, tenderi për Katundin e Ri do të zhvillohet në maj 2016, nënshkrimi i marrëveshjes do të bëhet në korrik 2016 dhe fillimi i ndërtimi në mars 2017.

Ndërsa ftohet publiku dhe palët e interesuara që të njihen me projektin dhe në kuadër të "Studimit VNMS në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare".

"Kjo është një tallje me ne, sepse edhe kur gjasme bëjnë një takim me publikun, nuk vijnë ta diskutojnë me ne, por shkojnë në takime me servilët e tyre që luajnë teatër", - thotë Nazmi Drizi.

***

Qeveria duket se është e angazhuar që të vazhdojë me projektet e hidrocentraleve mbi lumin Drin dhe për këtë po i harxhon energjitë në gjetjen e burimeve të financimit. Pasojat që rrjedhin prej tyre duket se nuk i merr seriozisht. Të paktën deri më tani. Ndërsa banorët i shtyjnë ditën duke iu lutur Zotit që ti kthejë në rrugë të mbarë qeveritarët e këtij vendi, në atë rrugë që të çon në bisedime me banorët. Asnjë anëtar i qeverisë nuk e do më shumë Atdheun se ç'e do çdo kryefamiljar i fisit Murrja në Selane.



Në foto: Shtëpitë e Fisit Murrja që do të përmbyten nga HEC Katundi i Ri. Foto: B.Karoshi

Historia e tenderave të pambaruar

Me historikun e ndërtimit të Skavicës autori i këtyre radhëve është rritur. Tregimet që ngjasonin si legjenda se një hidrocentral që do t'i jepte dritë Shqipërisë do të ndërtohej duke përmbytur shtëpitë tona - toka atëherë ishte e shtetit, - tregoheshin vazhdimisht. Dhe një qytet tjetër do të ndërtohej ku ne do të jetonim të lumtur e të gëzuar tregohej si përrallë. Por pas viteve '90 këto legjenda u harruan, derisa në maj të vitit 2005, qeveria shqiptare nënshkroi një marrëveshje të tipit "BOT - Ndërtim, shfrytëzim, transferim" me shoqërinë italiane TGT. Mbi 600 milionë Euro do të ishte investimi i huaj, por me gjithë shenjat optimiste që prezantonin palët, punimet nuk filluan.

Më 17 dhjetor 2008, Ministria e Ekonomisë hapi fazën e parë të një gare për të përzgjedhur kompanitë që do të ndërtonin tre hidrocentrale mbi Drinin e Zi. Gjashtë kompani të huaja morën pjesë në fazën fillestare, mes të cilave italiane TGK, koreanojugorja "Korea Electric Power Corporation", norvegjezja "Statkraft", gjermanja "R.ë.E. AG" dhe austriaket "Verbund" dhe "Kelag Group". Më 5 janar 2009 komisioni i vlerësimit do të jepte një përzgjedhje për vazhdimin e garës, por ajo dështoi me sukses. Ministria nuk dha informacion publik për dështimin.

Prej atëherë, pavarësisht daljes mediatike të herëpashershme si çështje, dukej se HEC i Skavicës ishte shumë larg realizimit, së pari për shkak të shumës së madhe të financimit, por edhe mungesës së projekteve serioze të qeverisë shqiptare. Por ajo që e ngacmoi çështjen ishte mënyra se si qeveria i dha 8 pikë bonues një konsorciumi turk.

Ishte vetë shoqëria turke që shkroi në faqen e saj të internetit se "Süzer Group" kishte nënshkruar një marrëveshje me të përbashkët me "Nurol Group" që në vitin 2014, për krijimin e një ndërmarrje për ndërtimin e një hidrocentrali në Katund të Ri, me një vlerë investimi prej afro 110 milionë euro. Partia Demokratike reagoi duke akuzuar qeverinë se "kishte dhënë pa tender HEC e Skavicës". Qeveria u detyrua të sqaronte se bëhej fjalë për "HEC Katund i Ri" dhe se për këtë i kishte dhënë konsorciumit turk një bonues prej 8 pikësh. Ditë më vonë qeveria nxori nga sirtari edhe studimet e KESH-it të vitit 2009, realizuar nga kompania e huaj SOGREAH, e cila e ka hedhur poshtë Skavicën në kuotën maksimale prej 441 metra, duke nxjerrë me leverdi dy hidrocentrale: Katundi i Ri në kuotën 445 metra dhe dy versione të Skavicës, 385 dhe 395 metra. Për të parën duket se procesi po vazhdon, pavarësisht kundërshtimit të banorëve, ndërsa për Skavicën po qëndrohet në heshtje, derisa të gjendet po një i huaj për të financuar.

HEC i Katundit të Ri do të ketë një volum prej 12.4 milionë metër kub ujë dhe do të përmbytë mbi 87 hektarë në fshatrat Selane, Hotesh, Gradec, Kovashicë, Topojan e deri në Fushë të Gjoricës.

Hec-i i Katundit të Ri, aferë e madhe korrupsioni

Jam kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.

Arsyet i kam parashtruar në librin "Po Dibrës!, Jo Skavicës".

Zhduk Dibrën. Shuan gjithçka. Dibranët do të enden si "çifuti në shkretëtirë"...

Jam kundër ndërtimit të HEC-eve në Luginën e Drinit të Zi me tri diga. Shkatërrohet reliefi ku do të merren inertet për ndërtim. Natyra e bukur e Drinit të Zi shndërrohet në gërmadhë.

Jam kundër ndërtimit të hidrocentralit mbi Katundin e Ri. Atë që shkatërrohet nuk e paguan as për njëqind vjet energjia që do të prodhohet dhe shkatërrimi i natyrës.

Hidrocentralet mbi lumin Drin janë çerdhja e korrupsionit e kohës sonë.

Dibra nuk fiton asgjë, përveçse ikjen pa kthyer kokën drejt së panjohurës.

E çfarë fitoi Dibra e Madhe nga ndërtimi i hidrocentralit të Spiles përveçse humbjen e 5000 hektarëve tokë bujqësore që ujitej nga dy lumenj, Drini e Radika, dhe ikjen e dhimbshme si në vitin 1913 nga pushtimi serb?

Në Tiranë "shoqëria cilivile" po përleshet për disa dynymë tokë për "Park lojërash".

Turp që nuk flet e bërtet për zhdukjen e një krahine të tërë!

NDAL KORRUPSIONIT SHTETROR,LOJËS MAKABRE ME MBYTJEN E DIBRËS!

Abdurahim Ashiku
24 mars 2016



Më shumë foto dhe video mund të shikoni në faqen e gazetës në FB: Rruga e Arbërit
https://www.facebook.com/Rruga-e-Arb%C3%ABrit-259603234230025/

Rruga e Arbërit nr. 119

FEJTON-SATIRË /
Letër mikut tim për një "ing-poet" që s'din se ç'shkruan e ç'flet...

fejton

Pse mos **ta mbysim Dibrën** profesor Bunguri?

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Nuk e di pse shqetësohemi i nderuar Adem dhe pse bërtasim "ish" kur nuk kemi pula në kotec. Skavica edhe me një digë, edhe me dy, edhe me tri nuk na mbyt as troje e as varre. Ty jo e jo se Greva është lart, por edhe mua jo, sepse trojet e Ashikëve dalin si ballkon mbi liqen. E vetmja gjë që do të na shqetësojë mua, ty dhe të gjithë dibranët në "ballkon të Skavicës" është mjegulla, ai fenomen meteorologjik që më mërdhin edhe këtu në Athinë, sa herë e kujtoj.

Por kjo anashharrohet nisur tashmë nga përvoja prej disa dekadash në dy hidrocentrale mbi Drinin e Zi në pjesën tej kufirit shqiptaro-shqiptar nën FYROM, hidrocentralit të Gllloboçicës dhe Dibrës së Madhe, dhe katër hidrocentraleve mbi Drinin e bashkuar:Fierzës, Komanit, Vaut të Dejës dhe Bushatit.

Tash flitet për tri diga të tjera mbi Drinin e Zi për ta çuar në 9 e për ta kthyer tërë lumin më të gjatë të Drinit në det....

Në det me ishuj, gadishuj, fjorde, limane, e udhëtime me gondola...

Unë edhe ti i kemi thënë JO SKAVICËS ! Jo gjoleve të saj, si me një digë po ashtu edhe me dy e tri diga. I themi jo thjesht nga dashuria dhe nostalgjia poetike se ai zhbë përfundimisht luginën më të bukur e më pjellore në Shqipëri. Unë nga profesioni i agronomit e ti nga ai i arkeologut. E bën dibranin pa plëng e pa shtëpi"çifut në shkretëtirën marramendëse të korrupsionit".

I kemi thënë kotnasikoti.

Ju pyeta "Pse mos ta mbysim Dibrën?" në replikë me një "ing" para emrit të tij, z. Stavri Vangjeli...

Me thënë të drejtën, me gjithë kërkimet e mija nuk e di se çfarë "ing-u" është zoti Vangjeli sepse me "ing" përpara emrit radhisin veten profesione të shumta (gjeologë, hidrologë, pylltarë, ndërtues, minerarë, naftëtarë, elektrikë, mobilieri...) por nga ato që shkruan faqeve të gazetës "Sot" "ing (pa dr. e pa prof.) më ngjan më tepërme një "poet në pleqëri".

Se vetëm poetët ëndërrimtarë në ekstrem mund të na japin vizionin e Detit të Dibrës...

"Skavica e madhe S - 485 do i shërbejë Europës edhe botës!"

O Zot sa i bukur ky titull! Kurrë nuk e kisha menduar...

Më në fund Dibra e ndarë me hanxharin e ndryshkur të Londrës 1913 do të shërbejë për diçka madhore, do t'i shërbejë Evropës dhe Botës. Me siguri do të na pranojnë pa asnjë kusht tjetër në Evropë dhe në Botë. Dhe këtë nuk do ta bëjë politika, por DIBRA...

Dibra me detin e saj???!!!...

Kërshëria më nxiti ta këndoj, si dikur këndonim librat e këndimit, tërë atë që shkruhej në vijim të titullit...

Sipas "ing-ut", "Skavica e madhe S-485" do të jetë ..."Me gjatësi 100 km, e gjithë vija ujore e liqenit do të jetë rreth 300 km e gjatë sepse



Në foto: Adem Bunguri, Abdurahim Ashiku

përfshin 9 apo 10 luginat e mëdha të Drinit të Zi . Diku afër sa bregdeti shqiptar nga Buna në Konispol. Ja pra një Shqipëri e dytë turistike liqenore me rreth 300 m më ulët se liqeni i Ohrit . Kjo vijë liqenore 300 km të gjatë do të kërkojë tre apo katërfishimin e banorëve, që kërkohen të zhvendosen nga varianti i Skavicës së Madhe. Për rreth 7000 familje gjithsej, i bie 20 familje për çdo 1 km."

Dhe prej "9 apo 10 luginave të mëdha të Drinit të Zi" (!!!) na çon në Paris...

"Dibranët e shqiptarët nuk janë njohur fare me "Parisin" ujor të Drinit të Zi. Ata nuk do të kërkojnë ato euro. Dibranët janë në pararojë të etnitet tonë. Vetëm të sqarohen mirë. Ata do të kërkojnë vetëm disa bonuse për të filluar jetën e re në shërbim të shqiptarëve, europianëve por kryesisht të botës së nxehtë aziatike, që kërkojnë të marrin një herë frymë pa kondicioner..."

Dhe fantazia e "ing-ut" na çon e ku nuk na çon. Në "qiellin e shtatë"...

"Do të jetë më mirë se në Zvicër dhe Paris. Për punën e tyre, ata do të shpërblehen vetëm në natyrë në disa akra toke! Banesat e dibranëve 2 dhe 3 katëshe, vila gjithandej futur në pyje e pisha të luginave i ndërtojnë vetë ata dhe i përfundojnë para se të përfundojë HEC-i. Hotele shumë katëshe të korporatave të botës do të hedhin shtat me dhjetëra e dhjetëra. Mos harrohet t'ju falim holandezëve pak fushë në Korab, sepse ata dheun 5 m të lartë e quajnë mal! Turizmi elitar masiv do të jetë kudo të ndërthurura mes tyre me natyrën plot bukuri e shëndet, super shpejtësisë e mjeteve motorike ujore, llixhat kurative me vlera të larta, xhepat e thella ujore të luginave natyrore me shpate të larta e pyje, do të jetë prezent në këtë Dibër shumë të vogël, gjatë gjithë vitit!... Inteligjenca dibrane shpejt do ta kuptojë këtë. Ata duhet të jenë pararoja e Ndryshimit dhe e Rilindjes së vërtetë shqiptare e dibrane."

"Ing-u-poet" pasi na çoi në Paris, Zvicër, Holandë...nuk harron të na çojë edhe në... Stamboll për të na thënë se "Është kryeqyteti i Ballkanit dhe i Anadollit, të dy gadishuj me shumë histori".Dhe për të vijuar... "Nata me ndriçimet është edhe më e paarritshme..."

Dhe duke përfunduar... "Bëra mjaft krahasime ndërmjet detit të kripur të Stambollit dhe detit të ëmbël të Dibrës. Unë po vë në dukje vetëm pak. Do ta kemi detin tonë edhe ½ herë më të thellë dhe 3 herë më të gjatë. Me maja malesh 1500, 2000, 2500 e deri 2800 m të lartë dhe me luginat e thella. Kaq. Poetë të shumtë do të vijnë të frymëzohen e të shkruajnë... edhe turq edhe francezë edhe izraelitë, nga e gjithë bota..."

"Ing-u" më tej na drejtohet me emër ty, Aliut dhe mua. U mërzita pak se ma kishte tjetërsuar emrin nga Abdurahim në Abdurrahman, gjë që nuk ma ka bërë as greku në këto njëzet vjet në mërgim. Por kjo nuk ka rëndësi në krijimtari letrare, i falet.

Ai na drejtohet në njëjës... "Në shek. e 21 historia nuk njihet, nuk përvetësohet dhe nuk admirohet duke shkelur 70 km luginë, kush do të të shoqërojë, akomodimi, të nxehtit e verës që do ta shuash me paguren e ujit që ke me vete. Si do të shohësh vendet e betejave të kohës së Skënderbeut, vendbanimet prehistorike në 18 zona që i përshkruan aq thjesht e bukur z. Adem. A. Ashiku thotë se varret, historia, lavdia e hershme dhe e re do të përfundojnë në llumin e turbullt. Ky është shqetësimi i parë. Unë shkurt po jap mendimin: Historia tani mbahet në muzeume, me piktura, dokumentarë shprehës të vendeve, burrave, kuvendeve, betejave. Dhe këto pa cicëronë, thjesht me komanda dore, ekrane, altoparlante. Me disa orë të ecur nëpër sallone të vogla e të mëdha njeriu thith dije, mbresa, njohuri të thella, të të parëve tanë dhe dibranë! Me investime për të bërë më të bukurën, që do të rrjedhin vetëm nga një vepër gjigande, është problemi më i thjeshtë që ka për të zgjidhur. Nuk është ëndërr. Janë 170 milionë euro në vit që i hiqen fondit vjetor për blerje energjisë elektrike. Janë milionat që do përfitohen nga turizmi. Vetëm, vetëm një gërmë ndryshoni në botëkuptimin tuaj nga JO bëheni PO."

Nuk ndalet hovi poetik i "ing-ut". Ai na tregon "arat" që nuk na i kishin treguar as prindërit e gjyshërit, këndon me pathos për to.

"Punët i kryejnë vetë dibranët... Dikur mblidheshin e gdhiheshin me javë e muaj për t'u përballur me armikun. Tani do të punojnë ditë e natë të krijojnë jetën e tyre të re dhe me det. Fillimisht, duke u nisur nga vija ujore e liqenit do t'i caktohet çdo familje truallin e ri. Për çdo familje rreth 20 m vijë ujore! Ja shpronësimi u zgjidh. Janë 220 ha pyje që përmbyten. Me një llogaritje të përafërt i bie që rreth 40 drurë i përkasin çdo familje, që t'i përdorë për 2 dyshemetë dhe çatinë e vilës së re. Ndërtimi horizontal duket se u zgjidh. Kërkohen kryesisht edhe këto shpenzime: Makineri për gurrë dhe latimin e tyre. Dhe atyre dekorative. Hekur e çimento. Makineri zhavorri..."

Më tej i "zë qetë" me z. Faruk e z. Kukeli "ish agronom i diplomuar në Korçë", të cilëve u bën thirrje që "Qysh këtë verë të fillohet me qerestenë e pyjeve që do të përmbyten! Me pleqësinë dibrane në krye, ky aksion i madh i kombit bëhet realitet!"...

Më tej ai kalon thellë në histori ku mbledh e bën grumbull turq, kinezë, personalitete historikë... Davutoglunë, Aleksandrin e Madh, Kostandin e Madh, Kastriotin e Madh... për të nathënë se ata, shekuj para Krishtit e shekuj që nga mesjeta për "Skavicën e madhe S – 485" kanë menduar e kanë luftuar.

Unë u kënaqa me "ing-un" pa "dr." e pa "prof.", z. Vangjeli. U kënaqa aq shumë sa vendosa ti them PO SKAVICËS. Ma mbushi mendjen sa koka ime është plotë përplot.

Unë po zgjedh vendin ku do të ndërtoj vilën time në tre poda. Po zgjedh ishullin e Gjarajcës mes detit të Dibrës. E kam timen atë kodër se lidhet me trojet e gjyshit tim zbritur nga Bulaçi në Rreth Kale. Dyzet drurë do t'ia kërkoj mikut tim, Dr.prof.ing. Selman Mëziut të mi zbresë nga pylli i Kroit të Zi për të shtruar dy dyshemetë dhe çatinë e vilës. Me siguri miku im inxhinier i pyjeve, ekolog i njohur, do të ngrejë vilën e vet në fjordin e Gurit të Kuq dhe do të komunikojmë bashkë kur dielli do të ulet mbi Runjë me gondola. Se i dashur Adem, Deti i Dibrës do të ketë shumë fjorde sa vendet nordike do ti kenë zili. Në 9 apo 10 luginat e Drinit të Zi që tash do të jenë fjorde do të ndërtohen hotele shumë katesh të korporatave të botës...

Unë më në fund do të njoh "Parisin" ujor të Drinit të Zi...

Edhe ty i dashur Adem të them shoqërisht t'i thuash "PO SKAVICËS", asaj të madhes. Dhe nxito shpejt të zësh një truall në ishullin "Kulla e Murre" në Hotesh. Dhe lëri anash ato studimet tuaja për arkeologjinë e Dibrës. "Historia tani mbahet në muzeume,-të kështillon "ing-u", me piktura, dokumentarë shprehës të vendeve, burrave, kuvendeve, betejave. Dhe këto pa cicëronë, thjesht me komanda dore, ekrane, altoparlante. Me disa orë të ecur nëpër sallone të vogla e të mëdha njeriu thith dije, mbresa, njohuri të thella, të të parëve tanë dhe dibranë...".

Bëju edhe ti me mua i nderuar Adem Bunguri. Harroje punën e arkeologut. Do të jetë më mirë se në Zvicër dhe Paris...

Athinë, 26 mars 2016

Shënim: Citimet janë origjinale. Unë nuk mbaj asnjë përgjegjësi për gabimet drejtshkrimore e logjike të ing.Stavri Vangjeli. I mban ai dhe gazeta që mbledh e boton lajthitje të këtij soji.



Bëj pajtimin tënd me

PayPal

përmes emailit
<rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton:
Në Shqipëri: 600 lekë.
Në Europë: 10 Euro.
Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.

Pajtimi në Europë dhe SHBA
është vetëm në versionin PDF.

Kryeministri Edi Rama pritet të vizitojë qytetin e Peshkopisë gjatë muajit Prill. Dhe një lajm për firmosjen e e marrëveshjes me shoqërinë kineze apo gjetjen e burimeve të tjera të financimit është shumë i mirëpritur. Në fund të fundit, dibranëve nuk u intereson se sa do të kushtojë rruga. Sado të kushtojë, ata njerëz e meritojnë!

E meritojmë Rrugën e Arbrit sado të kushtojë!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Kur kryeministri Rama prezantonte programin e qeverisë së tij në Parlament më 11 shtator 2013, duke folur për investimet në infrastrukturë tha se do ta nisnin nga "Rruga e Arbrit si prioritet...".

Ky ishte premtimi më serioz pas zgjedhjeve, ndërsa gjatë fushatës elektorale kishte theksuar se "Rruga e Arbërit është një projekt kombëtar, është një projekt shumë i rëndësishëm jo vetëm për ju, por është shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Është një projekt që nuk garanton thjesht lëvizjen, nuk shkurton lëvizjen thjeshtë, po garanton një zhvillim për një territor të tërë që tani është jashtë hapësirës së zhvillimit dhe është një projekt që për ne hyn tek projektet strategjike që ne do ta çojmë përpara me shumë vullnet".

Por prej atëherë qeveria nuk ka folur më për Rrugën, duke e quajtur këtë çështje të zgjidhur me shoqërinë kineze "China State Construction Company". Qeveria kaloi në prill 2015 një ligj të posaçëm në Parlament që i hapte rrugë negocimit të drejtpërdrejtë, dhe kur priteshin që në fund të vitit të përfundonte marrëveshja dhe në fillim të këtij viti të fillonin punimet, duket se problemi është kthyer në pikën fillestare. Dhe njëra nga arsyet është mosmarrëveshjet me kompaninë kineze për sa i përket kostos së financimit, duke e bërë marrëveshjen të paleverdisshme për qeverinë shqiptare.

SA KUSHTON RRUGA E ARBRIT?

Kjo është një pyetje që kurrë nuk ka marrë një përgjigje të saktë. Gjatë seancës parlamentare për miratimin e ligjit që i hapte rrugë negocimit më shoqërinë kineze, ish-kryeministri Berisha tha se "në të gjitha përllogaritjet, mund të kalojë edhe 1 miliardë".

Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Edmond Haxhinasto, tha atëherë në Kuvend se "26.9 kilometra është segmenti që po diskutojmë sot dhe kushton rreth 200 milionë Euro".

"Në projektin e hartuar nga qeveria e Partisë Demokratike, vlera e projektit shkonte deri në 180 milionë euro, ndërsa në këtë qeveri kjo vlerë ka shkuar në 240 milionë euro", thoshte atëherë deputeti i Dibrës, Bedri Hoxha.

Në Komisionin e Ekonomisë, gjatë diskutimit të projektligjit në fjalë, ministri Haxhinasto kishte deklaruar se "Autoriteti Rrugor Shqiptar e kishte llogaritur vlerën e projektit 28.8 miliardë lekë (përafërsisht 206 milionë euro) ndërsa kompania kineze ka sjellë një ofertë prej 21 miliardë lekë (përafërsisht 150 milionë euro - llogaritje B.K).

Ministri Arben Ahmetaj, duke folur atë kohë rreth aspektit financiar theksonte se "projekti do të negociohej". "Parlamenti, sipas tij, do të votojë sot vetëm procesin e hapjes së negociatave, ndërsa sa do të jetë kostoja, sa transparente do të jetë, ky Parlament dhe institucionet e tjera kanë mundësi ta ndjekin gjatë procedurës së negociatës".

Koço Kokëdhima, deputet i PS, në një intervistë ekskluzive për gazetën "Rruga e Arbërit" në prill 2015 tha se "kushtet e huasë që parashikoheshin në bisedimet e qeverisë së mëparshme ishin shumë të shtrenjta për Shqipërinë. Huaja parashikohej me interes 9.5% dhe koeficienti i kthimit të investimit, ishte 14.5%, pra, të dyja bashkë 24%". Ai theksoi se "marrëveshja e parashikuar pas negociatave të qeverisë parashikon një interes 3% dhe koeficienti i kthimit 5%, të dyja së bashku në 8%, shumë më e ulët se ajo e qeverisë së kaluar".

Rreth 200 milionë euro e parashikonte rrugën edhe ish-ministri i Financave Shkëlqim Cani, gjatë një interviste në atë kohë në Top Story.

Televizioni "Ora Neës" gjatë një kronike që i referohej vizitës së Kryeministrit Rama në Kinë në nëntor 2015, zbuloi se kosto e projektit për segmentit që vazhdonin negociatat janë 36 miliardë lekë - rreth 260 milionë euro.

"Financimi nga "Exim Bank" mendohet të jetë në shifrat e 200-300 milionë dol¬larëve që nevojiten për ndërtimin e tunelit të Qafë Murrizit dhe të një ure përgjatë këtij segmenti", shkruante në atë kohë portali respublica.al, një media e afërt me qeverinë.

Por, që kur ligji që i hapte rrugën negocimit të drejtpërdrejtë u miratua në Parlament, përveç rasteve sporadike të anëtarëve të qeverisë, ka pasur një heshtje të plotë. Tani, kur negociatat duhej të ishin mbyllur dhe procedura duhej të shkonte sërish në parlament për miratim, asgjë nuk dihet rreth kostos së ndërtimit.



Propozimi i ri: Një bypass në vend të tunelit. Rruga hapet për qarkullim për 18 muaj. Shoqëria Civile: Nuk ka kohë për të humbur

Në foto: Punimet në Rrugën e Arbrit pranë Urës së Vashës. Foto: B.Karoshi (Mars 2016)

"Djalli fshihet në detaje", - thotë një fjalë e urtë, dhe për çështjen e rrugës së Arbrit "djalli u shfaq gjatë negociatave". Ato duhet të kishin mbaruar, duhej të ishin firmosur nga tre ministra të qeverisë, dhe duhej të kishte shkuar në parlament për firmë. Por me sa duket, marrëveshja nuk është në kushte të pranueshme për qeverinë shqiptare. Mediat kanë raportuar se kjo mund të jetë kundërshtuar edhe nga FMN dhe Banka Botërore, ndërkohë që mungesa e informacionit për procesin, u ka dhënë zë njerëzve që jetojnë me teori konspirative se ndërtimin e kësaj rrugë nuk e do Greqia, Maqedonia dhe qarqet antishqiptare në rajon.

Më herët është folur për tërheqjen e Exim Bank nga financimi, por kjo nuk është pranuar zyrtarisht. Ndërsa në fillim të marsit, ish- kryeministri Berisha, gjatë një postimi në Facebook në fillim të marsit, shkruante se "Qeveria Kineze e ka njoftuar Ministrinë e Jashtme se ka nisur një hetim për korrupsion në lidhje me financimin e Rrugës së Arbrit". Sipas Berishës, "ky segment rrugor nuk kushton 80 deri 100 milionë euro. Ndërsa Bechtel ka ofruar ta ndërtojë këtë segment për 120 milionë euro"". Sipas Berishës, tek formula e financimit "Koncension me garanci trafiku" fshihet abuzimi që e ka çuar ofertën e shoqërisë kineze në 360 milionë euro.

PROPOZIMI I RI: NJË BYPASS NË VEND TË TUNELIT. RRUGA HAPET PËR QARKULLIM PËR 18 MUAJ

Një burim pranë Ministrisë së Transporteve i tha gazetës së një propozim i ri i ka ardhur Ministrit Haxhinasto për të gjetur një zgjidhje emergjente për çështjen e Rrugës së Arbrit. I pyetur se nga kush kishte ardhur propozimi, ai nuk përmendi emra, por theksoi se nga një firmë projektuese shqiptare, e cila është marrë me projektimin e rrugës.

Pyetjes se ç'po bëhej me kontratën me shoqërinë kineze, burimi, që lutet që të mos i përmendet emri, tha se kinezet kërkojnë rreth 200 milionë euro për ndërtimin e këtij segmenti të rrugës së Arbrit. Ata kanë përgatitur një propozim, ku përfshihen edhe ndryshime, të cilat dëmtojnë cilësinë e rrugës. Por, sipas burimit, duket se qeveria nuk është e gatshme ta firmosë për shkak të kostos së lartë të ndërtimit dhe termave financiarë të marrëveshjes, të cilat nuk janë të pranueshme për qeverinë shqiptare.

Ne kontaktuam z. Faruk Kaba, autor i projektit të kësaj vepre, i cili pranoi se, pasi ishte njohur me propozimin kinez, kishte dërguar pranë autoriteteve zyrtare një propozim, me të cilën i jepej një zgjidhje e shpejtë çështjes së rrugës së Arbrit.

"Njëri nga problemet e financimit të rrugës mbetet vlera e financimit, e cila parashikohet sipas projekteve të deritanishme rreth 150 milionë euro", tha ai. Duke marrë parasysh se pjesa më e madhe i takon ndërtimit të tunelit të Qafës së Murrizës - i cili kushton rreth 75-80 milionë euro, kemi propozuar që të fillojë ndërtimi i saj pa tunel. Në vend të tij të ndërtohet përkohësisht dhe me parametra të pranueshëm një bajpas, dhe kur të jetë e mundur nga ana financiare, të ndërtohet tuneli në një fazë të dytë".

Kjo do të zgjasë rrugën rreth 4.7-5 km. "Por, - thekson Kaba, - ky bajpas provizor do të jetë i detyrueshëm të ndërtohet edhe kur tuneli të jetë përfunduar, pasi është e domosdoshme, duke qenë se tuneli është parashikuar me një tub, si alternative kalimi për situata emergjente ose bllokime të tunelit në raste aksidentesh apo probleme të tjera teknike".

Kaba tha se ky propozim është plotësisht i realizueshëm. "Duke qenë se rruga është një vepër lineare, është e mundur shtrirja e punimeve në të gjithë gjatësinë e saj dhe ndarja e tyre në shumë firma. Rruga përfshin edhe një tunel të shkurtër të Gurit të Bardhë, 570-600 metra dhe një urë të madhe, e cila kërkon një teknologji të veçantë. Këto dy vepra mund t'ju besohen firmave të huaja, ndërsa pjesën tjetër të punimeve mund ta realizojnë firmat shqiptare të ndërtimi. Me një organizim të kujdesshëm për ndarjen e punimeve, në lëvizje dherash, vepra arti të vogla dhe të mëdha, punime shtresash, asfaltime dhe të tjera të mbetura, është plotësisht e mundshme që ky segment i mbetur i rrugës së Arbrit të përfundojë brenda një afati 15-18 mujor dhe rruga të hapet për trafikun, nëse edhe segmentet e mbetura, ku sot po kryhen disa punime, të përfundohen gjatë të njëjtës kohë".

Pyetjes se a ka marrë përgjigje për këtë propozim, Kaba tha se ai nuk pret përgjigje. "Unë pres, tha ai, që të ftohem për të argumentuar propozimin në një këshill teknik apo diçka të tillë. Vendimmarrja i mbetet sektorit publik".

SHOQËRIA CIVILE: NUK KA KOHË PËR TË HUMBUR

Kur jemi 15 muaj para zgjedhjeve, duket se më "çështjen e rrugës së Arbrit" do ta kalojmë edhe një fushatë tjetër elektorale, sigurisht përmes manipulimit dhe mashtrimit.

Siç faktet tregojnë, që prej 18 marsit 2013 kur nisi peticioni për Rrugën e Arbrit, asgjë nuk ka ndodhur, me gjithë premtimet e qeverisë se procesi është drejt finalizimit.

Kur nisi peticioni njërin nga synimet kryesore kishte që të ndikonte te qeveria e dalë pas zgjedhjeve të 23 qershorit që të niste dhe të përfundonte sa më shpejt rrugën e Arbrit, me cilësi dhe më standarde europiane. Rruga ishte një projekt që kishte nisur dy dekada më parë, por përveç fushatave elektorale që flitej çdo ditë për të, më pas heshtej.

Shoqëria civile kërkonte që të rriteshin përpjekjet dhe në koordinimi me deputetët e Dibrës dhe jo vetëm, të të gjitha partive politike, të hartohej një program i përbashkët, ku palët të merrnin përgjegjësi për ta çuar procesin e ndërtimit të rrugës përpara. Qytetarët e Dibrës janë treguar vazhdimisht të gatshëm që të paguajnë për këtë rrugë, pavarësisht se kush investonte. Dy shoqata dibrane i nisën edhe një letër gjashtë deputetëve të Dibrës dhe ministrit të Transporteve kur shprehën angazhimin për t'u përfshirë në proces si dhe bënë disa sugjerime thelbësore për një standard të lartë të ndërtimit të rrugës.

Me sa duket, qeveria shqiptare e quajti të mbyllur çështjen me kinezët, dhe jo vetëm që nuk u tregua e gatshme të bashkëpunonte, por deputetë dhe militantë të saj akuzuan qytetarët e angazhuar në këtë proces se ata po i shërbenin PD dhe SHQUP-it. "Për këtë çështje ka menduar Edi Rama, ndaj duhet ta lini të qetë". Përmes profileve fallso në rrjetet sociale u sulmuan disa anëtarë të shoqërisë civile, duke u kërkuar që të mbyllej peticioni, pasi qeveria do ta mbajë premtimin elektoral dhe për ballafaqimin e këtyre premtimeve duhet të presim vitin 2017.

Ndërkohë, qeveria ia ka dalë të gjejë financime për disa rrugë në vend, të cilat nuk do të kenë impaktin që sjell rruga e Arbërit në ekonominë vendore. Vetëm për rrugën Qukës - Qafë Plloç kjo qeveri ka arritur të gjejë rreth 150 milionë dollarë nga Banka Islamike, ndërkohë që rruga do të shkurtojë distancën më qytetin e Korçës jo më shumë se 5 km, dhe ndërtimi i saj kalon në lartësi mbi 800 metra mbi nivelin e detit, që do ta bëjë rrugën të vështirë gjatë periudhës së dimrit. Ndërkohë, pak ditë më parë, Ministri i ri i Financave ka nënshkruar një marrëveshje me Fondin e Kuvajtit prej afron 40 milionë dollarësh për rrugën e Lumit të Vlorës. Po ashtu, në konferenca ndërkombëtare qeveria shqiptare ka propozuar projekte të tjera në infrastrukturë, përfshirë edhe projektin e quajtur Boshti qendror i Jugut, që do të lidhë Elbasan-Berat-Tepelenë me një kosto të llogaritur në 210 milionë euro.

* * *

Shqipëria është një vend në zhvillim dhe rrugët e reja janë të nevojshme gjithkund. Por asnjë rreth a qark në Shqipëri nuk është kaq i izoluar sa ç'është Dibra. Ndaj rruga e Arbrit mbetet një prioritet.

Kryeministri Edi Rama pritet të vizitojë qytetin e Peshkopisë gjatë muajit Prill. Dhe një lajm për firmosjen e e marrëveshjes me shoqërinë kineze apo gjetjen e burimeve të tjera të financimit është shumë i mirëpritur. Në fund të fundit, dibranëve nuk u intereson se sa do të kushtojë rruga. Sado të kushtojë, ata njerëz e meritojnë!

Rruga e Arbërit nr. 119

Në vend
të një reportazhi

reportazh

Vlesha – *katundi që ka bërë emër*

Nga Prof. **Hajri SHEHU**

Vlesha është në rrëzë të Stërmecit. Stërmeci është mal, krejt i veshur - me shkozë, krekëza, thana e lajthi. Thuhet se në majë të Stërmecit, pranë kepit të Allçanikes ka qenë një manastir. Mundet. Hershmëri tregon. Pak më tej kepit, në të majtë është një shkëmb, si i prerë me thikë për së gjeri, me një damar të madh, të bardhë si mermer. e Velezit quhet...

Vlesha është njëri nga katundet e Ujemujës. Ujemuja, siç e tregon vetë emërtimi, kufizohet me ujëra në tri anë: Veleshica (në verilindje), Drini (në perëndim), Përroi i Gramës (në jug). Në lindje ka zabele, livadhe, pyje, kullota e bjeshkë që shkojnë deri në Korab. Qendra administrative e Ujemujës është Sllova.

Vlesha është në rrëzë të Stërmecit. Stërmeci është mal, krejt i veshur - me shkozë, krekëza, thana e lajthi. Thuhet se në majë të Stërmecit, pranë kepit të Allçanikes ka qenë një manastir. Mundet. Hershmëri tregon. Pak më tej kepit, në të majtë është një shkëmb, si i prerë me thikë për së gjeri, me një damar të madh, të bardhë si mermer. Rrasa e Velezit quhet. Sipas një kumtimi gojor nga i ndjeri Murat Hysa, te ky shkëmbi, tek ai damari i bardhë shkonin cucat e Vleshës, kur e ndienin adoleshencën e tyre, për t'u matur sa ishin rritur e sa ishin zgjatur. Tani nuk shkojnë më.

Prapa Stërmecit është një luginë e pjerrët me një rrafshinë në krye. Rrafshina quhet Zegadishte (besojmë të jetë një shformim i emrit Zagradishte). Në krah të djathtë të luginës ngrihet madhështor Gjipsi. Një mal i tërë. Një pasuri e madhe. Dikur, gurët që binin nga Gjipsi, do t'i merrnin nxënësit për të bërë parulla. Se ishin të bardhë. Do t'i merrnin edhe ndërtimtarët për t'i vënë midis rreshtave të qeremiteve (tjegullave), për të mos lëvizur nga erërat. Se ishin gurë të bardhë. Se zbukurohej çatia: kuq e bardhë.

Lart, shumë lart nga toka, atje në Gjips ka qenë një fole shqiponjash. Ajo duhet të ketë qenë shumë e thellë, sepse hynin e dilnin aq shumë shqipe. Imagjinoni ato flatrat e mëdha hijerënda të shqipeve dhe fërfëllimën e tyre sundimtare. Tani foleja është shuar. Është fikur. Ndoshta, shqiponjat i kafshoi ndonjë gjarpër i madh brenda në fole, kur nuk fluturonin, kur pushonin, kur flinin. Sepse gjarpri hyn aty ku e kanë bërë strehën të tjerët. Atëherë, kur fërfëllonin, ne fëmijët mundoheshim t'i shoqëronim me vështrimin tonë të ngulët hyrjet e daljet e shqipeve, derisa na lodheshin sytë. Tani ka mbetur vetëm vallja e kënduar e vajzave, "*Shqipe, shqipe*": *Pse m'sillesh mbi krie, / Shqipe, shqipe? / A don me m'kobit(e) / Shqipe, shqipe? / Hala gishti për mihir* (= myhyr unazë) *s'm'asht rrit(e), / Shqipe, shqipe*. Një skenë madhështore. Vajza punon në arë. Vetëm. Ka qitë rendin e korrjes dhe ka dalë ndër hije *(Çita renin e dola nër hije)*. Lart, mbi kryet e saj fluturon shqiponja. Për ta rrëmbyer. Sepse është aq e mirë. Një simbolikë kaq poetike: shqiponja – unaza *(myhyri)*. Vajza e di fejesën, përderisa përmend unazën. Madje, e do unazën, por ka njëfarë frike. Sepse, me siguri, ajo ka shkuar tek ajo Rrasa e Velezit për t'u matur dhe i është dukur që duhet të rritet edhe pak. Por e punës është. Ndryshe, si do të ngrihej para shqiponjës e madje, të kishte korrë me drapër edhe një rend grurë? Melodia, sikur imiton uljet dhe ngritjet e krahëve të shqiponjës e në ajri përcillet jehona e fjalëve të vajzës. Është një këngë që mund të këndohet, vërtet në skena operash.

Nga Gjipsi dalin dy burime uji: njëri, sa për një mulli bloje; tjetri, më i vogël. Me ujë kristal. Me ujë të ftohtë akull, që mund të pihet vetëm me pipëz kashte. Me ujë sulfuror. Mjaft kurues për sëmundje reumatizmale. Në verë, në korrik e gusht, vijnë nga fshatrat përreth, por edhe nga larg - edhe nga Kukësi, Tirana e Lushnja. Thonë se ka qenë në hartat hidrologjike austriake që më 1916. Në Gjips janë Rrugët e Bardha. Mbi Gjips ka një lajthishtë të madhe. Mbi Zegadishte ka, gjithashtu një lajthishtë. Pas lajthishtes vjen Zabeli. Dikur me drurë të mëdhenj ahu, që u prenë. Tani, ka vite që është bërë itifaku të mos preket zabeli. Dhe po rriten ahe si dikur. Itifaku, - një zgjidhje e bukur popullore: Zabeli është i të gjithëve dhe e ruajnë të gjithë. Është i të gjithëve dhe askush nuk e prek. Edhe Livadhi i Gjatë është i të gjithëve. Dikur e kositnin bashkërisht dhe e ndanin barin bashkërisht. Tani njerëzve u duket larg, ngaqë kanë tokë, sepse janë larguar shumë familje në Tiranë, Durrës etj. Në krah të majtë të Stërmecit është Rrafshja e Pazarit. Siç e tregon vetë emërtimi, dikur aty është bërë pazar. Në të hyrë të fshatit është një damar i madh shtufi, aq i mirë në ndërtimtari.

Në Zegadishte, në atë fushëz midis maleve, ka disa vjet që bëhet piknik në fillim të qershorit. Me mish të pjekur e me fli (fërli, palanik). Edhe me filmime. Tashmë, atje shkohet edhe me makinë. Thonë që në kohë të hershme pikniku bëhej në Krye të Zabelit ditën e Shëngjergjit, më 6 maj. Dhe prandaj burimi i vogël i ujit, që ka shekuj që nuk men, është quajtur Kroi i Shënxhexhit. Vite më parë, çikërrima e ujit, që quhet Kroi i Shënxhexhit, kishte lëfyt druri. Tani e ka rregulluar me rezervuar e me lëfyt plastik mjeshtri Aladin Shehu, i derës së Sheh Zumanit. Është i vetmi burim uji në një hapësirë aq të madhe. Prandaj ka bërë me çimento edhe një ujëmbledhës për kafshët dhe për zogjtë. Piva ujë, - thotë Aladini, - dhe bana të nisem. Kali më lëpiu dorën, çka do të thoshte se donte ujë edhe ai. Të nesërmen mora thasët me çimente dhe me ranë e bana lugun për kafshë. Se kafshët, - shton ai, - janë si njerëzit. Aty, edhe sot e kësaj dite janë tre drurë ahu më shumë se shekullorë. Shkuarja atje është, vërtet një ecje alpinistike. Kur mbërrin, çelesh sysh. Syri të sheh visore (peizazhe) të bukura. Të sheh edhe Fushën e Thatë, Bushtricën e edhe Kolasjanin e Kukësit. Aq lart e aq larg sheh syri. Livadhet, kullotat e pishnajat shkojnë deri në Gramë e Korab. Si në mes të rrugës – nga Zegadishtja te Kroi i Shënxhexhit është një si rrafshinë tjetër e vogël që quhet Papaxhurxhe. Sipas Defterit turk të vitit 1467, fshati ka qenë i krishterë. Lexuesi mund të bëjë lidhjen: manastiri te Rrasa e Velezit – Zagradishja – papa Xhurxhja – Kroi i Shëngjergjit. Dhe po të zbresim nga mali, kemi Shumarenën (Shën Marena) – përrua, Shënaprene (Shëna Premte) – ara e Shënxhexhe (Shëngjergje) – ara.

Në Defterin kadastral turk të vitit 1467, Vlesha del me 13-15 shtëpi. Ja disa nga emrat e banorëve të atëhershëm: Pip Lloshi, Leka Lloshi, Vllatko Lloshi, Koli Luzi (sot ka ara që quhen Luze), Petër Piluga, Gjuro Piluga (sot ka ara në Kallë me emrin Piluga), Nikolla Kaleçi, Petër Kaleçi, Nikolla Mileci, Gjon Tërbaçi (sot janë trojet e Tërbaçit dhe emërvendi "Stani i Lakës" / i Lakë Tërbaçit, për të cilin thuhet se kishte aq shumë bagëti, sa tamblin e çonte më tej me lugje), Llazar Bërzili etj. Sipas Defterit, ndër taksat që i paguheshin timarit, ishin gruri, thekra, meli, thjerrëza, arrat, mushti. Tani, por edhe shumë kohë më parë, thjerrëzat dhe mushti nuk njihen. Ta do mendja të thuash se gresi (larushku) në fushë të Vleshës të ketë qenë rrushi i mushtit, por që ka degraduar. Sa për arrat - arra ka edhe sot shumë. Madje, Vlesha mund të quhet vendi i arrave.

Që atëherë, Vlesha ka ndryshuar shumë. Ka ndryshuar shumë pas Çlirimit. U bënë shumë banesa. U ndërtua shkolla fillore. U shkolluan shumë veta me arsim të mesëm, kryesisht për mësues, por edhe me arsim të lartë. Në vitet '60 të shekullit të kaluar, në Vleshë, në çdo tri shtëpi i takonte të kishte një mësues. Dhe fshati duhet të ketë pasur jo më pak se 60 shtëpi. Më pas, mësuesit e përgjithësisht, intelektualët janë shtuar edhe më. Deri në vitin 1990, në Vleshë numëroheshim mbi 60 intelektualë – pedagogë, inxhinierë, agronomë, mësues, ushtarakë, mamí, infermiere, laborante mjekësore etj. Në punë të arsimimit, Vlesha mund të krahasohet me Zerqanin.

Pas viteve '90 të shekullit të kaluar, shumë familje e kanë lënë Vleshën dhe janë vendosur në Tiranë a gjetiu. Kanë mbetur shtëpi të zbrazëta. Janë vetëm dy-tri familje, që edhe pse banojnë në Tiranë, i mbajnë edhe shtëpitë e Vleshës. Kësisoj, fshati nuk e ka më atë shkëlqimin e gjallërinë e dikurshme. Vetëm për dasma a për sebepe të tjera shumohet disi Vlesha e ndihet njëfarë ndryshimi. I mirë, por i përkohshëm.

Ata që nuk kanë lëvizur, punojnë e prodhojnë. Janë krijuar tri-katër pemëtore. Tani i marrin të shartuara pemët. Kurse në vitet e para pas Çlirimit e më pas qe dora e Xhavit Hysës që shartoi mollë, dardhë, mana, qershi. Edhe kumbulla me zerdeli. Thjesht, për hatër. Për bashkëfshatarët. Kur vinte nga Peshkopia në ditë pushimi. Inxh. Isak Karçi ka ngritur një fidanishte pyjore me drurë zbukurimorë - blirë, mështekna etj. Ata që nuk kanë lëvizur, punojnë e prodhojnë, por puna e tyre duket se nuk jep atë që duhet. Cili është problemi? Prodhojnë, por u mbetet pa shitur. Më tregonte një bashkëfshatar: "Kam bërë 7 kv fasule, por nuk e shes dot dhe kam vendosur të mos mbjell më". Të mos mbjellësh?! Të mos mbjellësh, do të thotë të mos korrësh e të mos kesh. Një tjetër thoshte se kishte dele, se kishte qumësht e djathë e gjizë, por ankohej se vinin matrapazët e ia merrnin shumë lirë. Nuk kam interes të prodhoj, - thoshte ai. Ata të pemëtoreve qanin hallin se ç'do të bëhej kur pemët të hynin në prodhim. Po, janë, vërtet probleme. Dhe shteti duhet të mendojë. Shteti organizon dhe bashkërendon.

Përmes Vleshës kalon rruga e asfaltuar automobilistike që lidh Peshkopinë me Kukësin. Rruga ka prurë makina në fshat. Por, sidoqoftë, fshati sikur është vjetruar. Ku e si? Ka mjaft gjëra për të thënë. Më e para fjalë që mund të thuhet, është për ish-shkollën fillore. Qe shkollë e këndshme. U ndërtua pas Çlirimit. Për fëmijët e Vleshës dhe të Kallës. Me një pozicion e oborr që zor se e kanë shkollat e qyteteve. Tani dergjet. Nuk është keq që ata pak fëmijë të fshatit i çojnë me makinë në Sllovë. Por themi se është keq që ish-ndërtesa e shkollës dergjet: pa dyer, pa dritare. Le të bëhet diçka tjetër e të mos mbetet strehë macesh. Le të merret shembull ndërtimi i xhamisë. Besojmë të jetë më e madhja në krahinë e tej krahinës.

Fusha. E veçanta e saj është se pothuajse të gjitha arat janë me porende (mezhda me shkurre, sidomos me thana e lajthi). Sigurisht, në këto mezhda mund të shijosh thana e lajthi e manaferra e edhe gres, molla të egra e kaçe. Por ato e zvogëlojnë arën, e hanë. Në kohë të kooperativës kishte rrugë zetori e makine transporti. Tani rrugët janë zënë. Dhe transporti i prodhimit e i plehut bëhet me kalë. Jo afër. Larg. Vetë populli thotë: Është më mirë të dish, sesa të kesh. Atëherë në këtë rast, gjykimin e kanë në dorë vetë fshatarët. Vlesha ka shumë burime ujore. Nuk janë vetëm dy përrenjtë e Gjipsit. Ka burime në fshat dhe në fushë. Me Vleshën mund të matej ndoshta vetëm Gjorica. Në Vleshë, edhe në korrik, duhet të jesh i kujdesshëm të mos lagësh këmbët. Por, fatkeqësisht, ka ndonjë përrua a vijë që ndotet me hedhurina. Na duken, gjithashtu problem jo i vogël ujërat shpëlarëse të shtëpive (sepse tani çdo familje ka çezmë në oborr).

Në Vleshë ka disa fise. Secili, me të mirat e veta. Dhe me historitë e veta. Ndoshta, si më e veçantë është historia e fisit Shehu. Në zanafillë, një shkodran. Shumuar në dhjetëra e dhjetëra familje që nga viti 1800. Me njerëz të ditur. Më i pari, sheh Ibrahimi. Më pas, sheh Osmani. Shkolluar të dy, atë e bir, në Stamboll për fe. Sheh Osmani zbriti në mëhallën e poshtme e u krijuan kështu dy teqe. Thuhet se një pinjoll i teqesë së epërme ka shkuar tek Ura e Gurit në Prizren dhe edhe sot vijon rrënja e tij. Brez pas brezi, deri në vitin 1967, shehlerët e Vleshës, sidomos të mëhallës së poshtme qenë imamë në Fushë-Alie, Lazrej, Arras, Mustafe etj. Sheh Osmani, për një muaj Ramazan - në oborrin e Ali pashë Tepelenës. Kur e përcolli, Pashai i dhuroi një orë muri. Ora është ruajtur brez pas brezi. Tashmë, ajo i është dhuruar muzeut të Tepelenës. I shkolluar qe edhe sheh Zeneli. Tregojnë se në kohën e zisë, më 1916, nuk e hante racionin e tij të bukës dhe e ruante për udhëtarë, për lypës, për fëmijë a për të varfër. Një figurë tjetër ka qenë sheh Zumani. Thonë që në shtëpinë e tij ka bujtur Abdyl Frashëri në rrugë e sipër për në Prizren, për Lidhjen e Prizrenit. Nga të gjithë dijetarët fetarë të kohës, u përzgjodh sheh Zumani i Vleshës për të bërë duanë e kurorëzimit të mbretit Zog.

Imamët e Vleshës pajtuan gjaqe të mëdha. Urdhri kur'anor është: *Kush vret një njeri, ka vrarë tërë njerëzimin*. *Kush shpëton një njeri, ka shpëtuar tërë njerëzimin*. Ky ka qenë edhe gjykimi i shehlerëve të Vleshës. Janë falur gjaqe vëllai e gjaqe biri në saje të ndërhyrjes e të fjalës së imamëve të Vleshës. Dhe për këtë, ata janë vlerësuar e nderuar. Gjeshka e Shehit në Korab është dhuruar nga Radomira për pajtim gjaku. Edhe fisi Abazi është i sheh Ibrahimit. Por ata nuk u morën me shehllëk. I pari i tyre, Abazi, qe ushtarak i lartë i Turqisë.

Vleshasit janë njerëz paqësorë. Në Vleshë s'ka pasur kurrë hasmëri e gjakmarrje. Falë njerëzve të saj, Vlesha ka fituar emër. Kur rastis të paraqitesh (prezantohesh) te një i panjohur, po i the je nga Vlesha, s'ka nevojë për të bërë shpjegime të tjera. Tjetri do të thotë: "A, nga Vlesha?" Një shembull tjetër. Janë larguar, siç u tha, pas viteve '90 shumë familje. Edhe në kohën e socializmit mbi 30 familje nga Vlesha banonin në Peshkopi e gjetiu. Por edhe atëherë, edhe tani nuk janë tëhuajtur. Se tëhuajtja është armik i rrezikshëm i shoqërisë.

Fshati ka moral shumë të lartë dhe marrëdhënie fqinjësore e shoqërore shembullore. As më parë e as tani s'ka pasur grindje e zënka. Më shumë se kaq, vleshasit janë dashamirës me shpirt për të tjerët. Një shembull kuptimplotë: Fshati u fali tokë dy familjeve të nderuara evgjite. Dhe një shembull tjetër: Në të dalë të fshatit, në veri, në krah të Përroit të Shumarenës është një lis i moçëm që quhet Lisi i Vetëm. Po aty, në rrëzë të Lisit ka qenë një varr, që quhej Vorri i Vetëm. Janë, vërtet krejt vetmitarë – edhe Lisi, edhe Vorri. Lisi dhe varri kanë një histori. Është historia e rrugëtarit, të cilit i mbaroi jeta aty e Vlesha e varrosi. Se edhe armik po të të kenë, vleshasit nuk të lënë varrjashtë.

vendlindje

Ky siudhëpërshkrim do të ishte i paplotë, po të mos përmendeshin kopshtet e Vleshës me granabutin e tyre erëndshëm dhe marava e bjeshkës, të cilën nuk mund ta konkurrojë asnjë aromatizues i sotëm në dollape rrobash. Por Vlesha meriton shumë më shumë se një udhëpërshkrim a reportazh. Vlesha meriton një libër...



Vlesha, 1989. Fotografuar nga H.Shehu

Lëre pastaj kur ka mort në fshat. Mortin e bëjnë të tjerët. Familja që ka mort vetëm pret për "Kryeshëndoshë!". Edhe dasmën e bëjnë të tjerët.

Thuajse të gjitha martesat Vlesha i ka bërë me fshatra të Ujemujës (Sllatinë, Sllovë, Shumbat, Palaman, Trojak, Zallë-Kalis, Venisht, Dypjakë dhe Lugjej), me Kalanë e Dodës dhe me Dibrën (Sohodoll, Deshat, Brezhdan, Peshkopi, Grevë etj.), por edhe me Prizrenin. Kanë marrë më shumë nga Kalaja (Tejzi, Cereni, Ploshtani etj.) dhe kanë dhënë më shumë në Dibër, por edhe në Prizren. Kësisoj, janë gërshetuar kulturat. Vajzat e Vleshës janë të shkathëta e të gjalla. E, jo më pak të shkathët e të gjallë janë djemtë. Tri - katër vargje nga dy këngë popullore, besojmë se flasin për këtë: *A s't'paç thanë moj bij* / *Në çardak vetëm mos fij* / *Se t'kobitin gjemt e rij*. Dhe shpotia për dikë që nuk është i shkathët e i zhvilluar: *A s't'paç thanë moj bij,* / *Mos e merr moj bij* / *Sailëshumin-o* (= sylëshuar, sypërmbysur), / *Brezadunmin-o* (= që i dyndet brezi, që i rri brezi nëpër këmbë)?

Vlesha është pjesë e historisë së krahinës. Nga Vlesha ka pasur delegat në Kongresin e Lushnjës / 1920: sheh Zumani. Dhe pjesëmarrës në Kuvendin e Arrasit / 8 gusht 1920: sheh Zumani. Nga Vlesha dolën partizanë në luftën për Çlirim: Abdullah Shehu, Dali Abazi, Hamit Batin Shehu, Hysni Abazi, Mehmet Shira, Nazif Shehu, Ramiz Karçi, Shukri Shehu. Me forcat vullnetare: Ismail Shehu, Kadri Hysa, Xhavit Hysa, Xhetan Hasani. Kanë rënë dëshmorë: Fiqiri Shehu e Dije Abdullah Shehu. Nga familja e nderuar e Abdullah Shehut ka rënë edhe Shkurta. Jo në Luftë e jo për Luftën, se atëherë ajo s'kishte lindur. Ajo ra për mësuesen e për lulet e 7 Marsit. Në Allçanike, tek ai kepi i madh në të hyrë të Vleshës, vogëlushja kishte vënë re se kishte zambakë të egër. Ata çelin herët. Dhe vogëlushja kishte menduar ta kënaqte mësuesen me lule natyrore. U ngjit nga një rrëpirë duke u mbajtur shkurreve. Këmbë pas këmbe, me kujdes të madh mbërriti deri aty afër zambakëve. Dora e saj e vogël i rroku. Në zemrën e saj gufoi gëzimi. Do t'ia çonte mësueses për festë. Bëri të kthehej. Por .... Rrëshqiti këmba e vogël. Dhe ra vogëlushja. Për të mbetur përmendore e dashurisë së nxënësit për mësuesin. Nga Vlesha kanë drejtuar në zonë: Hafiz Shehu dhe Lavdërime Abazi. Në dy legjislaturat e fundit, Vlesha ka dy deputetë: Sadri Abazin dhe Sherefedin Shehun. Ka pasur dy zëvendësministra: Bashkim Shehun dhe Sherefedin Shehun.

Në vitin 1987, në Sllovë, atëherë, qendër e këshillit të bashkuar, u zhvillua një sesion shkencor në shtëpinë e kulturës (fatkeqësisht, tashmë ajo shtëpi kulture është shembur) me të gjithë mësuesit e gjuhës të rrethit të Dibrës për probleme të gjuhës së popullit e sidomos, të fjalëve dhe të shprehjeve popullore. Në fjalën e tij të mbylljes, drejtori i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, profesor Androkli Kostallari theksoi, ndër të tjera, rëndësinë e mbledhjes dhe të pasqyrimit të fjalës e të shprehjes popullore. Duke e konsideruar si detyrë tonën ndaj Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë (sepse kam qenë punonjës shkencor derisa kam dalë në pension) dhe ndaj tërë krahinës, e sidomos, ndaj Vleshës, kemi hartuar një fjalor me fjalë e shprehje popullore nga Ujemuja, i cili do të botohet nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë. Nuk mund të mos e them: Meqë kontaktet më të mëdha i kam pasur dhe i kam me Vleshën, lënda themelore e fjalorit është vjelë nga Vlesha e në Vleshë. Por, sigurisht, kjo lëndë përfaqëson edhe gjithë Ujemujën, sepse është një e folme. Në Vleshë kemi gjetur margaritarë. Nuk na kishte shkuar ndër mend se, përveç *njëzet* e *dyzet,* mund të kishte mbijetoja të tjera paraindoeuropiane të sistemit të numërimit vigesimal (me *njëzet*). Gjetëm fjalën *katërzet* (në shprehjen **asht m'katërzetat** *dikush*). Na është dukur habi që ekzistonte fjala *jutë* në të folmen e fshatit Vleshë e sidomos shprehja **shkoi jutë** *dikush a diçka*. Fjalori i gjuhës shqipe e ka fjalën *jutë,* por jo shprehjen. Fjala *jutë* vjen nga sanskritishtja (gjuhë e vjetër indiane e indoeuropiane). Habia tjetër: Fjala është marrë nga një gjuhë e huaj e shkruar europiane, sepse nuk është siç lexohet (në gjuhën e huaj), por siç shkruhet. Në Vleshë, krejt natyrshëm, kur motra po thurte një triko, përmendi fjalën *reklam*, në thënien: *me mang reklam*. Një kulturë e lartë pune e jetese. Fjala *reklam,* me një shqiptim më popullor e duket, si më të pranueshëm në të folmen e Ujemujës, është për barasvlerësin e huaj *reglan,* me kuptimin "me mëngë që ngrihen te qafa (për pallto, triko etj.)". Palltoja dhe mënyra e saj e qepjes është emërtuar sipas baronit Reglan / 1788-1885, kryekomandant i forcave britanike në Luftën e Krimesë, i cili vdiq në Sevastopol. Nga hetimet tona, fjala njihet në 16 gjuhë të Europës. Njihet edhe në Vleshë. Sigurisht, edhe në gjithë Ujemujën (sepse e folmja e Vleshës është, siç u tha, pjesë e së folmes së Ujemujës). Besojmë, edhe më tej, sepse, siç dihet, sidomos profesionalizmat shtegtojnë.

Çfarë deshëm të thoshim me këta shembuj? Fjala është një dëshmi, një fakt i jetës së njerëzve. Prandaj nga gjuha e popullit mund të marrim, siç marrim frutën nga dega e pemës. Atëherë, të nxitojmë ta mbledhim fjalën e këngën e popullit! Fjalori i Ujemujës e i Vleshës është një e mirë. Por jo e tërë e mira. E tërë e mira është fjalori i së folmes së Dibrës. Por ky fjalor bëhet kur të jenë bërë fjalorët e të folmeve më të vogla – të Shehrit të Dibrës, të Bulqizës, të Lurës, të Kalasë së Dodës, të Katundeve të Epra, të Maqellarës, të Çidhmës, të Katër Grykëve etj. E tërë e mira do të ishte mbledhja e emërvendeve (toponimeve) të të dy Dibrave.

E reja dhe zhvillimi bëjnë, siç dihet, të veten. Kësula e bardhë rrallë shihet në Vleshë e edhe më tej. Edhe koparania e zezë – e zezë për zi për vdekjen e Skënderbeut – rrallë shihet. Edhe tirqit e bardhë me gajtanat e zinj pakkush i mban. Edhe çorapet e leshta me mediskambe e ndortat e bardha s'po shihen më. Edhe kërrabëzat e gjergjefi po rrallohen. Por, bashkë me të renë e zhvillimin e sotëm, festohen bukur festat e hershme, Ditëverja dhe Shëngjergji. Më shumë nga vajzat. Me rite që përcjellin dashurinë për jetën e gëzimin për ardhjen e pranverës dhe të verës. Këtu nuk na duket se ka ndryshime, zvetënim, ndërhyrje e prishje. Po të kisha qenë kameraman, do t'i kisha filmuar të gjitha ritet. Për të tjerët, që nuk i kanë parë. Në natyrë dhe në shtëpi. Sepse me këto rite sikur të vijnë para sysh ajo jeta pagane e konceptet pagane për jetën. Por edhe besimet politeiste pagane – të papranueshme për Islamin. Do të kisha filmuar edhe këngët që këndohen nga vajzat, sidomos këngën që shoqëron lojën "Na jena shqipoja". Do të kisha filmuar edhe zjarret që ndizen mbrëmjeve jashtë. Edhe punën e ngulmët që nis pas Shëngjergjit në bujqësi. Edhe qengjat e ndarë nga mëmat, me blegërimat e tyre të thekshme. Edhe ndonjë sorrë që përvidhet ugareve për të rrokur ndonjë farë misri. Edhe mugullin e sapoçelë me atë ngjyrën e gjelbër të freskët. Edhe qyqen me ku-ku-në e saj. Edhe Përroin e Mullirit me gurgullimën e tij të përhershme.

Loja "Na jena shqipoja" bëhet për Shëngjergj. (Fjala *shqiponjë* njihet më pak, por duket, përdoret këtu për efekt ritmi). Në të vërtetë, nuk duket si lojë, por si një vallëzim i kënduar. Janë dy grupe vajzash. Ballë për ballë, rreth njëzet metra larg në një lëndinë. Veshur me petka ngjyra-ngjyra. Në dy rreshta. Njëri rresht, me duart në bel të njëra-tjetrës, drejtohet për te pala pritëse, duke kënduar: " Na jena shqipoja" dhe refreni. Kthehen gjithë delikatesë në vendin e tyre, duke lëvizur praptas sipas ritmit të këngës. Vjen pala tjetër me po kaq delikatesë "Ç'doni ju shqipoja?" (dhe refreni). Niset pala e shqiponjave: "Duem nji ma t'bukrën" (dhe refreni). – Cila asht ma e bukra? (refreni). Ma e bukra asht I. (refreni). Vajtje-ardhjet dhe kënga vazhdojnë derisa te pala pritëse nuk mbetet asnjë vajzë, sepse të gjitha janë të bukura e të gjitha bashkohen me shqiponjat. Refreni i bukur e shkuarja e kthimi me delikatesë ballas e bëjnë shfaqjen shumë elegante. Natyrisht, për çdo herë që zgjidhet e bukura, sytë e vajzave shkëlqejnë. Cila do të jetë e bukura më e parë? Po më pas? Cila është preferenca? A ka këtu anësi e miqësi? Besojmë se ka. E kjo e bën më të bukur garën, zgjedhjen, shfaqjen. Sidoqoftë, të gjitha vajzat janë të bukura, sepse në rreshtin e tyre nuk mbetet asnjë. E, kështu të gjitha kënaqen.

Ky siudhëpërshkrim do të ishte i paplotë, po të mos përmendeshin kopshtet e Vleshës me granabutin e tyre erëndshëm dhe marava e bjeshkës, të cilën nuk mund ta konkurrojë asnjë aromatizues i sotëm në dollape rrobash. Por Vlesha meriton shumë më shumë se një udhëpërshkrim a reportazh. Vlesha meriton një libër. Atij, që do të shkruante librin, i duhet të flasë për historinë e fshatit, për fiset, për punën e jetën e fshatit në kohë e në vite; për shkrumbimin e fshatit nga hordhitë pushtuese serbe, për ikjen e të gjithëve – me fëmijë e me gra – në Tiranë, për peripecitë dhe vuajtjet gjatë rrugës e në Tiranë, për kthimin pas tre vjetësh në vendin e shkrumbuar; për dashurinë e vleshasve për vendlindjen (në parantezë: Mixha Jeshar, / Jeshar Shehu - tregonin pleqtë, - mërguar në Turqi, por shumë i pasur, u ishte lutur ta merrte gjithë mëhallën në Turqi, madje t'ua ruante edhe atje emrin Vleshë; por nuk kishin pranuar se nuk mund ta linin Vleshën); për kontributin e tyre në çlirimin e vendit nga pushtuesit fashistë e nazistë; për punën ndërtimtare pas Çlirimit; për shkollat e për shkollarët; për mjekët popullorë; për solidaritetin e ngarendjen e të gjithëve në raste hallesh të mëdha; për rrugën e gjatë, me kalë e më këmbë për në Tiranë në vitet '30 e '40 të shekullit të kaluar për të blerë vaj guri e kripë; për kalldrëmin që niste në të dalë të fshatit e shkonte deri te Kodrat e Mullijve e që u mbulua me zhavorr e rërë (!), se na u bë unaza; për gatimet e pastra e të shijshme; për ngrënien veças që në vitin 1960 në familje të veçanta e më pas, në të gjithë fshatin; për dasmat e për këngët e dasmave; për odat e kuvendimet e holla në oda. Për çfarë tjetër? Për tërë jetën dinjitare të vleshasve.

Ferma “Kaloshi” rritet nga viti në vit. Diku shtohet numri i hektarëve të mbjellë, diku numri i krerëve dhe rendimenti.

Kaloshët e Kandrrit, *një histori suksesi mes traditës dhe punës*



Kushedi sa herë kullat hijerënda të Kaloshëve u qëlluan me topa dhe armë të rënda luftarake, në përpjekje për të thyer qëndresën e njerëzve që mbronin trojet e tyre. Po kaq konkret dhe i fuqishëm ishte reagimi i Kaloshëve dhe ndaj pushtuesve italianë e gjermanë. Ata morën pjesë me armë në dorë për çlirimin e vendit nga të huajt.

Nga **Osman XHILI**

Duhet të jenë mbi dy-tre shekuj qëkur Kaloshët e Kandrit kanë zbritur nga zona e Hasit dhe janë ngulur në trojet e sotme. Arsyet nuk dihen saktë. Mund të ketë qenë ndonjë hasmëri, por ndoshta dhe tokat e begata që zunë, mund të kenë qenë një karrem dhe shkak i fuqishëm për ta bërë një lëvizje të tillë. Fillimisht, ata zunë vend në Sinë të Epërme, ku dhe sot janë disa familje të këtij fisi. Më pas u bë lëvizja e dytë për në tokat e Kandrit.

KALOSHËT, NGA HISTORIA NË DIKTATURË

Fisi Kaloshi solli me vete cilësitë më të mira që pati, si trimërinë, burrërinë, besimin, dashurinë për vendin dhe shpejt u bë pikë e fuqishme referimi për banorët e këtushëm. Ata luftuan kundër serbit në shumë beteja, ku vlen të përmendet historia e Murat Kaloshit në luftën e Kolesjanit. Bashkë me patriotë dhe aktorë të tjerë, i shkaktuan dëme të pallogaritshme makinerisë luftarake serbe. Kushedi sa herë kullat hijerënda të Kaloshëve u qëlluan me topa dhe armë të rënda luftarake, në përpjekje për të thyer qëndresën e njerëzve që mbronin trojet e tyre. Po kaq konkret dhe i fuqishëm ishte reagimi i Kaloshëve dhe ndaj pushtuesve italianë e gjermanë. Ata morën pjesë me armë në dorë për çlirimin e vendit nga të huajt. Por, fatkeqësisht, komunistët dhe paritë e mëdha qenë në një pikë e në një drejtim deri në prag të çlirimit të vendit. Më pas gjërat morën kahe të ndryshme. Paritë e mëdha, aleatët e dikurshëm të komunistëve, u persekutuan, u denigruan, u zhveshën nga pronat dhe u burgosën e internuan. Dhe sot e kësaj dite disa familje të këtij fisi të shquar kanë mbetur në Savër të Lushnjes apo diku tjetër, që nga koha e internimeve famëkeqe. Të tjera familje kanë ikur në Amerikë, Kanada, Tiranë dhe kudo kanë treguar vlerat më të mira që ato mbartnin.

VITET ‘90, RIKTHIM NË TRADITË

Vitet nëntëdhjetë. Kohëra të reja për fisin Kaloshi, si për gjithë Shqipërinë. Një demokraci e brishtë, e gjymtuar, por sidoqoftë, shumë më ndryshe nga diktatura që përjetuam. Tomor Kaloshi, një nga pinjollët e këtij fisi të shquar, thotë se disa gjëra i rifituam e ca të tjera kishin humbur pothuaj përgjithmonë. Si mund ta kthente kohën mbrapa Tomori, nxënësi i shkëlqyer i shkollës së mesme, i talentuar në matematikë. Auditoret e shkollës së lartë kishin qenë të ndaluara për të dhe vetëm fëmijët e tij do të kishin luksin ti preknin e ti shijonin. Ishin vitet e para të demokracisë dhe Tomori bashkë me vëllezërit e tij u ulën për ti pleqëruar gjërat. Duhej punë dhe mençuri. A do të ishin ata të aftë të ribënin histori, të ngrinin dhe njëherë në maja të larta emrin e fisit që përfaqsonin. Apo e kishin humbur lavdinë njëherë e përgjithmonë e ajo kishte mbetur vetëm në fletët e historisë dhe kujtime gojore.

BUJQËSIA DHE BLEGTORIA, RRUGA E SUKSESIT

Për gati pesë vjet, tre vëllezërit, Tomori, Miftari dhe Agroni punuan bashkë. Ata disponojnë 200 dynymë tokë bujqësore, pa llogaritur bjeshkën e Derëzës në Gramë, zabelet e shumta, apo tokën tjetër në përdorim. Më pas, Tomori u mor me aktivitet bujqësor e dy të tjerët u lidhën me blektorinë, me delen dhe lopën. Miftari dhe Agroni, tëdy sëbashku, mbarështojnë jo pak, por 500 krerë dhen, për të cilat shfrytëzojnë dhe kullotat e tyre. Po kështu janë në zgjerim të kapaciteteve për të trasha, duke e kthyer fermën Kaloshi në një pikë referimi për fermerët e tjerë të Dibrës. Gruri, misri, jonxha, fasulja e të tjera kultura, i gjeje vazhdimisht të pranishme në fermën e tyre. Në vitin 2002, Drejtoria e Bujqësisë Dibër, bashkëpunon me Institutin e misrit dhe të orizit në Shkodër në lidhje me prodhimin e farës së misrit elitë nga linjat nënë dhe babë. U vendos që kjo procedurë të instalohej në fermën Kaloshi,në Kandër. Sipërfaqja e madhe e tokës krijonte mundësinë që eksperimenti të mbahej larg nga misri tjetër i zakonshëm. Tomori punoi me një përkushtim maksimal si një shkencëtar i vërtetë. Çdo ditë i hiqte xhufkat e linjës nënë, si një element shumë i rëndësishëm i prodhimit. I bënte të gjitha shërbimet deri në vjelje, largonte ndonjë kalli që nuk ishte i llojit, këpuste majat e tyre, në mënyrë që fara e prodhuar të ishte sa më cilësore e të realizonte maksimalisht pritshmëritë e njerëzve. Rezultatet ishin të kënaqshme. Merrej rreth 18 kiuntalë për hektarë dhe njerëzit filluan ta kërkonin farën e misrit që prodhohej tek Tomori, apo siç njihet nga fermerët me emrin “misër 111”.

JONXHA, SUKSESI I RI I FERMËS

Për vite me radhë Tomor Kaloshi është marrë me prodhimin e jonxhës dhe të farës së jonxhës, duke i çuar gjërat në perfeksion. Ai thotë se ne kemi një lloj autokton jonxhe me vlera të larta gjenetike, jonxhën Tomini. Por kjo nuk do të thotë që mos të provohen dhe eksperimentohen lloje të tjerë produktivë. Në vitin 2007, dy specialistë të Institutit të foragjereve në Fushë Krujë, Ismet Boka dhe Rushit Suna, ngrejnë tek Tomori një eksperiment, ku do të provoheshin tetë varitete jonxhe. Krahas llojit *Tomini*, u mbollën dhe lloji *Italian, Prosiment, Alfa Romeo, Krima, Gjigandi,Tomini* etj. Tri vjet vëzhgime, studime dhe konkluzione. Cili nga varitetet do të kishte treguesit më të lartë të produktivitetit dhe te rezistencës? Prosimenti Italian u rendit i paripas sondazheve të bëra. Kishte rritje të bujshme të llastarëve, gjatësimë të madhe, më shumë gjethe, më shumë rezistencë. Por dhe lloji *Tomini*, nuk qëndronte shumë poshtë për nga treguesit.



Kullat e Kaloshëve



Tomor Kaloshi me dy specialistë të bujqësisë Dibër

Tomor Kaloshi ka mbjellur pesë hektarë jonxhë dhe këtë vit do të shtojë dhe tre të tjerë. Jonxha, thotë ai, është një nga kulturat që ta shpërblen më mirë. Ajo mund të shitet si masë e njomë, e thatë, apo si farë jonxhe. Një hektar, në kushte të mira mund tëprodhojë pesë kuintalë me një çmim 600 lekë/kg,duke i sjellë jo pak të ardhura ekonomisë familjare. Fara e jonxhës që prodhon Tomori kërkohet shumë nga njerëzit, pasi veç të tjerash ka një pastërti maksimale nga kuskuta, një element shumë i rëndësishëm ky në vlerësim. Fermeri i kujdesshëm, në mungesë të një triori të mirëfilltë, ka sajuar një ventilator special, i cili mrekullisht ndan farën e jonxhës nga ajo e kuskutës, pasi kjo e fundit duke qenë më e lehtë, shkonte më larg.

FERMA, E ARDHMJA DREJT TURIZMIT

Ferma “Kaloshi” është lëkundur shumë herë, si një anije në det të trazuar. Cili do të jetë drejtimi i duhur i saj?Cilat do të jenë prioritetet?Me çfarë fitohet më shumë?Cilat produkte kanë më shumë para dhe siguri në treg?Misri, gruri, jonxha, apo të treja së bashku. Mos ndoshta i duhej dhënë fund shitjes së misrit e jonxhës e ti përdorte këto prodhime në fermën e tij të lopëve? Duke analizuar faktorët “pro” dhe “kundër”, Tomori vendosi të mbarështojë të trashat në fermën e tij. Ai e kishte një stallë që nga koha e monizmit, të cilën e përshtati akoma më mirë. Deri tani në të ushqehen 20 krerë. Por si do të vazhdojë më tej?Të tjera dyshime e pikëpyetje. Tregu i qumështit është i pasigurtë dhe ata e tregtojnë me shishe, duke u lidhur me disa dyqane të qytetit. Por dhe sektori i mishit ka problematikën e vet. Asnjë kontratë, asnjë garanci. Por, Tomori sërish beson tek zgjedhja e re, pasi ushqimet i prodhon në fermën e tij dhe nuk ka nevojë ti shesë diku. Ana tjetër e medaljes, është plehu, pa të cilin vështirë se ka rritje prodhimi në fermë.

Ferma “Kaloshi” rritet nga viti në vit. Diku shtohet numri i hektarëve të mbjellë, diku numri i krerëve dhe rendimenti. Është shtuar një zetor dhe disa paisje që e shoqërojnë atë. Janë përmirësuar kultivarët dhe teknologjia e prodhimit. Në krah të Tomorit qëndrojnë dy djemtë, që kanë mbaruar shkollimet e larta e prapë e duan fermën dhe punën e nisur nga babai i tyre. Më i vogli, Bestari, ka mbaruar universitetin bujqësor të Tiranës dhe ka ide konkrete se si do ta zhvillojë fermën në të ardhmen. Ndoshta, mendon dhe për turizmin duke shtuar pula, gjela deti, pak të imta, për ti dhënë më shumë grim e kolorit fermës së tyre. Po kështu, kullat e vjetra të familjes, mund të shërbejnë si bujtina për mysafirët, ashtu siç shërbyen dhe në rini të tyre për të njëjtin qëllim. Kaloshët disponojnë dhjetëra hektarë kullota të bukura e të pasura në polifite, në Gramë të Korabit. Derëza, siç quhet bjeshka e tyre e bukur në majat e Korabit, është një tjetër resurs për blektori dhe atraksion për turizëm. Kështu, me këmbë në tokë, por dhe me vështrimin nga e ardhmja, ferma Kaloshi, Tomori, Miftari dhe Agroni, bashkë me fëmijët, dhe me kushërinj do të jetë një faktor i rëndësishëm, pikë referimi për fermerët e tjerë dhe qendër studimore dhe eksperimentale.

veprimtari



Musa Riçku duke marrë titullin "Qytetar Nderi" nga kryetari i Bashkisë së Dibrës, Shukri Xhelili (djathtas) dhe kryetarja e Këshillit Bashkiak, Lulzime Dani. Majtas, moderatori i veprimtarisë, Defrim Methasani

Foto: Zaim Elezi

"Model më të shkëlqyer sesa mbështetja e veprimtarive kulturore deri te librat e bursat për arsimim, është të investosh për një perspektivë, për një projektim të shoqërisë sonë në një nivel akoma më të mirë, më humanist, më të ndriçuar. Dhe në fund të fundit, kjo ka qenë puna e humanistëve në të gjitha shekujt. Forcat e së mirës janë ato që orientojnë nga kultura e të gjitha niveleve, ndër to edhe e besimit"

Agron Tufa.

Musa Riçku, "Qytetar Nderi" i Dibrës

Mbi 600 dibranë u mblodhën më 20 maj në Hotel Tirana, në ceremoninë e dorëzimit të titullit "Qytetar Nderi", promovimin e librit "Musai - portret i njeriut fisnik", shfaqjen e dokumentarit dhe festimin e 60-vjetorit të lindjes.



Tre gëzime në një ditë është e rrallë të ndodhin, por për Musa Riçkun tre të tilla u bashkuan më 20 mars në Tiranë. Familjarë, miq e bashkëpunëtorë të tij u mblodhën në Hotel Tirana për të festuar 60 vjetorin e lindjes, përurimin e monografisë kushtuar tij, si dhe titullin "Qytetar Nderi" dhënë nga Këshilli Bashkiak i Dibrës.

Të pranishëm në veprimtarinë e organizuar nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë ishin deputetët Ulsi Manja, Sherefedin Shehu, Përparim Spahiu dhe Sadri Abazi, kryetari i Bashkisë së Dibrës, Shukri Xhelili, kryetari i Bashkisë së Dibrës së Madhe, Ruzhdi Lata, kryetari i Bashkisë Bulqizë, Melaim Damzi, kryetarja e Këshillit bashkiak Lulzime Dani, prefektja Donika Hyseni, miq e bashkëpunëtorë të Musait në vite, familjarë e bashkëfshatarë, etj.

Veprimtaria, e cila u moderua me shumë profesionalizëm nga babë e bijë, Defrim e Lunada Methasani, nisi në orë 1100 të ditës së diel dhe zgjati më shumë se 2 orë.

E para e mori fjalën Prof. Edlira Haxhiymeri, e cila bëri një ekspoze të jetës së Musait, si dhe një panoramë të shkurtër të veprimtarisë së tij, kryesisht në dhjetë vitet e fundit, edhe si nënkryetar i Shoqatës.

MUSAI, MODELI I HEROIT TË SHOQËRISË SË SOTME

"Ky është një rast fatlum, që na mundëson të gjithëve të meditojmë se sa shumë sfida ke përballuar në jetën tënde të vrullshme, se si këto sfida brumosën tek ty, i nderuar Musa, modelin e një njeriu këmbëngulës, "modelin e heroit të shoqërisë së sotme", - thekson znj. Haxhiymeri gjatë fjalës së saj.

Më pas, ajo bën një përshkrim të biografisë së Musait, që nga familja, shkollimi, puna si mësues e në galeritë e Bulqizës, si biznesmen i suksesshëm e si njeri aktiv i shoqërisë civile, në mbështetje të kulturës, sportit, objekteve të kultit etj. *(Fjala e plotë e botuar në 10-11)*

Pas fjalës së kryetares së LID, ishte radha e sekretarit të Shoqatës LID dhe anëtarit të kryesisë për t'i dorëzuar Musait Mirënjohjen nga LID për "Për kontributin e dhënë në krijimin, organizimin dhe funksionimin e Shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, jo vetëm si nënkryetar i saj, por edhe si mbështetës, promovues dhe kontributor në të gjitha veprimtaritë e Shoqatës që nga themelimi i saj".

Pas fjalës së rastit, një dokumentar prej 25 minutash, përgatitur nga Defrim Methasani, u shfaq në sallën e Hotel Tirana, mbushur plot si asnjëherë më parë. Dokumentari ishte një përmbledhje filmike eveprimtarisë dhe kontributit të Musa Riçkut në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore të shoqërisë dibrane dhe më gjerë. Ai evidentonte edhe përmes dëshmive gojore kontributin e tij në vitin e vështirë 1997 si dhe rolin e tij në promovimin e objekteve të kultit, botimit të librave, veprimtarive kulturore e sportive, siç janë Oda Dibrane dhe Klubi Korabi, botimin e gazetës "Rruga e Arbërit" e deri te ndihma më e fundit në ekipin e volejbollit, që po ecën me plot sukses në këtë sezon.

FORCAT E SË MIRËS JANË ATA QË ORIENTOJNË NGA KULTURA

Shkrimtari Agron Tufa foli shkurtimisht rreth librit "Musai - portret i njeriut fisnik", shkruar nga Shaqir Skarra.

"Unë kam qenë në këtë sallë shumë herë, në konferenca a tubime, - tha ai në fillim të fjalës, por ka qenë gjithmonë një sallë e ftohtë dhe me vende bosh. Kjo sallë e mbushur plot, tregon se kjo është fryma që ky njeri ka bërë aq të mira e vepra sa nuk i rendit dot në lista".

"Të gjithë do ta dëshironin një 60 vjetor të tillë të ngjashëm, me një bilanc të tillë njerëzor e humanist, kur hedh sytë pas, shikon se ke krijuar një perandori të së mirës, - theksoi Tufa. - Unë besoj se këtë Musa Riçku e ka krijuar.

Më pas, ai u ndal në një prej aspekteve që e çmon shumë fort te Musai.

"Ti gjendesh një njeriu në nevojë është një gjë madhështore, por të marrësh përsipër të ndihmosh kulturën shqiptare që përjeton ditët e saj më të rrezikshme, më të thata, të vësh dhe të krijosh një gjest të tillë të mbështetjes së një game aktivitetesh kulturore, do të thotë që të përpiqesh dhe të krijosh një perspektivë, t'u japësh një kurajë këtyre njerëzve që nuk shpërblehen në lekë. Kultura është ajo që na ka përfaqësuar në shekuj e po të mos ishte ajo, ne nuk do të kishim asnjë lloj identiteti dhe nuk dihet nëse ne do të flisnim shqip sot njëri me tjetrin", - tha Agron Tufa.

"Në Shqipërinë e postkomunizmit ka pasur mjaft biznese të suksesshme, madje ka nga ata që për nga pasurie ku e ku nuk krahasohen me Musain, por problemi është se nga shumësia e këtyre parellinjve që pati Shqipëria, ne nuk prodhuam dot mecenatë, në kuptimin latin të fjalës, që të marrin përsipër të ruajnë veprat e kulturës e të artit e letërsisë, t'i mbronte ato që të mos shkatërroheshin dhe të bënte ç'është e mundur që modelet e kësaj kulture të përhapeshin dhe të bëheshin vlerë e njerëzimit".

"Model më të shkëlqyer se sa mbështetja e veprimtarive kulturore deri tek librat e bursat për arsimim, është të investosh për një perspektivë, për një projektim të shoqërisë sonë në një nivel akoma më të mirë, më humanist, më të ndriçuar. Dhe në fund të fundit kjo ka qenë puna e humanistëve në të gjitha shekujt. Forcat e së mirës janë ata që orientojnë nga kultura, e të gjitha niveleve, ndër to edhe e besimit", - tha shkrimtari i njohur Agron Tufa.

Më pas, ai lexoi poezinë e tij kushtuar dajës Musa, me titull "Shtegu", e cila është e vendosur edhe në pjesën e brendshme të kopertinës së librit. Agron Tufa ka folur edhe në parathënien e librit, por leximi i poezisë së posaçme i dha një kënaqësi të veçantë sallës.

"Është privilegj për mua të flas sot, kur shikoj që salla është mbushur plot dhe jam e sigurt që gjithkush prej jush dëshiron t'i thotë dy fjalë për Musa Riçkun, këtë njeri të mirë dhe për të cilin

(Vijon në faqen 11)

Njeriu i ndershëm i punës!



Nga **Prof. EDLIRA HAXHIYMERI**
Kryetare e LID

Është kënaqësi për të gjithë ne, të mblidhemi sot këtu së bashku e të ndajmë gëzimin për tre momente të shënuara për Musain, bashkëshorten, fëmijët dhe të afërmit: Përvjetorin e lindjes së Musait, Promovimin e librit kushtuar jetës dhe aktivitetit të tij "Musai – portreti i njeriut fisnik", përgatitur me dashuri e profesionalizëm nga zoti Shaqir Skara, si dhe nderimin që i bëri Musait Këshilli Bashkiak i Dibrës, duke i akorduar titullin e lartë "Qytetar Nderi"

Është një privilegj i veçantë, por edhe përgjegjësi e madhe për mua që, në emër të Shoqatës së Intelektualëve Dibranë të jemi pjesë e këtij gëzimi të ligjshëm e të merituar dhe të të uroj "Jetë të gjatë e gëzime pafund për ty dhe familjen tuaj"!

Njëherësh, ky është një rast fatlum që na mundëson të gjithëve të meditojmë se sa shumë sfida ke përballuar në jetën tënde të vrullshme, se si këto sfida brumosën tek ty, i nderuar Musa, modelin e nje njeriu këmbëngulës, "modelin e heroit të shoqërisë së sotme" - siç ka theksua me të drejtë Agron Tufa.

(Vijon në faqen 10)

Rruga e Arbërit nr. 119

“Ai vërtet bën 60 vjet, por është në kulmin e moshës për t’i shërbyer humanizmit dhe Dibrës. Gjithçka e ka bërë tërësisht nga pozitat e një njeriu të lirë, e një biznesmeni të suksesshëm që gjithçka e ka arritur falë punës, mundit, djersës dhe kontributit të vet, personal, familjar, të fëmijëve të tij. Musai nuk është thjesht “Qytetar Nderi” i Dibrës, është “Nderi i Dibrës”.

Njeriu i ndershëm i punës!

(Vijon nga faqja 9)

Ju sapo keni mbyllur dekadën e gjashtë të jetës suaj dhe ndryshimi i prefiksit mund t’ju sjellë natyrshëm edhe ndonjë emocion! Nuk duhet të ligështoheni! Vitet janë thjesht numra! E rëndësishme është se si njeriu i jeton ato! E rëndësishme është vepra jote, bëmat tuaja, të ngjizura këto në personalitetin tuaj ndër vite. Dhe ato nuk janë të pakta. Ato e bëjnë njerëzor, të dashur, por edhe me plot ngjyrë e shkëlqim gjerdanin e jetës suaj, i nderuar miku ynë Musa.

Nuk ishte e lehtë që të kërkoja, të radhisja e të prezantoja përpara jush copëza nga jeta e Musait, kujtime të aktiviteteve të shumta të tij si familjar, qytetar, biznesmen, si kontributor i shquar e mbështetës i pakursyer në zhvillimin e promovimin e vlerave kulturore për Dibrën tonë të dashur, siç theksohet me të drejtë edhe në motivacionin e titullit “Qytetar Nderi”. Nuk ishte e lehtë sepse këtu kemi përpara një libër të gjallë, siç është vetë Musai, të cilin e kemi njohur në momente nga më të ndryshmet, kemi përshtypjet e kujtimet tona të vyera, por edhe sepse sot kemi në dorë një libër mjaft interesant, që nëpërmjet një narracioni të arrirë artistik, na jep Musain si një pikë referimi për këdo që mund ta lexojë sot, por edhe në të ardhmen. Ky libër është një kumt për veprën dhe figurën e Musait që do t’u përcillet brezave por edhe një apel për të mos harruar sfidat e sakrificat e sotme dhe për të parë me besim drejt të ardhmes. Eshtë e vështirë pra për mua të radhis të gjitha sfidat, kontributet dhe vlerat që kanë dominuar jetën e një njeriu të thjeshtë, në pamje të parë, por njëherësh edhe shumë kompleks, të pasur në shpirt e në jetën e përditëshme.

Jeta e tij tepër aktive që nga fëmijëria, në shkollë, nga biznesi tek sporti, nga fshati i tij i lindjes tek dibranët e vendosur në Tiranë, nga xhamia apo tek kontributi për shoqatën e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë, personaliteti i tij shumëdimensional, rrethi i gjërë i bashkëpunëtorëve, fisi i madh dhe lidhjet e shumëfishta për arësye njerëzore, e bëjnë të vështirë, gjithësesi, përpjekjen time modeste për të prezantuar në mënyrë shteruese figurën e Musait në një aktivitet si ky.

Megjithatë, unë e kam ndërmarrë këtë sfidë, me shpresën se do t’ja dal të evidentojë ato cilësi të rëndësishme që formësojnë figurën e një veprimtari të shquar, siç është Musa Riçku.

Më lejoni ti nis këto shënime për Musain duke ju referuar një mikut tonë të përbashkët: “Në rrjedhën e humanizmit, solidaritetit, burrërisë dhe patriotizmit dibran pa asnjë lloj dyshimi bën pjesë edhe Musa Riçku i Limjanit. Musai me virtytet dhe tiparet e një fisniku, i ka vënë obligim vetes gjithmonë të gjendet aty ku ka nevojë, varfëri dhe mençuri. Të varfërit i jep bukë, të mençurin e stimulon të jetë aktiv dhe të punojë më shumë”. Dhe vazhdon më tej: “Në asnjë vend ku jetojnë shqiptarët, Musa Riçku nuk është jabanxhi, por është vendas dhe njeri i shtëpisë”, nënvizon zoti Rruzhdi Lata, Kryetari i Komunës së Dibrës së Madhe. E pra ky misionar i së mirës i ka dyert e hapura në të gjitha trojet e banuara nga shqiptarët sepse personaliteti dhe figura e tij, njerzillëku i tij, thjeshtësia dhe dashuria që ai rrezaton nuk ka nevojë për ndërmjetës midis tij dhe komuniteteve shqiptare kudo që ata jetojnë.

Investimet në ndërtimin e xhamive, për libra e për shkollën, për veshje e ushqim për njerëzit në nevojë e bëjnë Musain një ambasador të Limjanit, të Dibrës e më gjerë, me të cilin krenohemi të gjithë, thekson Haxhi Ahmet Çaushi. Lindur në Limjanin e bukur dhe piktoresk, Musai kultivoi në personalitetin e tij të gjithë të mirat natyrore e sociale të këtij fshati-ballkon, për nga pozita gjeografike. Ai u rrit në natyren e pastër e të bukur te Limjanit, por edhe në pasurinë e madhe shpirtërore të banorëve të fshatit e të krahinës. Merita e Musait qëndron në atë se ai i manifestoi me besnikëri këto cilësi natyrore e sociale kudo që dallgët e jetës e çuan. Ai i mbarti ato me



Kryesia e LID, Shaban Bitri, Edlira Haxhiymeri dhe Shpëtim Cani duke nderuar me Certifikatë Mirënjohje Musain

fanatizëm, me pasion, dhe kudo që ai jetoi e punoi u bë një trasmetues besnik i tyre, duke u bërë kësisoj ambasador i kredencialeve të fshatit të tij të lindjes, Limjan, por edhe të krahinës së Dibrës.

‘Musai Riçku modest, nuk harron të kthejë kokën pas për të parë sokakët e shtigjet ku është rritur e ka punuar, ku duken gjurmët nga e nisi shtegëtimin, për t’i dhënë kuptim të plotë jo vetëm jetës së tij, ashtu si edhe dibranët e tjerë, që i kanë rritur dhe pasuruar vlerat me punë, por edhe duke lënë dëshmi krenarie prej njeriu me veti misionari’, thekson Ilir Balili.

Lindur në Janar 1956 në Limjan, mbaron shkollën 7 vjeçare në vitin 1970 po aty, kryen studimet në shkollën Pedagogjike të Peshkopisë në vitet 1970-74 dhe merr diplomën e mësuesit, ushtron profesionin e mësuesit në fshatin Lajthizë 1974-76, vagonist në Bulqizë për të kryer stazhin, në shkollën e Zall Herrit në Tiranë në vitet 1977-78, ku edhe diplomohet oficer, 1979 titullohet oficer aktiv në ushtri, Prill 1979 oficer me detyrë instruktor pranë shkollës së lirë ushtarake në Zogjaj, 1979-1980 kryen shkollën e MPB në Sauk dhe kthehet oficer ne Bulqizë deri në vitin 1983, disa transferime e lëvizje gjatë viteve 1983-1991 në cilësinë e oficerit.

Në 1992 largohet nga detyrat ushtarake. Dy herë tentoi të shkonte refugjat në Greqi, por nuk e joshi kjo aventurë e rrezikshme dhe kthehet në Dibër në Tetor 1992.

Në këtë vit Musai filloi një jetë krejt tjetër, jetën e një biznesmeni. Si shumica e biznesmenëve të kohës filloi me tregëtinë, duke bërë rrugën Tiranë-Dibër në shi e borë, në ngrica e acar. I gëzohej jo vetëm biznesit por edhe faktit që u gjendej pranë fshatarëve të zonës në përballimin e vështirësive për mbijetesë. Në rolin e biznesmenit, jo rrallë të filantropit e misionarit, po shpalosej një nga cilësitë më të mira të Musait, ajo e solidaritetit.

Siç na tregoi Hasia, bashkëshortja e Musait, ditën e Bajramit të parë pasi Musai kishte filluar aktivitetin tregëtar, hartoi një listë me 30 familje të varfra të fshatit të tij, u dërgoi haber që ato të vinin aty në dyqan, u dha nga një pako me ushqime dhe bashkë me to edhe urimin për ta festuar edhe ata të gëzuar ditën e Bajramit. Ky akt prej misionari, bamirësi e solidari do të bëhej tipari më esencial i biznesmenit të adhshëm Musa Riçku.

Kolegu im Agron Tufa në parathënie të librit ‘Musai – portreti i njeriut fisnik do të theksonte: Shoqëria jonë në këtë çerekshekulli të postkomunizmit ka parë me habi, se si, se kush, se në çfarë rrugësh e rrethanash janë ngritur bizneset e pasuritë marramendëse, madje pasuri përrallore pa pikën e djersës, të krijuara brenda një viti, brenda një mandati, brenda një muaji, brenda një dite, sa hap e mbyll sytë. Shumëkush e di se në shpinë të kujt janë krijuar këto pasuri, këto perandori të përgjakshme financiare: përmes korrupsionit, mashtrimit, trafiqeve etj. Një fizionomi e llahtarshme, një katastrofë morale e origjinës së tyre. Instikti i mençur popullor e di, ia qëllon, andaj u rri ftohtë dhe në heshtjen e tij nuk ia bën “hallall”.

Por për fat të mirë, ka një tjetër racë biznesmenësh si Musa Ricku, të cilët, ndonëse të rrallë, e kanë nisur nga hiçi falë punës së gjatë këmbëngulëse, duke patur me vete si aleatë vetëm mundin e djersën dhe si pajë - durimin, karakterin e papërkulshëm para vështirësive edhe kur gjithçka e kanë kundër dhe, sidomos, shpresën dhe besimin se Zoti ka për t’i nxjerrë faqebardhë.

Historia e tij (Musait) përbën simbolikisht një histori përfaqësuese të një klase njerëzish të suksesshëm, të cilët janë shpirti i ndershëm dhe korniza e kulluar morale e Shqipërisë në këta 25 vite lirie të trazuara. Ne e ndjejmë, e prekim nga afër dhe na mbush me krenari e mirënjohje fakti, që kanë ndodhur edhe histori të suksesshme me origjinë të pastër e të ndershme, prej punës këmbëngulëse. Kjo i jep vlerë e moral shoqërisë sonë dhe përbën zemrën e sinqeritetit për arritjet e merituara, e mbyll vlerësimin e tij Agron Tufa.

Musai përfaqëson atë racë biznesmenësh të këtyre 25 vite, që nuk iu fshehën ligjit, shtetit, detyrimeve e përgjegjësive administrative e fiskale. Kanë qenë të huaja për Musain mashtrimi, rruga e shkurtër për fitime të pamerituara e abuziviste. Ai i besonte vetëm punës së ndershme, pa hile, pa dredhira e pa kompromet ime. Djersa e ballit të Musait ishte e pastër si kristali, ishte ajo e një shënjtori dhe njeriu të devotshëm, të sakrificës por edhe të ndershmërisë deri në adhurim.

Prandaj edhe Zoti e ka bekuar aktivitetin e tij dhe të të gjithë familjes.

Figura e Musait do të ishte paplotë pa aspektin e saj familjar, atë të birit, bashkëshortit, babait, mixhës, dajës, kushëririt, gjyshit. Musai pasqyron dashurinë e devocionin e madh për prindërit, respektin e vlerësimin e madh për bashkëshorten po edhe dashurinë dhe përkujdesjen e pamatë për fëmijët e nipat e mbesat e tij. Kam patur privilegjin që unë dhe bashkëshorti im të kishim student në Universitetin e Europës JL të Tetovës djalin e dytë të Musait, Erionin. Ne e ndjenim nga afër raportin e shkëlqyer prind-fëmijë që reflektohej tek ai djalë i mbarë e që ecte i sigurtë në rrugën që i kish çelur me devocion, ndershmëri e dashuri babai i tij.

Është fat të kesh një familje kaq të mirë. Por është edhe zotësi e pjekuri për ta kultivuar atë. Unë besoj se Musai ia ka dalë kësaj, me ndihmën e pakursyer të Hasies, bashkëshortes, padyshim i ndihmuar nga modeli i përkryer që trashëgoi nga baba Haziz e nana Dudija për të ngritur një familje që reflekton të gjitha vlerat pozitive.

Është jo vetëm fat, por edhe emancipim.

Musai ka lënë gjurmë edhe në aktivitete kulturore. Kultura është një mënyrë e të reflektuari ndaj një realiteti. Kultura është koncept i gjërë. Kultura e punës, kultura e jetesës, kultura e banimit, kultura sociale, kultura politike etj. Musai na vjen e prezantohet si një figurë që aspekte të ndryshme të kulturës i ka plazmuar në karakterin e vet hap pas hapi. Musai, gjatë kohës që vazhdonte mësimet në shkollën pedagogjike do të zgjidhej si një nxënës me prirje edhe në fushën kinematografisë, si pjesmarrës në filmin “Malet me blerim mbuluar”, në krah të artistit të popullit Vangjush Furrxhiu. Në se Musai do ta kishte kultivuar këtë prirje, mund të kishim sot midis nesh një artist. Por, Musai kontribuoi dhe vazhdon të kontribuojë në Odën Dibrane, kësaj vatre të kulturës për krahinën e Dibrës. Aty është kultivuar dhe vazhdon të kultivohet jo vetëm folku dibran por edhe elementë të tjerë etnokulturorë. Musai është një nga sponsorizuesit e Odës Dibrane prej 21 vitesh, tashmë.

Musai ka qenë një dashamirës i flakët i klubit



shumësportësh “Korabi”. Nga vetë emri që ka mbajtur ky klub, atë të malit të Korabit, ai është kthyer në një pikë referimi për çdo dibran kudo që ai/ajo jeton.

Klubi i sportit të një qyteti nuk përfaqëson thjesht një ekip. Përkundrazi, ai është përfaqësues e kultivues i kulturës sportive, aq e domodoshme kjo për këtë krahinë të nderuar. Është kjo arsyeja pse Musai ka qenë një sponsorizues e mbështetës i këtij klubi, i kulturës sportive në përgjithësi, e cila godiste e vazhdon të godasë edhe sot normat kanunore e konservatore të jetës së përditëshme të banorëve të zonës.

Musai nuk është tërhequr para vështirësive e pengesave. Përkundrazi, ai sfidat i ka parë si pjesë e jetës, të kalitjes së karakterit e të qëndrueshmërisë së personalitetit. Si mësues, në Lurë, Musai nuk u jepte nxënësve të tij thjesht mësimin e ditës. Jo. Ai u kultivonte atyre e nëpërmjet tyre edhe mjediseve familjare të nxënësve, elementë emancipues, iluminues. Ai i frymëzonte nxënësit si të shihnin më larg, të ëndërronin. Këtë mision mund ta kryente vetëm një mësues me botë të madhe shpirtësore, që e shihte dhe e trajtonte misionin e tij pedagogjik jo thjesht si mësimdhënës por edhe si përhapës i kulturës në kuptimin më të gjërë të saj. Nga ana tjetër, Musai, ka theksuar se, përveçse përballoi largësinë, apo peshën e punës e përgjegjësinë si mësues i ri, “eksperienca dyvjeçare në Lurë ishte më shumë se një universitet për të”. E këtu kemi rastin e një aspekti të rëndësishëm të transkulturimit.

Me Lurën dhe lurianët u lidh në miqësi dhe shoqëri, të cilën ende vazhdon ta ruajë si më parë.

Një pjesë të mirë të jetës së vet Musai e ka kaluar si oficer. Ai, për më shumë se një dekade, ka ushtruar detyrën e oficerit, detyrë kjo shumë e vështirë, po të kemi parasysh privimet që impononte jeta e ushtarakut. Musai, kudo që ka ushtruar detyrën e oficerit, është sjellë në mënyrë korrekte, brenda ligjshmërisë së kohës, larg pasionit e subjektivizmit. Nën rrobën e oficerit pulsonte një zemër e zjarrtë atdhetari, gurgullonin ndjenja e emocione fisnikërie.

Musai është një praktikant i devotshëm i fesë Islame. Por, më shumë, Musai respekton të gjithë myslimanët praktikues. Ai është përpjekur vazhdimisht që ata të kenë mundësi të kryejnë ritet islmane në kushte sa më optimale. Në vitin 1999 mbështet ngritjen e minares së xhamisë në fshatin e tij të lindjes. Në vitin 2013 Musai u kujdes për rindërtimin e xhamisë së fshatit, punë që u krye në 32 ditë, me kujdesin dhe nën drejtimin e drejtpërdrejtë të vet Musait. Ritet fetare Musai i shihte edhe si moment ku ai mund të realizonte aktivitete bamirësie – Musai ka qenë pranë dhe ka ndihmuar shumë njerëz në nevojë, të sëmurë, hallexhinj. Shumë prej tyre i janë mirënjohës dhe e falenderojnë Musain për dorën e tij të zgjatur në momentet e tyre të vështira.

Një miku i tij në libër do të theksonte se Musai dhe familja e tij bëjnë një jetë normale në Tiranë, por pa harruar vendlindjen plot halle.

Besoj se në këtë aspekt një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe gjysma tjetër e rëndësishme e familjes-Hasija, bashkëshorte, bashkudhëtare dhe bashkëpunëtore e ngushtë në gjithcka.

Bashkë me Hasijen ndanë momente të bukura e të vështira të jetës së tyre në Peshkopi, Bulqizë, Fushë Krujë e prapë në Dibër e Tiranë. Hasija mbajti derën të hapur për miq e familjarë. Nuk është e rastit që ajo nuk u tut të kishte plot 31 kosovarë bujtës në shtëpitë e saj gjatë luftës në Kosovë. Nuk u lodh kurrë. Nuk u ankua sepse kishte dhe ka në krah Musain.

“Me Musain jemi bashkëshortë, kolegë e shokë të mirë dhe kështu i thërrasim njëri tjetrit. Kemi plot 33 vjet bashkë. Çaste lodhje, dëshpërimi, gëzimi e lumturie. Të gjitha i kemi kaluar bashkë të dy. Përjetojmë çdo ditë gëzimet dhe zhgënjimet që të jep jeta, puna dhe profesioni”, thotë Hasija në kujtimet e saj.

Ata janë sot prindër të tre djemve të mrekullueshëm: Klodit, Erionit dhe Metit, vjehërr të tre nuseve si drita dhe gjyshër të lumtur të dy nipave dhe dy mbesave. Së shpejti edhe me të pestin pasardhës!

Në aktivitetin e Musait zë një vend të rëndësishëm ideimi, mbështetja dhe financimi i Shoqatës së Intelektualëve Dibranë. Shoqata jonë e nisi rrugëtimin e saj plot 10 vjet më parë.

Musai ka luajtur një rol të rëndësishëm jo vetëm si nënkryetari i saj por edhe si një ndër kontribuesit kryesor të saj. Është falë Musait që Lidhja Intelektualëve Dibranë ka ndërmarrë shumë aktivitete për promovimin e vlerave dhe personaliteteve që i bëjnë nder Dibrës sonë. Botimi i gazetës ‘Rruga e Arbërit’ ka gjithashtu kontributin e Musait si një ndër aksionerët e saj e sot si aksioneri kryesor. Kjo gazetë ka luajtur një rol të rëndësishëm për promovimin e vlerave më të larta të qarkut të Dibrës. Jo vetëm personalitete nga fusha e artit dhe kulturës, por edhe nga jeta shoqërore, politike dhe sociale. Roli i Musait në këtë media ka qenë ndikues për një gazetë të lirë dhe të pavarur.

“Angazhimi dhe drejtimi i Lidhjes së Intelektualëve Dibranë në krah të prof. Nuri Abdiut apo kontributi i vyer i tij për botimin e gazetës “Rruga e Arbërit’ janë dy arësye më shumë që ne si dibranë duhet të ndjehemi gjithnjë krenarë dhe borxhlinj për këtë figurë kaq popullore, humaniste dhe të zellshme për ta nderuar brez pas brezi”, thotë miku ynë Defrim Methasani.

Personalisht kujtoj me shumë respekt dhe mirënjohje ftesën që prof. Nuri Abdiu dhe Musai më bënë për t’u bërë pjesë e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë. Megjithëse një shoqatë relativisht e re, ajo u për ne të gjithë organizata e bashkimit me vlerat, kontributet, eksperiencën, figurat dhe personalitet e Dibrës, që kanë bërë emër e që po aq natyrshëm japin emër.

Që në takimet e para Musai spikatin me personalitetin e tij. Iniciator, inkurajues, mendjehapur dhe dashamirës.

Natyrisht, unë kisha pak njohje dhe në një nga ditët e punës së përbashkët, guxova ta pyes prof. Nuriun: “Profesor, çfarë përfaqëson Musai?” Si njeri i mençur që ishte, qetë e ngadalë mu përgjigj: Njeriun e ndershëm të punës!

Sa më shumë e njihja Musain, bashkëshorten dhe djemtë, aq më të fuqishme më tingëllonin fjalët e profesorit.

Por bashkëpunimi me z. Riçku, mua personalisht, më ka ndihmuar të njoh më shumë e më mirë dibranët që përballuan sfidat e tranzicionit, duke ruajtur të paprekuar vlerat njerëzore që kanë karakterizuar dibranët dhe dibranet në breza.

Familjar i mirë, mik i vërtetë, shok i papërtuar, qytetar i ndërgjegjësuar, dibran me zemër të madhe janë vlerat për të cilat familja, djemtë, motrat dhe vëllezërit, kushërinjtë, miqtë dhe bashkëpunëtorët duhet të ndihen krenar për Musain!

Në emër të shoqatës Lidhja e Intelektualëve Dibranë, miqve, bashkëpunëtorëve, kontribuesve të këtij takimi, të falenderoj për gjithcka bën për komunitetin e dibranëve dhe të uroj jetë të gjatë e të lumtur bashkë me Hasijen dhe djemtë, i rrethuar nga dashuria dhe mirënjohja e merituar e të gjithë të dashurve të tu!

Fjalë e mbajtur gjatë veprimtarisë që u mbaj në Hotel Tirana International më 20 mars 2016

“Ashtu siç u tha që na ka bashkuar edhe neve politikanëve, mendoj që ne duhet të jemi të bashkuar pikërisht për të motivuar, për të promovuar, për të mbështetur njerëz si Musai dhe vlerat e tjera të Dibrës dhe meqë jemi të gjithë dibranë, është rasti që ne të jemi të gjithë të bashkuar që të kontribuojmë për Dibrën me ato mundësi që na janë dhënë dhe rasti më i mirë është Rruga e Arbrit”.

Musa Riçku, “Qytetar Nderi” i Dibrës

(Vijon nga faqja 9)

jemi mbledhur sot për të festuar ditëlindjen e tij dhe me këtë rast promovojmë monografinë kushtuar njeriut fisnik, por edhe nderimin që i bëhet nga Bashkia e Dibrës, duke i dhënë titullin “Qytetar Nderi”’, - tha në fjalën e saj Miranda Goleci, drejtore e Botimeve M&B.

“Libri është punuar më shumë seriozitet, përkushtim dhe dashuri. Por falënderimi shkon për Hasien dhe Musain, si dhe autorin e librit, z. Shaqir Skarra, që na dhanë mundësinë të punojmë me këtë monografi”, - tha ajo.

“Libri është një monografi e shkruar për Musain, por jam e sigurt se gjithkush do të gjejë aty veten, të afërmit apo jetën tonë me traditat dhe zakonet e bukura dibrane. Aty është një jetë e tërë sakrifice, janë periudha të caktuara si ajo e 97-ës, me ngjarje që të rrënqethin, por edhe të mbushin me admirim për forcën, kurajën dhe humanizmin e treguar nga Musai dhe familja e tij në këtë ditë të vështira.

Aty është familja e Musait, Hasija, gjysma më e mirë e Musait, e cila e ka mbështetur në çdo vendimmarrje, të çfarëdolloji qoftë, janë fëmijët e Musait, fëmijë të shkolluar, të edukuar, më nipër e mbesa të cilët ia shtojnë bukurinë Musait dhe familjes së tij”, - mbyll fjalën e saj Miranda Goleci.

Miranda dhe Bujari kishin përgatitur edhe një dhuratë me rastin e ditëlindjes, një pikturë të realizuar mjeshtërisht nga artisti dibran Zaim Elezi, i njohur me emrin artistik “Zaya”. Kjo pikturë ishte edhe një gjetje origjinale për kopertinën e librit, duke e plotësuar librin si një monografi serioze dhe të plotë.

Gjatë fjalës së tij, shkrimtari Shaqir Skarra tha se “Në këtë libër nuk kam thënë gjithçka, nuk kam bërë aq sa i takon një personaliteti si Musai, pasi ai ka dhënë e ka bërë edhe më shumë për Dibrën, për artin, sportin dhe kulturën, për njerëzit e mirë dhe të zgjuar dibranë”.

“Për njerëz si Musa Riçku ka vërtet nevojë Dibra dhe më së fundi me vendimin e Këshillit bashkiak duke e shpallur “Qytetar Nderi”, Dibra i dha vlerësimin e duhur dhe vlerësimi nga vendlindja është vlerësim mbi vlerësimet”, - theksoi ai.

“Jam munduar të bëj diçka të mirë dhe të bukur që dhe brezat e tjerë të mburren me ndihmën dhe kontributin e Musait për Dibrën dhe dibranët, tha ai. Në fillim të them të vërtetën e kisha tepër të vështirë. Nuk mundja të trilloja, të fantazoja asgjë. Personazhin kryesor që do të shkruaja në këtë monografi e kisha përballë çdo ditë. Kisha fare pranë një Musa që e njihja nga afër, vite më parë, e takoja, komunikoja e pija kafe me të. Një Musa tepër njerëzor, të thjeshtë, punëtor, fisnik e bujar. Një Musa modest që nuk pranonte stisje, trillime e fantazi, por kërkonte me këmbëngulje që realiteti të jepej ashtu siç kishte ndodhur gjatë etapave të jetës së tij”.

Duke falenderuar ata që e ndihmuan në përgatitjen e këtij libri, vuri në dukje edhe kontributin e atyre që kanë shkruar në këtë libër “Unë kisha kontakte edhe me kolegë, partnerë, shokë e miq të Musait, dëshmitarë okularë në ditë me diell e të vështira. Ata u treguan të gatshëm dhe m’i treguan çdo detaj nga të gjitha ngjarjet, ashtu siç kishin ndodhur, ashtu siç i kemi trajtuar edhe në libër”.

MUSAI NA KA NDERUAR TË GJITHËVE

Dal këtu si dibran dhe në emër të dibranëve, sepse ajo është që na ka bashkuar të gjithë këtu pavarësisht është Musai”, - tha në fillim të përshëndetjes së tij deputeti Sherefedin Shehu.

“Ne themi që erdhëm për të nderuar Musain, por unë do të thoja që Musai na ka nderuar ne dhe të gjithë ne jemi krenar për Musain, por edhe për të gjithë ata dibranë të shquar që i kanë dhënë emër Dibrës”, tha ai. “Besoj se të gjithë ne sot jemi dëshmitarë që në listën e atyre kontribuuesve të mëdhenj dibranë, të atyre që kanë krijuar historinë e Dibrës, që kanë ngritur emrin e Dibrës shtohet edhe Musai. Ai e ka shkruar vetë biografinë që edhe pa atë libër që u prezantua këtu, të gjithë e dinë se kush është, të gjithë e njohin, të gjithë e vlerësojnë dhe të gjithë e respektojnë. Por megjithatë është mirë që t’i shkruajmë gjërat, sepse duhet t’i njohin pasardhësit tanë. Ashtu siç krenohemi ne besoj që si njeri si Musai do të krenohet jo vetëm familja por edhe të gjithë pjesëtarët e saj dhe e gjithë Dibra mbarë. Natyrisht që Musai i ka këto vlera për shumë arsye, por nxjerrja e tyre në dukje është edhe familja e mrekullueshme e tij sidomos e gruas, sepse të jesh një bamirës, natyrisht që pa mbështetjen dhe pa lejen e gruas nuk mund të jesh. Por besoj që Musai shkon pak më përtej sepse ka dhe një familje të madhe që kur të krijon probleme, në vend që të jesh bamirës, në vend që të jesh kontribuues, dhurues, në vend që të punosh për emrin tënd do punosh për emrin e familjes. Por besoj në rastin e Musait familja ka qenë mbështetëse ndaj kemi figurën e Musait, një figurë të vlerësuar dhe të respektuar nga të gjithë”.

“Ashtu siç u tha që na ka bashkuar edhe neve politikanëve, mendoj që ne duhet të jemi të bashkuar pikërisht për të motivuar, për të promovuar, për të mbështetur njerëz si Musai dhe vlerat e tjera të Dibrës dhe meqë jemi të gjithë dibranë është rasti që ne të jemi të gjithë të bashkuar që të kontribuojmë për Dibrën me ato mundësi që na janë dhënë dhe rasti më i mirë është Rruga e Arbërit. Ne kemi detyrën që të bëjmë Rrugën e Arbërit dhe duhet të jemi ne të bashkuar kur vjen puna për çështje të mëdha



“Libri është një monografi e shkruar për Musain, por jam e sigurt se gjithkush do të gjejë aty veten, të afërmit apo jetën tonë me traditat dhe zakonet e bukura dibrane. Aty është një jetë e tërë sakrifice, janë periudha të caktuara si ajo e 97-ës, me ngjarje që të rrënqethin, por edhe të mbushin me admirim për forcën, kurajën dhe humanizmin e treguar nga Musai dhe familja e tij në këto ditë të vështira”.



Deputeti i Dibrës Sherefedin Shehu gjatë fjalës së tij.



Deputeti i Dibrës Ulsi Manja gjatë fjalës së tij.

Musa Riçku, "Qytetar Nderi" i Dibrës

për sa i takon Dibrës", - tha ai.

Pas kësaj përshëndetje, ishte një mik i Musait që mori mikrofonin pa radhë.

"U kënaqa shumë që juve përmendet vetëm Dibra, Dibra. E keni birin tuaj, sot do flisni për të. Por mos harroni e kush nuk do të fliste për Korabin, po pse Gjallica që e ka pranë, nuk duhet të flasë dy fjalë për Korabin. E kështu bashkë kushedi sa të tjerë janë kështu si unë. Janë Shkëlzeni, Tomorri, Mali i Gjerë e gjithë Shqipëria , besoj që do ketë edhe të tjerë. Më lejoni që edhe unë, duke patur gjithë këtë emocion në shpirt, edhe duke e prishur protokollin tuaj, t'i shpreh këto fjalë nga zemra. Edhe 100 Musa, edhe gëzim e krenari për të gjithë intelektualët dibranë që më bën me shumë emocion sot në këtë ceremoni", tha Fadil Grosha, një mik i Musait.

"ME JETËN, VEPRAT DHE PUNËN TËNDE IA KE SHLYER DIBRËS"

Jam i emocionuar dhe i privilegjuar, tha në përshëndetje e tij deputeti i Dibrës Ulsi Manja, të them pak fjalë për dibranin zemërbardhë, fisnik, fjalëpak dhe punëshumë Musa Riçku. Unë nuk mund të them për Musain, asgjë më tepër sesa ato që u thanë, sepse Musai e ka shkruar me punën dhe djersën e vet. Kë nderon Dibra? Dibra simbolikisht nderon bijtë e bijat e vetë më të mirë. Nderon ata që ndër vite kanë kontribuar për atë që ka më të shenjtë Dibra: Traditën, kulturën, doket, zakonet, arsimin, kulturën, besimin, por dhe humanizmin njerëzor. Ka shumë dibranë që mund ta kenë bërë një gjë të tillë, dhe kanë lënë gjurmë në historinë e Dibrën në shekuj e vite. Sigurisht që Dibra mund t'i ketë nderuar dhe çmimin "qytetar nderi" për atë gjurmë, atë shenjë që kanë lënë në historinë e Dibrës, por shumica jam i bindur që e kanë bërë nga pozitat e funksionit apo detyrat shtetërore që u është dhënë mundësi të kenë në Dibër. Dibra ka vlerësuar dhe jabanxhinj me këtë titull që kanë lënë gjurmë dhe histori në traditat e Dibrës. Por titulli që bashkia e Dibrës i jep Musa Riçkut është i veçantë në llojin e vet, është i veçantë, sepse Musa Riçku nuk do të jetë më qytetar nderi i Bashkisë së vogël të Peshkopisë, por do të jetë qytetar nderi i Dibrës i bashkisë së madhe të Dibrës që fillon nga Kalaja e Dodës deri Ura e Topojanit. Dhe është një vlerësim që Dibra e bën për Musain, sepse Musa Riçku shpirtin e madh human, humanizmin e vet njerëzor, dhe ato çka i dha Dibrës dhe ato që do të vazhdojë i japë. Jam i bindur, sepse është në kulmin e moshës, ai vërtet bën 60 vjet, por është në kulmin e moshës për t'i shërbyer humanizmit dhe Dibrës e ka bërë tërësisht nga pozitat e një njeriu të lirë, e një biznesmeni të suksesshëm që gjithçka e ka arritur falë punës, mundit, djersës dhe kontributit të vet, personal, familjar të fëmijëve të tij. Musai nuk është thjesht "Qytetar Nderi" i Dibrës, është "Nderi i Dibrës", - tha Manja.

"Unë jam i bindur që humanizmi yt do të vazhdojë, prandaj je Musai i të gjithëve, dhe, sigurisht, edhe ne politikanët sot jemi këtu e para se na ka ftuar një "Qytetar Nderi" i Dibrës, e dyta se jemi dibranë, por që jemi dhe do të vazhdojmë të jemi gjithë jetën borxhlinj ndaj Dibrës. Ti të paktën, me jetën, veprat dhe punën tënde ia ke shlyer Dibrës, prandaj Dibra të ka dhënë titullin "Nderi i Dibrës".

Sa i pasur është Musai?

Unë e njoh Musa Riçkun që prej 10 vitesh. Kryesisht prej bashkëpunimit në gazetën Rruga e Arbërit, e cila na ka afruar më shumë dhe na ka bërë të diskutojmë më shpesh. Kafet e mëngjesit, sidomos kur gazeta del nga shtypi, është e përbashkët.

Disa miq të mi, herë pas here, më kishin pyetur për pasuritë e Musait. Musait i del emri të veprimtaritë e shoqatave dibrane si donator, te librat si kontributor, të gazeta si aksioner, të sporti si dhurues... Nuk ka veprimtari, sidomos në Tiranë, që lidhet me kulturën e sportin, ku emri i Musait të mos jetë i pranishëm me një kontribut sado të vogël. Por meqë shembujt si ai mungojnë ose janë të rrallë, është krijuar përshtypja se Musai është shumë i pasur. Dhe një ditë, një mik i yni i përbashkët, më pyeti: Sa i pasur është Musai? Dhe unë që këtë pyetje e mora të ngjashme me pyetjen: "Sa e ke rrogën", nuk e kam dhënë kurrë një përgjigje. Sepse unë nuk di rrogën time, jo të dija paratë e Musait.

Por, duke u marrë më procesin e redaktimit të librit dhe duke parë sallën në Hotel Tirana të mbushur plot, si kurrë më parë, unë e kam gjetur përgjigjen se sa i pasur është Musai. Dhe meqë disa nga ata që më kanë pyetur ishin në atë sallë dhe disa të tjerë mund të më pyesin sërish nesër, unë po e shkruaj përgjigjen tani:

- Musai është i pasur, sepse ai është rritur dhe edukuar nga prindër të mrekullueshëm, që e kanë mësuar se gjëja më e mirë që mund t;i ndodhë njeriut, është të ushqehet gjithmonë me Hallallin.

- Musai është i pasur, se ka punuar gjithmonë fort, ka qenë i drejtë dhe nuk i ka hyrë në hak askujt.

- Musai është i pasur se ka pasur në krah një zonjë si Hasija, e cila e ka ndihmuar dhe e ka përkrahur vazhdimisht në ditë të mira dhe në ditë të këqija, i ka qëndruar gjithmonë pranë për t'ia lehtësuar punën dhe për t'ia zbukuruar jetën.

- Musai është i pasur se Zoti i ka dhënë tre djem të mrekullueshëm, që nuk janë rritur duke prishur lekët e babait lokaleve të natës apo resorteve luksoze të botës, por janë edukuar përmes punës dhe librave si shumica e fëmijëve të familjeve normale në këtë vend.

- Musai është i pasur, sepse ka miq e shokë që jo vetëm një sallë nuk i nxë, por edhe ajo festë të bëhej në fushën e sportit të Korabit, prapë nuk do t'i nxinte...

Ndaj Musa Riçku është i pasur, sa edhe unë jam i pasur që kam një mik si Ai!

Bujar Karoshi



Ne si politikanë vazhdojmë të jemi akoma borxhlinj Dibrës, në shumë drejtime, dhe borxhi që kemi për t'i larë Dibrës dhe që duhet ta lajmë për aq kohë sa të jemi në politikë është Rruga e Arbrit. Shpresoj dhe ajo do të jetë dhurata e Dibrës", - mbylli përshëndetjet e tij deputeti i Dibrës, Ulsi Manja.

"MUSAI HARXHON NJË PASURI TË FITUAR ME HALLALL - HALLALL I QOFTË"

Është një rast i veçantë, është një moment i këndshëm të marrim pjesë në këtë aktivitet të urojmë nga zemra zotin Musa Riçkun, të jetojë edhe shumë vite", nisi fjalën e tij kryetari i Komunë së Dibrës së Madhe, Mr. Ruzhdi Lata.

"Me Musain nuk na lidh ndonjë miqësi, nuk na lidh ndonjë e kaluar. Me Musain jemi shokë, pse jemi shqiptarë, asgjë më shumë dhe asgjë më pak. Ftesa për të marrë pjesë në këtë aktivitet më imponon të them disa fjalë për Musa Riçkun, ashtu siç unë e njoh. Së pari do t'i kthehemi të kaluarës. Musai mban një emër profetik, kështu që është një ngarkesë shpirtërore, një obligim moral, por që ti dalëngadalë e realizon.

Çka bëri Musa Riçku për këto vite. E lexova librin deri diku. Dëgjova parafolësit, unë vij nga Dibra e Madhe, me të gjithë ju që jetoni në Shqipëri, me të gjithë ju që jetoni në Tiranë, ne jemi krenarë, por jemi krenarë ka moti, shumë herë, dhe tash atë krenari na e shton Musa Riçku. Dhe Musa Riçku sikur vazhdon rrjedhën e historisë dibrane në Tiranë. Kthehemi në vitet '20. Një dibran i quajtur Fuat Dibra, për pavarësinë e Shqipërisë harxhon pesëqind mijë franga floriri. Musa Riçku për dibranët në Tiranë, për tiranësit dhe gjithë shqiptarët, vazhdon të harxhojë një pasuri të fituar me hallall. Por hallall i qoftë", mbylli fjalën e tij Mr. Ruzhdi Lata.

"MUSAI KA ZEMRËN E MADHE"

Artisti i njohur Bujar Kapexhiu, kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane", duke përcjellë përshëndetjet e tij personale dhe të kryesisë së Shoqatës, tha se "kam kënaqësinë që jam përpara jush, por mbi të gjitha më jepet rasti të flas për një njeri fisnik".

"Musain e kam njohur vonë, por e kam personale këtë gjë dhe e ndjej të moralshme ta falënderoj, sepse ka kontribuar për tre aktivitetet e mia. Kam bërë dhe unë disa aktivitete në kuadrin për Dibrën. Me Musain nuk njihesha, por me organizatorët, kur bisedonim, më vinte emri. Po kontribuon Musa Riçku, një biznesmen dibran. Pra, Musai nuk kontribuoi për Bujar Kapexhiun, si person, kontribuoi për aktivitetin, atë që ishte për Dibrën, për të ngritur vlerën Dibrës. Dhe unë po them që më ndihmoi pa më njohur. Ka shumë biznesmenë jo vetëm dibranë, por edhe të tjerë, të cilët, siç thotë populli: "Punoi me ndershmëri dhe fitoi me të dyja duart". Edhe Musai është nga ata që punon me ndershmëri dhe me durim dhe fiton me të dyja duart. Fiton me të dyja duart, sepse ka dy, por po të kishte 3 ose 4 do të fitonte me katër duar. Por ka nga ata biznesmenë, të cilët i mbledhin ato para dhe i shtrëngojnë në grusht. Musai është nga ata që njërin grusht e ka mbledhur dhe e ka për vete, kurse tjetrën e ka hapur. E ka hapur për të gjithë ne, pra për artin dhe kulturën shqiptare. Kjo është vlera e këtij njeriu. Sepse Musai nga të tjerët ka diçka, ka zemrën e madhe, ka mirësi, ka admirimin dhe nderi që i bën artit dhe kulturës dhe mbi të gjitha ai ka dashurinë mbi njeriun. Prandaj unë sot i uroj jetë të gjatë me të gjithë familjen e tij, por dhe me të gjithë ne së bashku për Dibrën. Historia e një familje, historia e një fisi, historia e një qyteti, historia e një shteti varet vetëm nga emrat, përbëhet nga emrat. Dhe unë them se Musai emrin e vet të madh e ka vendosur në Dibër; ai punon në Tiranë dhe i takon që qytetar nderi ta bëjë dhe Tirana".

Adem Zemzadja, një bashkëfshatar i Musait, gjatë fjalës së tij tha se "ai Musai ka ka nderuar familjen, na ka nderuar ne, Dibrën dhe ndoshta edhe Tiranën".

"Unë flas jo vetëm si vendlindje, por edhe si vendrritje. Ka një origjinë të mirë qysh nga baba dhe nga emri i vjetër Musai. I lidhur me bashkëfshatarët e Limjanit, në të gjitha konceptet, në të gjithë pjesët e historisë, i lidhur si mishi me kockën me institucionet e fshatit", - theksoi Zemzadaja.

TE MUSAI BASHKOHEN QYTETARIA, PËRKUSHTIMI DHE VEPRIMTARIA PËR TË NGRITUR LART EMRIN E DIBRËS

Donika Hyseni, prefekte e Dibrës, gjatë përshëndetje së saj tha se "është një nga rastet e rralla kur një vendim Këshillit bashkiak për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" përkon me realitetin dhe siguron një konsensus të gjerë qytetar. I tillë është edhe rasti i sotëm, për të cilin jemi mbledhur për t'i dhënë titullin "Qytetar Nderi" zotit Musa. Dhënia e këtij titulli nuk është një qokë e rastit apo tekë, për t'i bërë qejfin dikujt, siç ka ndodhur rëndom, përkundrazi tek Musai shkrihen në një pikë të vetme qytetaria, përkushtimi për komunitetin,

cyan magenta yelloë black



Musai me familjen. Foto: Zaim Elezi

veprimtaria për të ngritur lart emrin e Dibrës dhe të dibranëve. Kontributet e tij në veprimtaritë shkencore, historike, kulturore e sportive për Dibrën janë të panumërta, humanizmi, atdhedashuria, shpirti i sakrificës e bëjnë të veçantë zotin Musa në mjedisin dibran dhe më gjerë, ndaj në emër institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër ndihem krenare që kam miratuar një vendim të tillë të marrë nga Këshilli bashkiak, ndaj përulem me respekt përpara jush".

Ardit Tupja, njëri nga bashkëpunëtorët në biznes me Musain, gjatë përshëndetjes së tij tha se "Ne jemi pjesë e asaj autokolonës, dmth nuk jemi pjesë e letrave që folën deri më tani".

"Ne kemi qenë në autokololën që e ka sjellë Musait deri këtu. Kemi qenë në pjesën e vrapit, d.m.th. ato arkat që i kemi ngarkuar shkarkuar dhe jam pjesë e atij grupi njerëzish që e vlerësojnë Musain për besimin, atë pjesë që në të gjithë botën mungon. Musai më ka dhënë besimin që në momentin e parë, pa e njohur, para 20 viteve. Ne e dimë të gjithë që askush nuk ta fal këtë besim. Pjesa e besimit, që ai më ka dhënë dhe gjithë vendosmëria që ka patur në mbështetje, është një motiv jam këtu dhe e përshëndes me gjithë zemër në këtë 60-vjetor, për një jetë të mbarë e të lumtur, siç e ka patur deri tani".



Musai duke marrë titullin "Qytetar Nderi" nga kryetari i Bashkisë së Dibrës, Shukri Xhelili dhe kryetarja e Këshillit Bashkiak, Lulzime Dani

Më pas, një përshëndetje e posaçme për Musai erdhi nga Kosova. Isa Musmurati nga Gjilani tha se "pas gjithë këtyre fjalëve që u dëgjuan deri tani, miradie dhe humane, Musai ka dhënë një kontribut të veçantë edhe në përkrahje të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ne kishim një strehë të fortë tek Musai në Peshkopi për transportin që bëhej për armatim, municione ushtarake dhe gjëra të tjera. Kontributi i Musa Riçkut ka qenë i veçantë në transportin në mënyrë vullnetare", tha ai.

Më pas, Ambra Meda, vajza e cila fitoi një betejë të rëndësishme gjatë jetës së saj, tha falenderimet e saj për "xhaxhi Musain, i cili jep një shembull tek të gjithë ne, që na frymëzon për të bërë gjëra të mira në jetë dhe mes fjalësh të mira dhe urime kam dhe unë një dedikim, sepse dhe ti xhaxhi Musa je nga ata që ke firmosur në jetën time. Xhaxhi Musa, njeriu që përcjell mirësi dhe fal dashuri, faleminderit që ke firmosur në jetën time".

Më pas Rushit Kuçi nga Shoqata e Pensionistëve e falenderoi për ndihmën që ka dhënë në aktivitetet e shoqatës së pensionistëve, ndërsa ish-presidenti i Korabit, Fehmi Mziu, i dhuroi atij një fanellë të ekipit të Korabit.

"Të flasësh për Musain është historia që ka edhe vitet mbi shpatulla. Musai është biri i Dibrës, ka dhënë shumë dhe kam besimin që do japë akoma dhe më shumë. Shpresoj që të ketë jetën e gjatë dhe shumë dibranë t'i bashkohen Dibrës si Musai", tha Mziu.

Më pas, futbollisti i Korabit Sidrit Guri, i cili një ditë më parë kishte shënuar për ekipin e Korabit, tha: "Kam shënuar disa gola në këtë kampionat, por ai i djeshmi ishte dedikim për



Në foto: Nga e djathta në të majtë: Defrim Methasani, Musa Riçku, Isa Musmurati, Ambra Meda, Rushit Kuçi, Lunada Methasani, Fehmi Mziu dhe Sidrit Guri. Foto: Z. Elezi

Mësuesi Musa!

Nga **ABAZ DEDA**

Si fillim do të doja të binim dakord që Musait t'i drejtohesha Mësues Musai, sepse për mua dhe gjeneratën time ishte dhe do të mbetet i tillë. Unë atëherë edhe për nga vitet, por edhe për nga shtati isha më i vogli ndër nxënësit e tjerë të klasës.

Mësues Musai tregonte një kujdesje të veçantë ndaj meje. Kështu midis nesh filloi të ndërtohej një lidhje e jashtëzakonshme. Me një fjalë unë kisha fatin që isha më i përzgjedhuri në mesin e nxënësve të shumtë që ishim në klasë.

Sot, pas shumë e shumë vitesh, mësuesi im (Musai) ka shumë arsye të ndihet krenar për gjithçka që ka bërë për shkollën e Gur-Lurës. Populli i asaj ane, kolegët, ish nxënësit e tij edhe sot e kësaj dite në mendjen e tyre ruajnë me krenari kujtesën për këtë mësues të shkëlqyeshëm që aq devotshmërisht i shërbeu këtij fshati dhe zone.

Për emocionet që mbizotërojnë tek ne për këto kujtime nuk do të ndryshojnë asnjëherë, s'do t'i harrojmë këshillat dhe qortimet e tij, pasi ato janë kyçur në kujtesën tonë.

Pas ikjes nga Gur-Lura, jemi ritakuar pas shumë vitesh në rrethana të ndryshme nga ato të mëparshmet. Unë tashmë isha një djalë i ri, që sapo kisha filluar punë si hetues në Hetuesinë e Rrethit Dibër, ndërsa Musai ishte në pozicionin e Oficerit, pranë Divizionit Dibër, megjithëse vitet kishin kaluar, vlerat dhe karakteri që mësuesi im pasqyronte vazhdonin të ishin aty, ende prezente.

Eventualisht, si një njeri vizionar e me ambicie, Musa provoi një sfidë të re, atë të sipërmarrjes. Duke e nisur nga pothuajse asgjë, ai, duke rrezikuar, duke mos njohur fjalën "dështim" e me një vullnet të pashoq, e zgjeroi biznesin e tij duke e çuar atë drejt disa kufijve që as ai vetë nuk do ta kishte besuar.

E megjithatë, pavarësisht gjithçkaje, suksesi nuk ia zbehi atij vlerat njerëzore. Si një person me ndjeshmëri ndaj çështjeve shoqërore e veçanërisht atyre të Dibrës, por jo vetëm, ai u gjend aty për çdo problem apo çështje në dukje të vështirë për të dhënë kontributin e tij. Si një njeri që shquhet për humanizmin e tij.

Vullnet Sina: “Mirënjohja që ju dibranët shprehni për njerëzit e mirë tuaj është një virtyt shumë i madh që mungon, por ju e keni të skalitur në Dibrën tuaj”.

Musa Riçku, “Qytetar Nderi” i Dibrës

(Vijon nga faqja 13)

DEKORIMI

Pas ceremonisë së gjatë dhe ku u thanë shumë fjalë të mira për Musain, Hasijen dhe fëmijët e tyre, i erdhi radha dhënies së titullit “Qytetar Nderi” nga Këshilli bashkiak i Dibrës.

“Vendimit nga Këshilli bashkiak për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” Musa Riçkut ka qenë vendim unanim nga gjithë këshilltarët”, tha kryetarja e Këshillit Lulzime Dani.

“Këshilli bashkiak, me propozimin e Qendrës Kulturore Dibër, KS Korabi dhe Sektorit të Kulturës, Edukimit, Komunikimit dhe Çështjeve gjinore, vendosi t’i japë z. Musa Riçku titullin “Qytetar Nderi” me motivacionin “Për kontribut të shquar, mbështetje të pakursyer, që ka dhënë e vazhdon të japë në zhvillimin, promovimin e vlerave të kulturës dhe sportit në Dibër”, - lexoi motivacionin kryetarja e Këshillit bashkiak. Vendimi mban numrin 8, datë 3 mars 2016 dhe është firmosur nga kryetarja e Këshillit bashkiak znj.Lulzime Dani dhe kryetari i Bashkisë, z. Shukri Xhelili.

Shukri Xhelili, kryetar i Bashkisë së Dibrës, duke i dorëzuar titullin Musa Riçkut, tha se “Është një kënaqësi e veçantë për mua që marr pjesë në aktivitet në promovim të titullit “Qytetar Nderi” të Musa Riçkut. Unë e quaj fat këtë medalje dhe gjithashtu dua t’i uroj Musait jetë të gjatë e të lumtur me rastin e 60-vjetorit të tij, gjithashtu dua t’ju falënderoj dhe ju të gjithëve që keni marrë pjesë këtu. Kjo është një konfirmimi për veprimin e drejtë që kemi bërë ne, duke i propozuar Këshillit bashkiak për dhënien e titullit”.

“Urime Musa, uroj dhe këto vlera të një familje tradicionale dibrane të trashëgohen dhe në familjen tënde brez pas brezi”, tha kryetari i Bashkisë.

Më pas, kur veprimtaria po shkonte drejt fundit, pati edhe surpriza të tjera. Zonja Zamira Gjeleshi, aktiviste dhe përgjegjëse e zyrës së kulturës në Bashkinë e Dibrës i dhuroi Muait një shqiponjë të gdhendur në dru. “Musai është identifikuar me shqiponjën, jemi nga vendi i shqiponjave dhe bashkëjetojmë me shqiponjat. Shqiponjat fluturojnë lart”, - tha ajo.

Më pas, një falenderim në emrin e tij dhe të Shoqatës “Çidhna dhe Kastriotët” dha edhe Met Birti. “Unë e kam kushëri Musain, por nga ajo që pashë sot këtu, mësova shumë gjëra që nuk i kisha ditur më parë”.

Vullnet Sina, President i “Big Market” e vlerësoi Musain jo vetëm si një bashkëpunëtor dhe aksioner të grupit, por edhe më tej.

“Kam mësuar dy gjëra të mëdha në këtë sallë të dibranëve që ne ju njohim për të zgjuar dhe shumë trima, - tha ai. Unë kam 10 vjet që punoj me Musain dhe këto gjëra nuk i kisha dëgjuar ndonjëherë. Një burrë i urtë që nuk kishte treguar asnjëherë për veten e vet. Dhe gjënë më të madhe kam vënë re dhe mësimin më të madh që më keni dhënë ju sot është mirënjohja që ju dibranët shprehni për njerëzit e mirë tuaj. Është një virtyt shumë i madh që mungon, por ju e keni të skalitur në Dibrën tuaj”, - tha Sina.

Më pas, një tufë e madhe me lule erdhi së bashku me dedikimin në mungesë të mikut të familjes, Miço Todhe.

“I dashur vëlla Musa! Në pamundësi për të qenë fizikisht aty me ju, ti e di shumë mirë që me mendje, në shpirt e zemër unë jam aty për të të uruar për librin tënd dhe titullin e merituar, të uroj shëndet e lumturi. Një respekt të veçantë për bashkëshorten tënde që të ka mbështetur në çdo gjë, për tre djemtë e tu që janë pasqyrim i virtyteve të tua. Jam krenar që je shoku, vëllai dhe miku im!” - shkruante Todhe në kartolinën e urimit.

Më pas, lot gëzimi shfaqen të Musai, Hasija dhe familjarët e tij. Nipërit dhe mbesat që e përqafojnë gjyshin e tyre që tashmë e ka nderuar gjithë Dibra. Hasija nuk gjen fjalë falenderimi, ndërsa Musai i emocionuar thotë veç një fjalë: Faleminderit!

Më pas, një tortë e porositur nga ekipi i futbollit Korabi e ëmbëlsoi ceremoninë, ndërsa një potpuri këngësh dibrane kënduar nga Lirie Rasha e çoi peshë sallën. Atë sallë të Hotel Tiranës, që kurrë më parë nuk kishte parë kaq shumë njerëz të gëzuar!

Korresp. “Rr.A”.



Në foto: Vullnet Sina, Hasija dhe Musai. Foto: Z. Elezi

Musai është njerëzor, jeton me hallet e njerëzve

Nga **HASIJE RIÇKU**

Jam krenare të them dy fjalë në emër të familjes Riçku, një familje e vjetër, punëtore dhe e ndershme, ku pjesëtare jam edhe unë prej 33 vjetësh.

I falenderoj të gjithë nga zemra për pjesëmarrjen e tyre në këtë gëzim familjar.

Musait i uroj edhe 100 vite të tjera bashkë.

Një homazh ju bëj dy prindërve të mrekullueshëm të Musait, babë Hazizit dhe nënë Dudies, të cilët sakrifikuan jetën për rritjen dhe arsimimin e Musait.

Musai është punëtor, i dashur, trim. Është shok i mirë, bashkëshort shembullor. Është i drejtpërdrejtë. Ai është i rreptë me padrejtësinë.

Fati e deshi që për 33 vite të jem përkrah Musa Riçkut. Kemi tre djem të mrekullueshëm: Klodin, Erin dhe Metin, të cilët mundohen t’i ngjajnë të atit. Por është shpejt... Musai është i paarritshëm.

Një jetë bashkë me Musain, që nga viti 1982. Por jo gjithçka ka qenë e lehtë, për të arritur këtu ku jemi sot. Kemi kaluar një rrugë të gjatë me vështirësi e sakrifica të panumërta...

Në faqet e monografisë që u prezantua sot është jeta e Musait, është jeta jonë së bashku në hotelin e punëtorëve në Bulqizë, sakrificat në rritjen e fëmijëve, vështirësitë në vitin e mbrapshtë ’97, periudhë e cila në mendjen time ka plot kujtime të dhimbshme, ku pjesëtarë janë e gjithë familja ime, djali i madh, Klodi, vetëm 11 vjeç, është dëshmitar i ngjarjeve tronditëse.

Nuk mund të le pa përmendur edhe momentin e hapjes së depove të armatimit, ku Musai bashkë me djalin e dytë, Erjonin, ishin në Tiranë. U ndërpre lëvizja dhe rrugët ishin të pakalueshme. Një javë nuk e dinim se ku ishin dhe u përhapën fjalë se i kanë vrarë...

Por familja jonë e bashkuar në një të vetme ia doli mbanë në këto vite të vështira, duke treguar edhe humanizëm në furnizimin e popullsisë me ushqime.

Musai me guximin e tij vazhdoi pa ndërprerje rrugën Peshkopi – Tiranë dhe anasjelltas. Kemi punuar shumë e nuk e kemi ditur kur është natë, e kur është ditë. Musai është njerëzor, jeton me hallet e njerëzve. Ku ka mirë, ku ka keq, gjendet Musai.

Sot kemi një familje të lumtur, të nisur në vitin ’82 dhe sot jemi bërë plot 12 veta, me nipër e mbesa që na e zbukurojnë jetën tonë e që janë mjalti i mjaltit.

Unë dhe Musai që ditën e parë të njohjes e kemi konsideruar njëri-tjetrin shokë në çdo llogore dhe ashtu jemi edhe tani.

Ky është dhe suksesi i jetës tonë bashkë!

Gjithashtu, jam shumë e lumtur për vlerësimin që i është bërë Musait nga Bashkia e Dibrës, duke i dhënë titullin e lartë “Nderi i Dibrës” dhe për këtë i falenderoj të gjithë. Musai nuk e harroi kurrë Dibrën dhe ajo ia shpërbleu në këtë 60-vjetor! Ky titull është një pasaportë për familjen Riçku! Të rrojnë e ta trashëgojnë brez pas brezi!

Falenderimi i Musait

Në fillim falenderoj Shoqatën Lidhja e Intelektualëve Dibranë me kryetare Prof. Edlira Haxhimyeri dhe kujtoj me respekt ish kryetarin Prof. Nuri Abdiu, me të cilët së bashku kemi kaluar 10 vite duke kontribuar për jetën kulturore, artistike e shkencore të Dibrës, duke u përpjekur të vlerësojmë sa të mundemi kulturën dibrane.

Dua të falenderoj Këshillin Bashkiak të Dibrës dhe Kryetarin e Bashkisë z. Shukri Xhelili për vlerësimin që më bënë duke më shpallur “Qytetar Nderi”. Shpresoj që sa të jem gjallë ta mbaj me nder këtë barrë të rëndë!

Falenderoj Klubin Sportiv Korabi, Qendrën Kulturore Peshkopi dhe Seksionin e Kulturës në Bashki, të cilët u bënë iniciatorë të propozimit.

Falenderoj miqtë e mi, Myftiun e Dibrës së Madhe, z. Ruzhdi Lata dhe Myfiun e Dibrës Ahmet Çaushi nga të cilët kam mësuar shumë...

Falenderoj deputetët për vlerësimin që më bënë me praninë e tyre.

Felenderoj partnerët në biznes, nga Gostivari e Kosova si dhe të gjithë biznesmenët nga Gjirokastra në Kala të Dodës, me të cilët kemi punuar së bashku me sinqeritet e moral të lartë, dhe sot kemi mbetur miq.

Nuk dua të harroj një falenderim për Bujarin, Mirandën, Defrimin, Shaqirin, Zaimin dhe gjithë ata që na ndihmuan në botimin e librit dhe organizimin e kësaj veprimtarie.

Dhe në fund, një falenderim për familjen time, bashkëshorten Hasie, e cila nuk u mërzit kurrë me mua dhe e kam pasur gjithmonë një mbështetje të madhe gjatë gjithë kohës.

Dua të falenderoj tre fëmijët e mi, të cilët, megjithëse nuk u kam qëndruar shumë pranë ndërkohë që rriteshin, nuk më sollën kurrë një shqetësim. Tani i kam krahë, djem të mirë në shtëpitë e tyre, duke ma zbukuruar jetën me nipër e mbesa!

Në fund, falenderoj Zotin që më udhëzoi që këto investime morale t’i bëj në vendlindjen time, për artin, kulturën, sportin dhe Dibrën tonë!

Musa Riçku burrë dibran

NUREDIN SADIK LUSHAJ

Musa Riçku burrë dibran,
Faqebardhë në histori,
I njohur në katër anë,
I dalluar për fisnikëri.
Intelektual humanitar,
Nga rrënjët familjare,
Trup dhe shpirt gjithë në ar
Derë trimash atdhetare.
Burrë i shquar me pak fjalë,
Në kuvende me urtësi.
Vendi i tij sofra e parë.
Ky ndëgjohet me dashuri.
Musa Riçku – krenaria
E mbarë popullit të Dibrës.
Model e ka shoqëria.
Shndrit si ylli i dritës.
Dibrën me zemër të madhe.
Punëtor në pararojë,
Mik i dashur zgjidhi halle,
S’ka njeri që mos ta dojë.
Me shoqen familje model
Njeri me Fat dhe zotësi.
Sikur rrezja kudo shkëlqen
Shumëkushi u merr lakmi.
Me rastin e 6o-vjetorit
I uroj jetë të gjatë!
Nga zemra e kraharorit
Sa maja e lartë Korab!



Shaqir Skarra
Musai - portret i njeriut fisnik.
Monografi
ISBN: 978-9928-172-68-6
Botimet M&B

Miku im i bekuar

PËLLUMB AHMETI

Mirëmëngjesi, i them sa zbres shkallët
para gjashtës lëviz miku im qetë-qetë
ngadalë m’i ëmbëlson buzagaz fjalët
sytë i qeshin e ma kthen mirëmëngjes.
Shpirti gaztor uruar prej perëndive
Besimplotë vështrimin hedh tej agimit
Rrezje dielli Dajtit lëshon drita e syve
Për vendlindjen ngre dallgë mallëngjimi.
Eh, miku im i mirë Musa Riçku dibrani
Fjalën e bardhë urtësisht të buron ndjenja
Falur zoti madhështinë me zemër djali
Bekuar i perëndisë bamirësinë e bën zemra.
Fale me urtësinë e të madhërishmit Zotit
Libra jete fëmijëve të vobektë nëpër shkolla
Fjalë urtësinë me xhaminë e ngrite motit.
Thjesht e shpejt këto vargje për ty i hodha.
Ditën e mirë i thamë dhe sot njëri-tjetrit
Si rrëkeza a si pika uji rendëm drejt jetës
Dielli nga Dajti me rreze na përshëndeti
Miku im i bekuar në supe peshon viti 60!



Numri 1, maj 2006 — Numri 118, shkurt 2016

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë.

Kontribuo edhe ti për lirinë e saj me vetëm një pajtim!

Gazeta "Rruga e Arbërit" këtë vit mbush dhjetë vjet nga dalja e numrit të saj të parë dhe çdo muaj përcjell informacione, komente, opinione, reportazhe, recensa dhe rubrika të tjera për artin, kulturën, historinë dhe gjithçka që ka të bëjë me qarkun e Dibrës.

Gazeta është një botim i pavarur dhe këtë e ka dëshmuar gjatë këtyre dhjetë viteve me integritet dhe profesionalizëm.

Redaksia mbetet gjithmonë e hapur për sugjerimet tuaja, jo vetëm në trajtimin e tematikave, por edhe për të shkruar mbi veprimtari, individë apo organizata që veprojnë, kontribuojnë apo kanë lidhje me qarkun e Dibrës.

"Rruga e Arbërit" është një gazetë e lirë dhe liria e saj është e garatuar jo vetëm nga redaksia, por edhe nga lexuesit e saj, të cilët ndodhen larg vetëm një pajtim.

Gazeta shpërndahet në Tiranë, Durrës, Burrel, Klos, Bulqizë, Shupenzë, Maqellarë, Peshkopi dhe Dibër e Madhe në versionin print dhe në të gjithë botën përmes emailit në versionin PDF.

Një pajtim vjetor në Shqipëri dhe Dibër e Madhe, si deri më tani, kushton 600 lekë. Në Europë 10 Euro, në SHBA dhe vendet e tjera 15 USD.

Pajtimet jashtë Shqipërisë janë vetëm në versionet PDF dhe mund të kryhen përmes PayPal.

Për më shumë informacion:

Email: rrugaearberit@gmail.com
Tel: 00455 68 65 08 441.
WhatsApp: +355 68 65 08 441
Viber: +355 69 20 68 603
www.rrugaearberit.com
Bej "Like" dhe "Share"
Qëndro me gazetën #rrugaearberit më pranë #Dibrës!

Rruga e Arbërit - aty ku fjalët nuk i merr era!

Njoftim

Në kuadrin e 155 vjetorit të lindjes së Elez Isuf Ndreut - Nderi i Kombit, Bashkia Peshkopi, nën kujdesin e kryetarit të saj, z. Shukri Xhelili, do të organizojë një veprimtari në muajin qershor 2016.

Veprimtaria parashikon mbajtjen e kumtesave :

1 - Jeta dhe vepra e Elez Isuf Ndreut
2- Kontributi i Elez Isufi në mbrojtje të trojeve shqiptare
3 -Lufta e Elez Isufit për demokratizimin e vendit
4- Elez Isufi në traditën gojore
5- Bashkëveprimi i Elez Isufit me atdhetarët kosovarë Isa Boletini, Bajram Curri, Hasan Prishtina dhe Hoxhë Kadriun.
6-Përshëndetje: nga Kosova-nipi i Hasan Prishtinës, nipi i Isa Boletinit dhe mbesa e Hoxhë Kadriut, nga Prefektura e Dibrës, Qarku Dibrës, Komuna e Dibrës së Madhe, Bashkia e Bulqizës, nga familja (pasardhësit e Elez Isufit).

Plani i masave parashikon dhe veprimtari letrare e këngë për Elez Isufin. Po sot iu bë propozim Këshillit Bashkiak të Dibrë për dhënien e titulli "Qytetar Nderi" Elez Isufit.

E gjithë veprimtaria mbyllet me homazhe tek varri i Elez Isufit në Sllovë dhe bustit në Peshkopi.

Të gjitha individët, organizatat, shoqatat apo biznesmenë që dëshirojnë të kontribuojnë në këtë veprimtari mund të kontaktojnë me zotin **Moisi Murra**, në nr. tel: 068 38 93 020.

Veprimtari me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Librit dhe të Drejtës së Autorit

Me datë 23 prill 2016, ora 10.00, në mjediset e Pallatit të Kulturës Peshkopi, do të organizohet nga Bashkia Dibër dhe Biblioteka e Pallatit të Kulturës,

"DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT DHE E SË DREJTËS SË AUTORIT" .

Gjatë aktivitetit do të promovohen libra të autorëve dibranë dhe autorët do të prezantojnë një pjesë nga libri i tyre.

Të interesuarit që dëshirojnë ti bashkëngjiten kësaj veprimtarie ose që duan të prezantojnë botimet e tyre me këtë rast, janë të lutur të kontaktojnë me përgjegjesën e zyrës së kulturës në bashki, znj. Zamira Gjeleshi.

Email: **zgjeleshi@gmail.com**

Tel: **0682403154**

Nis puna për krijimin e Unionit të Shoqatave Dibrane

Më datë 26 mars 2016, me iniciativën e drejtuesve të shoqatave "Bashkësia Dibrane" dhe "Bulqiza" u mblodhën në Tiranë përfaqsuesit e shoqatave dibrane Bujar Kapexhiu, kryetar i "Bashkësisë Dibrane"; Bashkim Lami, kryetar i "Shoqatës Atdhetare Kulturore Bulqiza"; Musa Riçku, zv/kryetar i shoqatës Lidhja Intelektualëve Dibranë"; Hajri Mandri, kryetar i shoqatës "Elez Isufi"; Shaban Bitri, zv/kryetar i shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët" Skënder Gjoni, kryetar i shoqatës "Martaneshi"; si dhe Agim Quku, Hamit Dërvishi, Agim Biçaku, Sulë Keta, Bujar Karoshi, etj , që diskutuan mbi nismën për krijimin e Unionit të Shoqatave Dibrane.

Për këtë nisëm u shprehën unanimisht për dakortësi në parim dhe u ngrit grupi i punës i përbërë nga Edlira Haxhiymeri; Hyqmet Gonxhe; Bashkim Lami; Saimir Shatku; Hajri Mandri; Hamit Dërvishi; Skënder Gjoni; Gjetan Nura; Hysen Uka, që do të pregatisë dokumentin e memorandumit për tu bërë publik në një takim të gjërë të shoqatave me mbështetje në trevat e Dibrës brenda e jashtë kufirit dhe në diasporë.

Pjesmarrësit u njohën me dakortësitë e ardhura nga shoqata që nuk patën mundësi të jenë të pranishëm në këtë takim si "Nisma Dibrane" në Peshkopi, "Golloborda" në Durrës, "Ekspertët e rinj mjedisor në Bulqizë, shoqata "Votra Dibrane" në Dibër të Madhe, "Shoqata Atdhetare Dibra" në NY; FNAI në Itali; Kulturore Italo-Shqiptare në Itali, etj.

Unioni i Shoqatave Dibrane synon që të bashkërendojë veprimtaritë e shoqatave duke ruajtur pavarësinë e tyre si dhe të bashkojë zërat e tyre në një të vetme për çështje të rëndësishme të komunitetit në Dibër e Tiranë. Grupi i punës do të hartojë memorandumin e mirëkutimit dhe mënyrën e funksionimit, dhe pasi kryesitë përkatëse ta diskutojnë dhe të japin sugjerimet finale, do të firmosin së bashku.



Presidenti i Republikës Bujar Nishani dekoron
me Titullin "Mjeshtër i Madh" artistin dibran

dekorim

Skënder Cala, *i magjepsur nga "Magjia e Dibrës"*

***Nga* Halil RAMA**

Presidenti i Republikës, Bujar Nishani i akordoi zotit Skënder Cala Titullin **"Mjeshtër i Madh"** me motivacionin: *"Në vlerësim të kontributit të shquar në fushën e regjisurës, aktrimit dhe muzikës, si një nga përfaqësuesit e denjë të përcjelljes së vlerave, traditave dhe kulturës së komunitetit dibran në mbarë vendin tonë dhe më gjerë"*. Qoftë edhe ky motivacion që shoqëron Dekretin presidencial të dekorimit nr. 9469 dt. 17/03/2016, shpreh vlerësimin e kreut të shtetit për artisin e mirënjohur dibran.

Ceremonia në presidencë, në praninë e dhjetra miqve të z.Cala, mes të cilëve: deputeti Sherefedin Shehu, artisti i Popullit Robert Ndrenika, Prof. Dr.Bujar Kapexhiu, Piktori i mirënjohur Buron Kaceli, Shaqir Rexhvelaj (Mjeshtër i Madh), Besim Ndregjoni (Mjeshtër i Madh), Edmond Zhulali (kompozitor i shquar) etj, qe vërtetë mbresëlënëse.

Vetë Presidenti Nishani mbajti një fjalë, në të cilën sintetizoheshin arritjet dhe vlerat që bart "Mjeshtri i Madh" Skënder Cala, si artist, regjisor, aktor, këngëtar e shkrimtar si dhe dimensionin njerëzor të këtij dibrani të shquar.





Skender Cala: "Dibranët janë një specie e veçantë, sepse sido që të vijë puna, nuk e prishin shtëpinë e tyre.
Të mençurit, ata që e stërhollonin fjalën, duke e përpunuar në laboratorin e inteligjencës dibrane, dinin që t'i vendosnin gjërat në vendine tyre; vlerësonin dhe burrat që kishin me vete peshoren, metrin, dhe kunjin e mprehur në të dyja anët...".

NË RRUGËN DREJT ARTIT, MES DY DASHURIVE TË MËDHA

Skënder Cala e nisi rrugën drejt artit, mes dy dashurive të mëdha, Korabit hijerëndë dhe Drinit plak që e kishte zbutur e burrëruar, e kishte bërë më të urtë, më të mençur, siç janë Dibra dhe dibranët.

Ai kujton vitet kur turrej me tersëllimë nëpër zabelet e Përroit të Madh, kur kalonte dushqe, kërcunj, lisa, kanale, prita e porene arash dhe ndjente mbi shpinë grahmën tërbuese të egërsirave. Ashtu si Qatip Cala, i cili si i lidhur me historitë e fisit, atë që dinte e hodhi në librin e tij "Në kërkim të një fisi", edhe Skënderi kërkon që njerëzve e ngjarjeve t'u vendosë emër, që të mos mbeten anonime si mjaftë gjëra të papërsëritshme në historikun e fiseve...

Për herë të parë, kur sapo kishte mbaruar klasën e tretë, fillojë të dëgjojë jaren shkodrane, ta mësojë e këndojë atë. Këngët: "Për mue paska qenë kismet", "Pra në kjoftë kjo e vërtetë", "Kalaja e Shkodrës", "Dalin vajzat prej mejtepi" u futën në repertorin e tij me tekst e muzikë origjinale, që në fëmijërinë e tij, kur s'i shkonte ndërmend se do të bëhej këngëtar...Fare i ri, 15 vjeç ai do të shërbente si mësues në shkollat fillore të Reçit e Dardhës, nga ku mësoi me zell filozofinë dibrane.

Kur futej nëpër zabele, këngët e bilbilave, trumcakëve e laureshave e çonin peshë shpirtërisht dhe ndjente sikur rritej orë e çast, bashkë me ritmin e tonalitetin dhe tingujt fantastikë të atyre mjeshtërve, që Zoti i kishte krijuar për të hijeshuar natyrën e për të zbutur egërsinë e jetës....E tërhiqnin veshjet e krahinës së tij që janë me larmi formash e kolorit ngjyrash, ku dhe puna artistike që është përdorur për realizimine tyre është shprehje e shpirtit krijues të nënave, motrave, nuseve e vajzave tona, të cilat kanë derdhur në këto veshje artin e papërsëritshëm të popullit. Po ashtu mahnitej nga veshja e burrave prej koporaneve dhe tirqve të zezë, brezit të mesit me një pafundësi ngjyrash, ku e zeza, e kuqja dhe e bardha bien më në sy...nga çorapet e leshit të burrave, të thjeshtë ose me midiskame, me kolor ngjyrash dhe figurash të ndryshme me yje, lule, rrathë, trekënëdësha, me vlera të veçanta artistike....

Me përshkrimin e veshjeve që përdornin malësorët e Dardhës, Skënder Cala të krijon përshtypjen se "malësori pa kësulë, tirq e koporane, pa çorape leshi e opinga me norta nuk mund të ketë ato vlera burrërore që jemi mësuar të shohim në qëniene tij. Këto elementë sikur e kompletojnë atë, i japin vlera më burrërore, e bëjnë më të pranueshëm në sfondin e legjendave të maleve, bëmave dhe ngjarjeve të historisë....

Duke argumentuar institucionin e shenjtë të burrave në kryet e vendit, z Cala konkludon se "dibranët janë një specie e veçantë, sepse sido që të vijë puna, nuk e prishin shtëpinë e tyre. Të mençurit, ata që e stërhollonin fjalën, duke e përpunuar në laboratorin e inteligjencës dibrane, dinin që t'i vendosnin gjërat në vendine tyre; vlerësonin dhe burrat që kishin me vete peshoren, metrin, dhe kunjin e mprehur në të dyja anët...".

Në këtë kontekst e rendit ai përkujdesjen e e Hazis Ndreut, porositë e tij për kujdesin që duhej të tregonte për zërin, që ta ruante atë se e kishte pasuri që ia kishin dhuruar nëna e baba. "Mësoi këngët e Dibrës se janë flori, kanë melodi të bukur dhe tekste përrallore..Kështu i dukej Hazisi edhe muzikant, edhe poet, edhe i ditur."

Rrugës duke shkuar për në Vilë ku ishte mësues, filloji të thurë ëndrra në mendjen e tij prej të riu..E shihte vetën nëpër skena, duke kënduar si Hozelito i vogël te filmi "Dëgjoni këngën time..."

Hazisi ia kishte futur keq fitilat si Sheherezadja, që çuditi mbretin e Persisë në "Njëmijë e një netë". Ideja e Hazisit për të përvetësuar foklorin e popullit e tërhoqi shumë. Ai e dinte se dernjani sa bie prej djepi e gjer kur bëhet gati për të shkuar n'atë botë kërcen.... Ëndërronte si muzikantët më të mëdhenj të botës, si Bah, Bethoven, Verdi, Puçini, Moxarti të cilët ishin ulur këmbëkryq në shpirtin e popullit dhe kishin marrë prej tij nektarin e këngës popullore...

GJIMNAZISTI I SHKËLQYER I GJIMNAZIT TË KUADROVE TË ARSIMIT

Më pas do të ishte gjimnazi i kuadrove të arsimit në Tiranë, shkolla që e përgatiti S.Calën si mësues me njohuri e dije shkencore dhe nga ana tjetër nxori në pah dhuntitë e talentin e tij për t'u marrë veçanërisht me futbollin dhe rrethet artistike, sidomos me këngën...Me repertorine tij muzikor u muar vetë drejtori Riza Hajro, që kishte mbaruar studimet në Bashkimin Sovjetik, që e njihte muzikën ruse mjaftë mirë, këndonte me pasion dhe kishte dëshirë të interpretonte bukur..

Në një konkurs final me shkollat e kryeqytetit, Skënderi ka kënduar dy këngë "Azerbajxhani ynë"(e kënduar nga këngëtari Reshit Bejbutov) dhe "Kënga e dashurisë së parë" . Krahas këngëve ruse repertorit të tij iu shtuan edhe këngë italiane sidomos ato napolitane. Për të ishin mjaftë të dashur këngëtarët italianë si: Domeniko Modunjo, Klaudo Vila, Pepino di Kapri, Luçiano Tajoli. Por ato që e mahnisnin dhe e linin pa gjumë gjithë natën ishin këngëtarët operistikë Mario Delmanok, Henriko Karuzo dhe më vonë Luçiano Pavaroti e Plaçido Domingo. Ndërkohë filloi të magjepsej pas zërave të bukur të Llukë Kaçajt, Mentor Xhemalit, Avni Mulës, Ramiz Kovaçit, Stavri Rafaelit, Kristaq Antoniut dhe Gaqo Çakos. Gjithsesi, adoloshenca e tij, si dhe e qindra e mijëra bashkëmoshatarëve, u shtyp nga trysnia e halleve.

Më vonë, kur u burrërua dhe mori rrugën e vërtetë të artit, duke u bërë artist i skenës si këngëtar, aktor e regjisor e ka takuar si mik të paharruar Riza Hajron, i cili për erudicionin kulturor e artistik që zotëronte, u bë drejtor i Teatrit Kombëtar dhe më vonë drejtor i Teatrit të Operas dhe Baletit...

Ditën që mbaroi gjimnazin dhe mori në dorë dëftesën e pjekurisë, ndjeu sikur një ngërç i madh i pushtoi gjithë trupin dhe ju duk vehtja si i paralizuar. Sepse ëndërronte Tiranën ndërkohë që do t'i duhej të endej nëpër malësitë e Dibrës, duke ndërruar shkollë një herë në gjashtë muaj apo një vit, për një copë bukë.. Por gjithsesi ato vite i shërbyen për të mësuar gjuhën e veçantë të dibranëve me shifra e kode, që gosite me pambuk, por therte gjer në palcë, mjeti artistik i të cilëve ishte humori që përdornin, që në esencë kishte një dramacitet e tragjizëm të thellë, që digjte e përvëlonte si zjarr.

SI SHPËTOI ARTISTI, PAS TRE INCIDENTEVE QË I KURDISËN ISH AGJENTËT E SIGURIMIT TË SHTETIT

Regjisori, këngëtari dhe aktori i roleve në disa filma e teatro e ka provuar dhe trysninë e pushtetit makabër. Pikërisht në sallën, fare pranë "Bulevardit të blirëve", për të cilin sot ndjen dhimbje, para tre dekadash ju bë "gjyqi në kolektiv", sepse sigurimsat kishin sinjalizuar lart se "Skënder Cala, shikon çdo natë në televizor stacione të huaja, duke iu kundërvënë hapur vendimit të Komitetit të Partisë së rrethit për zhdukjen e antenave televizive". Nomenklatura e asaj kohe ishte shqetësuar dhe po i bënte gjyqin në kolektiv, për të përcaktuar se çdo të bëhej me këtë njeri të pabindur që shkonte kundër rrymës?!

E mbrojtën artistin e qindra roleve të spikatura, Artisti i Merituar Hazis Ndreu, ish drejtori Adil Shehu dhe kolegu Abdyl Sturçe, mbrojtje kjo që i detyroi të dërguarit e nomenklaturës të largoheshin me bisht ndër shalë...

Në korrik '65 e përjashtuan për një vit nga Instituti i Arteve sepse kishte mbrojtur shokët që një të shtunë ishin larguar nga aksioni në fermën e Sukthit dhe kishin shkuar në Tiranë të laheshin e të bëheshin gati për të hënën, ai u shpëtoi falë zgjuarsisë prej dibrani të sprovuar. Ato vite ishte stërholluar lufta e klasave dhe veçanërisht shtrirja e veprimtarisë së Sigurimit të Shtetit në çdo qelizë të shoqërisë shqiptare kishte krijuar një gjendje terrori në gjithë vendin.... Këtë terror e ka përjetuar me ankth edhe S.Cala, që si artist ka interpretuar mjeshtërisht role në flimat "Guximtarët" (me partner "Artistin e Popullit" Sandër Prosi), "Kërcënimi" përkrah Rajmonda Bulkut e Stavri Shkurtit, apo dhe tek "Çeta e Vogël" ku pati rastin të ketë partnerë aktorët e mëdhenj Ndrekë Luca e Marie Logoreci. Por bashkëkohësit e mbajnë mend Skënderin edhe tek filmi "Skënderbeu", kur në moshë krejt të njomë gjendet mes dhjetra fëmijëve, grave e pleqve, i veshur me lecka si malësor i vogël, në atë mori flakësh, britmash e ulërimash prej tmerrit të turqve....

SUKSESI I PARË SI PROFESIONIST ME SHFAQJEN "TË FALA NGA KORABI"

Duke shfletuar jetën e tij në udhën e vështirë të artit Skënderi kujton kohën kur, nga Sorica e largët ku shërbente si mësues shkon në Peshkopi si këngëtar në Estradën e qytetit, kujton repertorin e tij të parë muzikor që përbëhej nga këngët "Shkurta e Hoklit", duetin "Kufitarët" me Muharrem Zajmin dhe këngën e "Hatixhes". Djali i ri nga Lugjejt e Zall Dardhës vokalin e kishte të pastër dhe arrinte në nota tenori, pavarësisht se ishte bariton..Të gjithëve u bëhej qejfi, por veçanërisht Hazis Ndreut që e kishte prezantuar si këngëtar dhe Tonin Rrotës, i cili si kompozitor shpresonte që me të të bënte punë të mira.. Dhe këto "punë të mira" u dukën fare qartë në turrneun më të gjatë e të suksesshëm të Estradës Profesionte të Peshkopisë, në Tiranë dhe në gjithë Shqipërinë, në maji 1961, me shfaqjen "Të fala nga Korabi".

Në Institutin e Arteve shkoi i burrëruar, ndoshta më i pjekur se shumica e studentëve të kursit të tij..Asgjë s'i mungonte që t'i përkushtohej shkollës dhe profesionit të bukur, por të vështirë të aktorit. Fati i madh për të ishte që këtë kurs e drejtonin udhëheqësi artistik Kujtim Spahivogli dhe pedagogët Naim Frashëri, Pjetër Gjoka, Mihallaq Luarasi dhe Prokop Mima...

Kur i doli e drejta e studimit dhe po vinte për në Tiranë, u betua se do ta rrallonte rrugën për në Dibër, sepse dega që kishte zgjedhur kërkonte punë, prova e studim. Por Dibra, sado të mundoheshe për t'iu larguar, ajo t'i ngulte kthetrat e të tërhiqte rreth vetes si magjistare.

Dibra ishte si një dashuri klandestine, që vjedhurazi të pushtonte mendjen e zemrën dhe dalëngadalë të mbërthente plotësisht duke të bërë për vete, siç na bën edhe libri i tij me vlera të rralla letrare e artistike "Magjia e Dibrës".

OFROJMË
- redaktime - korrigjime - ftesa - fletëpalosje
- fotokopje - kartvizita - printime - lidhje libri
duke filluar nga 1 kopje e vetme!
Çmime të favorshme dhe shpejtësi!
Telefono: 068 65 08 441

ese

Bý të Drínit!

Nga **Dionis XHAFA**

Drini është dhurata jonë prej Zotit a prej Natyrës kush të jetë se nuk beson në fe, por edhe drama nga ana tjetër e një vendi rebel të ngjashëm me vetë njësinë e afërt gjeografike e gjeopolitike të veten.

Drini është simboli ynë i përbashkët, forca jonë, dhimbja dhe ura jonë. Ky është lumi ynë që rrjedh pa ndaluar as edhe një cast njëjtë sikundër edhe jeta jonë e bijve të Drinit.

Po Drini është fati ynë i padijshëm që kërrkush prej nesh nuk e di se ku mund ta përplasë.

Ky është lumi që veç rrjedh e sikur nuk çan kryet për atë sesi rrjedhin fatet e jetëve të njerëzve të vetë vendit ku lumi gjarpëron.



Drini, foto © Edmond Hasani

Lumi veç rrjedh, e lag këtë tokë – ua lag trupat bijve të vet por se prapë veç ecën pa dashtë me dijtë për pengesa: as për trupa, as për kaçuba, as për drunj, pemë, gurë e zhavorrë.

Drini jonë është fati i pandashëm me jetët tona. E se më tej Drini që rrjedh nga anët tona – që i lag tokat e Dibrës tek derdhet në Adriatik – quhet si për dreq: i Zi.

Po ç'domethënë i zi? Si mundet që lumi të jetë i zi? Unë si dhe ju jemi larë aty.

Po jemi larë dhe jemi shpërlarë në lumin e Ballkanit, që kryq e tërthor i bie një gadishulli të kryqëzuar keqas mes Lindjes dhe Perëndimit.

Por mos u çudisni nga fakti se ju e keni parë lumin e pastër dhe se nga ana tjetër ky lum na qenkërkash "i zi".

Mos bëni sikur nuk e keni parë edhe të zi jo veç të kaltër dhe të bardhë e jo gjithnjë të qetë.

Drini hera-herës në stinët e egra sidomos ngrihet lart si vullkan dhe stërkalat i lëshon deri në Urën e Topojanit.

Po ashtu e vërtetë është se me siguri që e keni parë se në lum – kur ai tërbohet – krijohen vorbulla të rrezikshme që përpiqen të të gëlltisin, të të hanë e të të rrjepin.

Nuk është gënjeshtër po ta themi se Drini ka këputur edhe jetë, madje të njoma krejt që shuhen në vorbulla të tërbuara si kuçedra.

E pra Drini është krenaria jonë e dhuruar prej Zotit po aq sa edhe fataliteti ynë i përditshëm, i çdokohshëm, i pandalshëm.

Drini është fati ynë i turbulluar si tel i pazgjidhshëm; Drini është zemra jonë e rrëmbyer, fytyrat tona herë të rrëmbyera dhe herë fatkeqe, krejt jeta jonë me të mirat më shpresëdhënese dhe të këqijat më vdekjeprurëse.

Po ç'ka është Drini, rrjedhja e këtij lumi me nam të madh në anët tona e në Gadishullin Ballkanik? Ç'ne ky Drini qenkërkash fati ynë, zemra jonë, pulsi ynë, gjymtyrët tona?

Pse kaltërsi e Drinit qenkërkash fati ynë i ndezur, e vorbullat e lumit famëmadh qenkërkan gërmadha e varri ynë?

Pse Drini qëndron hijerëndë mbi fatet tona njerëzore e se pavarësisht se çfarë ndodh sot, nesër e pasnesër, ky lum i gjatë veç ecën – pa u lodhur dhe pa u ndjerë.

Pse Drini është i lidhur pashmangshmërisht me emocionin tonë njerëzor me gëzimin, lumturinë, harenë, fatmirësinë, bardhësinë – e nga ana tjetër me tmerrin, lemerinë, plogështinë, harresën, mallin, plagosjen, vrasjen.

Drini është si jeta jonë e andaj jemi të lidhur pashmangërisht me këtë lum.

Drini qysh nga Ohri ku e nis udhëtimin e derisa bashkohet me Bunën në Shkodër, ecën pandërprerë, duke marrë përpara gjithçka që e gjen.

Pavarësisht se lumi has në pengesa, në vështirësi, në drunj e në hunj ai ecën duke e lënë pas ç'ka i ndodh, edhe pse merr goditje të konsiderueshme.

Po ku ngjasojmë ne, jeta jonë me Drinin? Sigurisht që ngjason, tepër madje.

Sikundër rrjedh Drini ashtu rrjedh edhe jeta jonë me fate të kryqëzuara e të panjohura, në shtigje të rrezikshme e një jete që nuk gjen rehati deri në pushimin e zemrës.

E kësisoj ne, jeta jonë është si Drini ynë, herë e ngazëllyer në stërkala e herë me fishkëllima e vorbulla thithëse.

Ne bijtë e Drinit bëjmë nga një hap për çdo ditë. Ne shembim botë, luftojmë dragonj flakadanë, këpusim mishtë, ngadhënjejmë ëndrra, për liri e mirëqënie, goditemi, çohemi sërish, rrëzohemi dhe rivazhdojmë.

Ne bijtë dhe bijat e Drinit ndryshojmë nga lumi vetëm në atë se ky lum mbart pavdekësinë e ne të gjithë jemi vdekatarë.

Por edhe se lumi vdes, shuhet kur derdhet në Bunë e se përfundon në det së bashku me ujërat e lumenjve të tjerë.

Nëse nuk jemi lum, atëherë secili prej nesh është pikë uji e këtij lumi e se secili derisa të shuhet përballet me sfida, rebeshe, krisje, tensione, kriza, depresione, e gjithëçfarë sëmundjesh a murtajash.

E pra, Drini është si vendi ynë dhe ne si piklat e tij. Drini sikundër Dibra në mos janë këtu qysh prej formimit të tokës.

Ne jemi udhëtarë të përkohshëm të një udhëtimi çmendurak, aventuresk, që s'dihet sesi e ka fundin e vet.

Po qe se piklat metaforikisht ne bijtë e bijat e këtij Drini e nisin udhën kristal dhe se edhe pengesat rrugës të lënë po kristal Drini do krenohej.

Pra, nëse në udhëtimin e jetës tënde, po qe se do të jesh i pastër kristal, tiu kesh shërbyer njerëzve ndershmërisht e me drejtësi, vendi do të ishte krenare me ty dhe e kundërta: nxirja ta bën fundin e hidhur.

Në fund të rrugëtimit secilit prej nesh një prehje e përhershme na pret. Nderimi, respekti, e mirënjohja sigurt do të jetë në raport me atë sesa pastër e kreve udhëtimin e jetës, e se kristali do ta ketë qiellin e kaltëruar, kurse zezonja më tepër do të ishte barrë për tokën e vendin.

Përpiqu të bëhesh Kristal i jetës tënde. Respekti, nderimi, e mirënjohja në jetë ta rrisin famën e mirësisë, kurse mendjemadhësia e veprat e këqija ta damkosin fundin tënd.

Rrugëtimi për secilin nuk është i lehtë, por mbushur me peripeci, ankthe, pengesa, vështirësi, lodhje, strese, probleme.

Në mund të durosh të gjitha ndjesitë e hidhura; të sillesh drejt edhe kur ndaj teje sillen padrejtësisht e në nivel të të padrejtës të mos biesh, lavdia do të të përkasë.

Në mundsh që qetë e racional të qëndrosh e në parime krejt pa u përkulur, kurrë pa i prekur lirinë tjetrit pa vrarë, pa prerë, pa dhunuar, pa cënuar, por në heshtje të qëndrosh e i përulur të sillesh, respektin e njerëzve do ta kesh.

Në mundsh që zemrat e tradhëtuara ti qetësosh, të varfërin ta ndihmosh, të pangrënin ta ushqesh, njeriun me lëkurë të bardhë a të zezë njëlloj ta respektosh; në mundsh të harrosh kur të tjerët ferrin ta bëjnë, të largohesh kur e ndjen të keqen e krejt pa folur të qëndrosh, emri yt më lart e për mirë do të përmendet.

Sepse fundja nëse në këtë jetë në tokë të përkohshme iu bën mirë njerëzve, dije se ata të mirën do të ta kujtojnë e do të të nderojnë.

E kundërta është se emri yt nam të madh zemërkeqi do të ketë.

Bëj mirë për veten, emrin tënd, komunitetin, të prekësh zemrat e njerëzve që duan dashuri, sepse kështu – siç shprehet Kipling në poezinë e tij të famshme – edhe bir (a bij) i denjë (i Drinit) do të jesh!

Tiranë, 16 mars 2016



Bulqiza, foto © Bujar Karoshi

Një ditë *nga jeta e një punëtori* **në galeritë e Bulqizës**

Nga **Edison BALLA**

Alarmi i celularit bie. është ora pesë dhe duhet të ngrihem. Ndërkohë, shumë pyetje më vijnë në mendje: A do të lodhem edhe sot si dje? A do të jetë shumë i ftohtë mëngjesi? A do mund të ngjitem nëpër "furnele" pa u dëmtuar, siç më ndodh shpesh? A do të dal i gjallë nga ajo galeri? Ndërkohë që i përgjumur mendohem, hapat e nënës time vijnë nga dhoma tjetër për të më zgjuar, për të më dhënë, si çdo ditë, përqafimin e ngrohtë të mëngjesit dhe bekimin për tu kthyer shëndoshë e mirë nga ajo galeri, e cila është shndërruar në makthin e nënës sime, të të gjitha nënave, të cilat mendojnë se mbase ai përqafim mëngjesi mund të jetë e fundit për djalin...

Dal nga shtëpia me kokën pas porsi një refugjat i përhumbur. Furgoni i linjës është i mbushur me të rinj që e shohin galerinë si të vetmin burim jetese,nga e cila nxjerrin kafshatën e gojës për veten dhe familjet e tyre. Brenda në furgon askush nuk flet. E vetmja zhurmë janë dridhjet dhe rropatjet e sendileve që vijnë nga gropat që gjenden në rrugën e degraduar. Sheh vetëm fytyra të zverdhura e të përgjumura, të zhgënjyer nga e tashmja dhe të pashpresë se një e ardhme më e mirë mund të jetë shkruar për to.

Edhe pse ora është gjashtë e mëngjesit, "qyteti i minatorëve" gumëzhin nga numri i madh i punëtorëve që vijnë pothuajse nga çdo fshat fqinje. Lokalet janë të tejmbushura dhe qëllon shpesh që mezi gjen një tavolinë boshe për të pirë kafen e mëngjesit. Ulem aty në një kafe në qendër të qytetit me shokët e mi të vjetër, që megjithëse të rinj, ashtu si unë, punojnë në galeri...

Rreth orës shtatë nisem nga qyteti për të arritur më pas në atë që njihet si "Zona D", zona mineralmbajtëse më e njohur në Bulqizë. Në minibuzin e punës të mbushur plot me punëtorë, bisedat janë rreth inventarit të djeshëm të kromit dhe objektivave që synojnë të përmbushin për ditën e sotme, a thua po e nxjerrin për vete kromin... Ndonjëherë, më vjen të ngre zërin për gjithë këto padrejtësira që bëhen, por sapo kthej kokën në anën tjetër, shoh përgjegjësin e turnit, i cili nuk harron të ritregojë diku tjetër çdo bisedë që bëhet aty...

Pasi zbres në vendin e quajtur "Piecale", shpejtoj hapat për tu ngjitur sipër, afër hyrjes për në tunelin e errët të galerisë. Aty afër gjendet një barakë e sajur, ku era e ftohtë dhe e acartë hyn nga çdo anë. Shpejtoj të ndërrohem, pasi përgjegjësi i punës ka urdhëruar që të futemi sa më para në galeri...

Ashtu, të bindur dhe kokëulur, futemi brenda në galeri, ku uji i ftohtë që të bie nga sipër, të bën qull akoma pa filluar punën. Temperaturat disa gradë nën zero të bëjnë të shpejtosh hapat për tek vendi i punës, që të fillosh të punosh për të luftuar të ftohtin e nëntokës. Tuneli nga hyrja për tek vendi i punës është plot 8 km, por sot më kanë caktuar të punoj në nënkatin e tetë, dhe për të shkuar atje më duhet të ngjis shumë furnele e "hapësina" që janë një hap larg vdekjes. Sot më kanë caktuar të punoj me një ortak që më shkon shumë muhabeti, do lodhemi e do rraskapitemi si çdo ditë, por të paktën do shkëmbejmë dy fjalë të mira. Ortaku im, edhe pse është vetëm dy vite më i madh, thotë se tashmë është bërë ekspert në këtë punë, pavarësisht dëmtimeve dhe lëndimeve trupore që tregon se i ndodhin çdo ditë. Fillojmë të punojmë e të "hahemi me shpirtin" pasi duhet të realizojmë normën, përndryshe e nesërmja na gjen pa punë dhe pa kafshatën e gojës. Në këtë vend që po punojmë, mesa duket kromi është i gatshëm që në kohën e "xhaxhit" dhe ne duhet të bëjmë të pamundurën që ta zbresim deri në nivel. Vazhdojmë ashtu intensivisht, por të pashpresë se diçka do ndryshojë në këtë vend të kapur ....

Ikën edhe një ditë. Ndërsa unë dola gjallë nga galeria, pronarit im është i mërzitur. Ai ka pasur halle këto muaj. Thonë se çmimi i kromit ka rënë dhe ai është i mërzitur... Fitimet i kanë rënë. Ndërsa unë jam i lumtur që sot do të mundem ta ushqej familjen time. Dhe lutem që edhe neseër, në mos do të jetë më mirë, të paktën të më jepët mundësia të punoj sërish për bukën e përditshme të familjes...

Rruga e Arbërit nr. 116

Jeta e fshatrave shqiptare në Grykën e Rekës së Epërme,
Dibra e madhe (Maqedoni) është shkruar
nga Franz Baron Nopcsa & Bajazid Elmaz Doda.

recension

Libër me vlera të larta **për etnokulturën** shqiptare

Jeta e fshatrave shqiptare në Grykën e Rekës së Epërme, Dibra e madhe (Maqedoni), është shkruar nga Franz Baron Nopcsa & Bajazid Elmaz Doda. Libri është një vepër historike-kulturore, ruajtur në Bibliotekën Kombëtare të Austrisë, përfunduar në vitin 1914 nga autori, asokohe njëzet e gjashtëvjeçari Bajazit Doda. Nga parathënia e përpiluesit, lë të kuptosh se teksti në fjalë është përkthyer nga Nopcsa në gjermanisht. Libri është shqipëruar nga origjinali nga Nexhat Mehmedi dhe është shtypur në shtypshkronjën"Evropa 92" Koçani

Nga Edibe SELIMI-OSMANI

Një përkthim nga gjermanishtja me vlera të larta për etnokulturën shqiptare që kanë objekt studimi e trajtimi çështje nga fusha e antropologjisë, përkatësisht etnologjisë, por edhe atyre që merren me fusha simotra të saj, botimi i këtij libri pëkthyer nga Nexhat Mehmetiështë i mirëpritur dhe plotëson mungesën e literaturës që ndihej në këtë sferë.

Shqipëruesi Nexhat Mehmeti, si njohës i mirë i të folmes karakteristike të kësaj krahine, ku një pjesë të jetës e kaloi në vendlindje, në fshatin Rimnicë, Reka e Epërme, ka bë një përkthim të mrekullueshëm. Ai është i diplomuar në gjuhën gjermane të nivelit më të lartë. Gjatë përkthimit prof. Nexhati, vëren fjalët e shumta shqipe dhe emrat e vendeve dhe toponimeve, të cilat i gjen në tekste. Ata janë të shkruara nga Doda dhe Nopcsa me shkrimin e gjermanishtes dhe jo gjithmonë në mënyrë konsekuente, kështu që edhe pas disa përshtatjeve nuk është ndryshuar origjinaliteti i fjalëve.

Ndërsa albanologu i njohur Robert Elsie, për veprën në fjalë konstaton se *studimi i pranishëm është një pasuri e madhe të dhënash dhe informcionesh, përtej të gjithave, ky studimi në gjuhën gjermane ku autori i të cilit, është një shqiptar nga Shtirovica, mundë të thuhet se është një Etnograf*.

Në Parathënin e tij Nopcses, ndër të tjerat shkruan se "*pa njohuritë rreth jetës primitive të popujve të vjetër është e pamundur të bëjmë histori për epokat parahistorike (për jetën e popujve në epokën parahistorike)*". Nopcse, me të drejtë shkruan *se "nuk mund të përfitohet bindja se një shqiptar sikur Doda, të marrë për detyrë që të bëjë një përshkrim të përpiktë, deri në detaje, jetën e përditshme të një krahine relativisht primitive, gjegjësisht të krahinës shqiptare në shpatinjtë lindorë të Korabit*.

Sipas mendimit të Bajazit Dodës, qëllimi i veprës është për të pasuruar unitetin dhe vendosmërinë e bashkëfshatarëve dhe për të lënë një vepër të përhershme në letërsinë shipe, me qëllim historik-kulturor për pasqyrimin e jetës së shqiptarëve në Rekën e Epërme, thjeshtë përshkrimin e jetës ashtu siç e kam përjetuar edhe vetë, ditë pas dite në këtë skutë të rruzullit tokësorë.

1. PËRSHKRIMI I REGJIONEVE

Në kapitullin e parë të veprës në fjalë "*Përshkrimi i regjioneve*" përshkruan vendbanimet e Rekës së Epërme, relievin, konfigurimin e këtij vendi malor, linjat e komunikimit, klima, vegjetacioni, përshkrimi fizik i popullatës së kësaj krahine e tjerë.

2. DOKET

Në kreun vijues, *doket(zakonet, traditat, adetet*), autori përshkruan ceremonitë tek lindja dhe vënia e emrave, ku në veçanti vë në dukje vyrtytet bujare dhe guximin që ka femra deri në aktin e lindjes së foshnjës."*Kur vinte momenti i lindjes, i zoti i shtëpisë(babai i foshnjës) dhe të gjithë meshkujt largoheshin nga shtëpia, që momenti i lindjes të jetë më i lehtë*". Survivale të fundit të lehonis sipas dr.Ukë Xhemës, i takojnë grupit të tretë, mungon tërësisht, prania fizike e burrit në zakonet rreth lehonisë. Në këtë fazë nuk është e pranishme qenia fizike e burrit. Mendojmë se kjo është faza e e paraqitur në mënyrë simbolike e elementit të lehonisë mashkullore.

Po në këtë kapitull, paraqet proceset dhe fazat e jetës individuale e kolektive të kësaj krahine, si akt i rëndësishëm i trashëgimisë familjare, martesa me të gjitha fazat e saj, ceremoni e rite rreth vdekjes, si dhe zakone e besime të varrimit. Si në shumë krahina të tjera edhe në Rekën e Epërme, jeta dhe mënyra e jetesës kanë reflektuar me rite e besime karakteresh të ndryshme.

Në vazhdim autori cekën traditat e daljes së dhëmbit të parë tek fëmijët, lojra fëmijësh, ceremonitë gazmore të synetit. Martesa, si moment më i rëndësishëm në jetën e njeriut, zë vend të theksuar në këtë vepër. Ceremonitë e fejesës e të dasmës, kanë rrjedhat e veta të dokeve e të zakoneve, të normave morale, etike, juridike e patriarkale, që paraqesin lëndë të pasur edhe për studime etnografike.



Siç kemi njohuri se festat e motmotit janë prodhim shpirtëror i popullit. Ato janë krijuar gjatë rrjedhës së shekujve dhe janë përcjellur nga brezi në brez. Në këtë vepër, si nënkapitull *Festat e rëndësishme dhe festimi i tyre*, janë shënuar Shumtanasi (Shën Tanashi) që festohet në muajin Shkurtë, Dita e Verës, Shyngjergji që festohet në fillim të majit, Shynkrysha (Shën kryqi) në fund të shtatorit. Zanafillën e tyre ato e kanë në kohë shumë të vjetra e kanë evoluar bashkë me kushtet e bashkësisë njerëzore. Është tepër e njëanshme t'i shpregosh këto dukuri me rrënjë që nga lashtësia ilire e paleoballkanike vetëm si gjëra primitive. Duke parë vlerën e veçantë të besimeve popullore e të riteve të tyre, me eksplorime terreni, kemi mbledhur një material të konsiderueshëm për festat e ritet e motmotit ku në këtë krahinë etnografike janë të shënuara 43 kremete. Në këtë vepër Doda, i anashkalon kremtet tjera që festoheshin në këtë krahinë.

III. PARAJA DHE FITIMI I PARASË TEK REKALINJTË

Jeta e përditshme e banorëve të krahinës në fjalë, vendi në të cilin jetonin është varur shumë edhe nga pozita gjeografike me male shkëmbore në të cilat dimri është i gjatë dhe i ftohtë, që me të vërtetë ua kushtëzonin banorëve të atjeshëm mënyrën e jetesës, e bënte jetën e rekalijve dita ditës më të vështirë. Por, mençuria popullore ka krijuar ligjet popullore, kanunet dokesore për t'u vetëqeverisur në mungesën e një shteti kombëtar të centralizuar. Kështu ka krijuar rregulla të marrëdhënieve shoqërore e të ekuilibrit në lidhjet bashkëfshatare e krahinore me ato mes krahinash të ndryshme. Një vend të rëndësishëm në psikologjinë e vendasve ka qenë forma e *fitimit të parave tek Rekalinjtë*. *I tërë kapitulli në fjalë përfshin veprimtarinë ekonomike të Rekës së Epërme, si bujqësinë, blegtorinë, mjeshtrinë popullore, gjahun, peshkimin e tjerë*.

Po në të njejtin kapitull, *Forma e fitimit të parave tek Rekalinjtë,* janë përfshi nënkapitujt: *Kultivimi i dhenve*, vendosja në kullota, bjeshkë, stane, ndërtimi i kasollës së barinjve , emërtimi i orienive të stanit, të dhënat për çobanët dhe të punësuarit të tjerë në stane, klasifikimi i deleve, prodhimi i qumështit dhe produkteve të tij, jeta e barinjve, qethja e deleve, rrjepja dhe përpunimi i lëkurës së deleve. Gjendja e një kasolle barinjsh: stani në vjeshtë, largimi , shpërngulja nga kullotat e bjeshkës, marshi, rrugëtimi i tufave drejtë kullotave të dimrit, sjellje e të njëjtëve, fitimi nga kultivimi i deleve, sëmundjet e deleve, ditët e kurbetit tek rekalinjtë, qëllimi i shkuarjes në kurbet, nisja për në kurbet. Shitësit e produkteve ushqimore, si salepi, hallva, boza, përfaqësuesi i mallrave të përpunuara, duhanit e tjerë. Është plot e arsyeshme bindja e Dodës, ku thotë se vet ekzistenca e një numri të mjaftueshëm të kullotave (bjeshkëve), vetvetiu i ka bë Rekanët drejt kultivimit të dhenve, përndryshe ishte bërë traditë që fitimi i parave të fituara në vende të huaja, në kurbët, ta sillnin për ta harxhuar në shtëpi. Si pasojë e kësaj tradite, të gjithë rekalinjtë, sikurse edhe banorët e Dibrës, janë bërë kurbetqarë.

Këtë kapitull e zbukurojnë edhe fjalët e rralla, ata e pasurojnë leksikun që deri sot për gjuhtarët janë të panjohura. Në pamundësi për t'i përfshirë të gjitha do t'i veçojmë disa nga ato si:

Kutmaçi- qumësht i zier; *tylynup*- pjesë e mbrendshme e lëkurës; *shtyngjjet*-shkop i lëmuar prej druri që shërben për të mtollur brumin; *krypesan*- enë druri që shërben për të ruajtur kripën; *zhdrabillë*- lloj thike; *liplunga*-peshqir që shërben për t'i mbështjellë bukët etj.

IV. KULTURA MATERIALE

Për lexuesit janë mjaft me interes si: ndërtimi i një shtëpie, kompleksi i shtëpisë dhe oborrit (çifligut), plani, themelet e një shtëpie, orenditë e brendshme të shtëpisë, kompleksi i një mulliri, prodhimi i stofit, të tjerrit, të endurit (me vek), veshjet e meshkuje, veshjet e grave, ushqimet e miellit, ushqimet e mishit, ëmbëlsirat, ilaçet etj.

Janë të shumta ritualet arkaike të shënuara në këtë libër. Në pamundësi për t'i përfshirë të gjitha, do t'i veçojmë disa nga ato.

Në këtë krahinë kur i zoti i shtëpisë së bashku me familjen e tij hyn në shtëpinë e re, pasi të jenë larguar mjeshtrit, ***nënkuptohet që në mbrëmjen e parë*** *e zonja e shtëpisë kryen disa ceremoni rituale*.

Pra, hyrja për të parën herë në shtëpi të re për filozofinë popullore përfaqëson një rrethanë të veçantë, prandaj këtij akti i kushtohet kujdes, posaçërisht që merr përmasa rituale dhe ceremoniale. Domethënien e posaçme e ka edhe zakoni ***në mbrëmje ose para lindjes së diellit.*** Kjo na bën të kuptojmë paganizmin e lashtë dhe kultin e diellit të njohur mirë në kulturën ilire.

Është mjaft e arsyeshme se një vend të rëndësishëm në libër zen edhe veshja popullore shqiptare e Rekës së Epërme. Ajo paraqitet në të gjitha tipet dhe varianetet e pranishme në këto anë, e parë në procesin evolutiv, ku përfshihet veshja e burrave, e pleqve, e vajzave, veshja e grave e plakave me të gjitha motivet ornamentet e mundshme që shfaqen në to.

Me shumë hollësi autori dallon veshjen e verës dhe të dimrit. EdhepseShtirovicakufizohet me fshatrat e Rekës së Poshëme, vërejmë se elementet e veshjes-kostumet emeshkujve nuk ndryshojnë nga krahinat që e rrethojnë atë, përveç se tirqit, në Rekën e Poshtme, kanë qenë më të gjëra dhe pa gajtana, ose vende-vende me ndonjë zbukurim. Ndërsa tirqit në Rekën e Epërme, gjithmonë kanë qenë me gajtana.Personi që i ka vesh ata dallohej sipas gjendjes ekonomike që kishte.

Meshkujt në gjithë territorin e Rekës së Epërme, bajshin kësula prej leshi me formë gjysëmkonike ose të rrafshëta që quhen *qylah,* ose lloji i plisit *zofern*. Llojet e kësulave që i përshkruan Doda, shpesh bie në sy, që shqiptarët ortodoks në vend të *qylafit*, mbajnë kësula të rrafshëta, të kuqe me një xhufë ngjyrë manushaqeje (*ksul me kitka*).Muhamedanët i mbajnë flokët e shkurta me zullufe të mesme, ndërsa krishterët mbajnë flokë të gjata, përshkrimi i Dodës. Kemi të bëjmë me një krahinë karakteristike të lashtë që përkon me studimin e studiuesFatbardha Demi, kunë shkrimin e saj"*E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët*(Plisi, miti i origjinës së pellazgëve hyjnorë), Pjesa e II, thotë:"Plisi apo Qeleshja e shqipetarëve të sotëm është objekti që ka ruajtur dhe përcjellë MITIN e Origjinës së njeriut dhe Historinë e zhvillimit të besimit pellazg. Ajo ka simbolizuar lidhjen e njeriut tokësor me Krijuesin, siç e shprehnin edhe vetë pellazgo-ilirët, duke e quajtur veten HYJNORË. Format dhe ngjyrat e mbulesës së kokës, që i shikojmë sot tek shërbenjësit e besimit kristian, dëshmojnë se kur u krijua Qeleshja nga para-ardhësit e shqiptarëve, nuk kishte qëllim praktik (mbrojtjen nga të ftohtit apo nën helmetë) apo si simbol të lirisë, siç lexojmë në disa enciklopedi, por LIDHJEN me ZOTIN, prandaj shqiptarët edhe në shekullin e 19 e quanin veten bij të një populli hyjnor".

Ndërsa veshja e femrave siç thotë Doda, është e shumllojshme. Gratë e Shirovicës veshin të tjera kostume, më moderne dhe më kualitative, që ndoshta për shkak të pasurisë së veçantë të këtij fshati ka ndikuar më lehtë kultura turko-kostandinopoliane, se sa në pjesët tjera të Rekës së Epërme. Gratë e Shtiravicës përdorin zakonisht këpucë me llak, me çorapë prej leshi të thurrura vetë, këmishë nga një pëlhurë e hollë, mbi këmishë mbahet një xhamadan pa mëngë. Për pjesën e poshtme të trupit, gratë në Shtiravicë veshin pantallona të gjata deri te nyjet e këmbëve dymija. Mbi brez në pjesën e përparme dhe të sprasme, vishen dy pershtelka.

Sipas studimeve etnografike të Mark Tirta, ai shkruan: "Sidomos lloji i qirkut që ishte importuar nga Turqija dhe kanë bajtur gratë kudo në trojet shqiptare. Ndërsa nga fundi i shekullit XIX e këtej, hyjn në përdorim masiv veshjet me çitijane. (Mark Tirta, Atllasi II, Tiranë, f.80)"

Edhe Andromaqo Gjergji, në vështimin e saj, ndër të tjerat shkruan: Për sa u përket veshjeve qytetare hynë në përdorim elemente turke orientale si anteria e gjatë, binishi, shallvaret të kuqe e tjera (A.Gjergji, *Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri*).

Gjellërat (gatimet). Gjendja e vështirë ekonomike apo skamja që përcjellej shekuj me radhë kishte ndikuar edhe në kuzhinën e këtij populli apo në ushqimin e tij më kualitativ dhe më i llojllojshëm. Llojet e artikujve ushqimore ishin mjaft të reduktuara.Doda, listën e gatimeve të rëndomta të Rekës së Epërme e përfshinë në një meny kartë të pasur, kryesisht hasen qumësht, djath, ushqim bimor, mish, llojet e gatimit prej miellit si *ndrie* (pete), *ndrudhia* e tjerë.

V. QEVERISJA

Marrëdhëniet me ish qeverinë Turke, funksioni i plakut të katundit, tatimi, shërbimi i detyrueshëm ushtarak, gjyqësia, kaçakët, ekspedicionet ushtarake për të vënë autoritetin qeveritarë, hajdutët, vjedhjet e pasurisë shtëpiake, vjedhja e bagëtisë me të madhe, vjedhja e bagëtisë me pakicë, zënia e pritave, bandat e grabitqarëve dhe epoka e Mustafa Litës, të gjitha këto Doda na i përshkruan hollësishtë.

VI. PËRRALLAT

Për lashtësinë e përrallës ekzistojnë mendime të ndryshme, por dominon kryesisht mendimi se është njëra ndër format më të lashta të krijimtarisë letrare, gojore dhe supozohet se mund të ketë lindur qysh në kohën e gurit.

Duke qenë se përralla është zhanër letrar me shtresa të pasura kuptimore dhe artistike në kapitullin e gjashtë janë shënuar përralla (gaçka) dhe legjenda siç janë: "Plaka dhe pula e saj", "Gaçka e qerosit", "Dhuratat e mbretit të gjarpërinjve", Fëmijët me dhembë të argjendtë dhe flokë ngjyrë ari", "Tre vëllezërit dhe gratë e tyre jo të ndershme", "Rruga e drejt dhe ajo e shtrembëta", "prejardhja e bacës", "Burri dhe ujku", "Cubi dhe nipi i tij", "Kur dikush s'ka fat", "I shenjti dhe shërbetori i tij", të cilat lënë gjurmë dhe e pasurojnë krijimtarinë letrare gojore.

VII. GJUHA

Është kapitulli shtatë– ana gjuhësore, e cila është mjaft e pasur. Lista e emrave të Rekës, veçoritë e zanoreve të të folurit (autori e thekson, si dialekt, por në fakt është një të folur me karakteristika krahinore të një pjese të dialektit gegë) e Rekës së Epërme, mundësitë verifikuese që kanë të bëjnë me marrëdhëniet etnologjike gjuhësore. Kemi të bëjmë me një thesar bukur të pasur fjalësh të gjuhës shqipe. Përpjekjen e parë për grumbullimin e materialeve dialektore nga të folmet shqipe të Maqedonisë e bëri Nober Jokli më 1915.Edhe në këtë vepër bashkëpunuan Dr.Nobert Jokli & Dr. Baron Nopça, ata përpiluan listën e fjalëve rreth 810 emra ku është sqaruar çdo detal i fjalës, njëkohësisht është bërë edhe përshkrimi fonetik, përcaktimi i prejardhjes së tyre etimologjike etj.

Por në veçanti janë studiuar edhe karakteristikat kryesore të zanoreve në të folurit e Rekës së Epërme.

***

Vepra përmbyllet me disa fjalë mbi situatën aktuale të Rekës së Epërme.Shqipëruesi Nexhat Mehmedi, pasqyron të djeshmen dhe të sotmen e shqiptarëve të Rekës së Epërme.

Qëllimi i këtij përshkrimi është që lexuesit, të cilët Rekën e Epërme e njohin vetëm nga artikuj gazetareskë dhe doreshkrimet e fundit prej autorëve të ndryshëm, të kenë një pasqyrë sadopak reale për atë se çka ka ngelur nga Reka e Epërme. Përshkrimi ndahet në katër intervale kohore edhe atë si vijon:

1. Përshkrimi i shkurtër i gjendjes ekonomike, politike dhe diskriminimi i vazhdueshëm në forma të ndryshme të këtyre fshatrave në vitet 60-të.

2. Ikja masive e meshkujve (në mes moshës 18-45) vjeçare në kurbet, Gjermani, Austri e gjetkë 1969 deri 1971.

3. Përmirësimi i standardit të familjeve (me të ardhurat e kurbetit) dhe fillimi i shkollimit të fëmijëve në Gostivar dhe Dibër (vitet '70-të).

4.Indiferenca e paskrupullt e qeverisë komuniste (në vitet '80-të), kundrejt kësaj popullate, trazoi rrugën definitive të shpërnguljeve totale. Periudha e shpërnguljes masive të fshatrave: Duf, Va, Bogdë, Krrekerrnicë, Verben, Kiçinic, Niçpur, Vallkavi, Beliçicë, Sencë, Verbjan, Tanushaj, Grekaj, Nivishtë, Rimnicë, Bibaj, Nistrovë dhe Zhuzhnjë. Fshatra këto që den-baba-den kanë qenë territori i Rekës së Epërme.

Botimi dhe përkthimi i kësaj vepre është me shumë vlerë për të nxjerrë në dritë jo pak të panjohura. Siç u tha që në fillim të reçensionit se është një kontribut i ndjejshëm në etnokulturën shqiptare.

botim

Libri "Ankthi" i Dr. Sadik Lalës jo vetëm që plotëson një boshllëk në studimet tona për këtë fushë specifike, por është edhe një trajtim me seriozitet dhe me thellësi i njërës prej dukurive më interesante dhe më problematike të shëndetit mendor...

"Ankthi", libër me shumë vlera

Nga **Xhafer MARTINI**

Kohët e fundit, Dr. Sadik H. Lala, me cilësinë e specialistit psikiatër, botoi librin "ANKTH", një realizim me shumë vlerë i këtij autori që ka pasuruar më tej literaturën ekzistuese për shëndetin mendor. Ky libër u shtohet botimeve të mëparshme të Dr. Sadik Lalës, si "Fjalori i psikologjisë" (2010), "Psikopatologji" (2013), si dhe librave me bashkautor: "Psikiatri" (2006), "Psikiatria ligjore" (2011). Libri "Ankthi" i Dr. Sadik Lalës jo vetëm që plotëson një boshllëk në studimet tona për këtë fushë specifike, por është edhe një trajtim me seriozitet dhe me thellësi i njërës prej dukurive më interesante dhe më problematike të shëndetit mendor, siç është ankthi, që në këtë libër paraqitet me tërë larminë e shfaqjeve, pasojave, mënyrave të trajtimit etj. Niveli shkencor bashkëkohor, struktura e lëndës, gjuha dhe stili që ka përdorur autori, e bëjnë veprën e tij shumë të përdorshme dhe një armë me afekt të plotë në duart e mjekëve specialistë të psikiatrisë, të psikopatologjisë klinike, për mjekët e familjes, për studentët e mjekësisë dhe për të gjithë ata njerëz që duan të dinë më shumë për shëndetin mendor. Për të analizuar siç duhet librin "Ankthi" të Dr. Sadik Lalës duhet të jesh specialist, por edhe pa qenë i tillë, siç jam unë, nuk mund të mos vëresh mprehtësinë e autorit për të trajtuar një temë me interes të madh shoqëror, siç është ankthi. Meritë e madhe e Dr.Sadik Lalës qëndron në faktin që ka gjetur mënyrën dhe formën më të përshtashme për ta përcjellë këtë vepër tek lexuesi. Vërtetohet edhe një herë ajo që është thënë shumë herë: veprat shkencore mbeten me një përdorim shumë të kufizuar nëse autorët e tyre nuk arrijnë që të dhënat e shkencave, përvojën vetjake, intuitën dhe sensibilitetin shkencor t'i paraqesën me arkitekturën e përshtashme. Çdo libër, i çfarëdo gjinie të jetë ai, i kulturës apo i shkencës, pa një kompozicion të përshtashëm, pa një gjuhë të pasur dhe të thjeshtë, pa një stil të qartë që të ketë parësor komunikimin, nuk ka vlerë se mbetet si një ndërtesë pa derë dhe dritare që nuk din nga të futesh brenda dhe, po ia arrite kësaj, endesh në errësirë, pa mundur të shikosh asgjë. Një mendimtar ka thënë se për të qenë arkitekt i mirë duhet ta lësh dritën brenda ndërtesës. Në analogji me këtë mendim, unë dua të them se për të qenë një autor i vlerësuar, duhet që lexuesit t'ia bësh sa më të lehtë rrugën për të hyrë tek dituria. Autori i këtij libri ka aftësinë që ta plazmojë materialin shkencor, t'i japë atë formë, ta paraqesë me ato mjete stilistike dhe gjuhësore që ai të bëhet pronë e lexuesit, t'i shërbejë atij. Libri "Ankthi" dëshmon edhe një herë që edhe problemi më shkencor, i një natyre shumë të veçantë, mund të paraqitet me një gjuhë të gjallë, emocionuese, me pasuri fjalori; ka vdekur përgjithmonë ai koncept që "shkenca, sidomos ajo e fushave specifike", është e vështirë për t'u kuptuar dhe se stili shkencor është i rëndë, ngarkuar me terma dhe me një gjuhë të drunuar, me ndërtime jo të natyrës së gjuhës shqipe që të çojnë nëpër labirinthe ku të merret fryma. Dr.Sadik Lala çlirimin nga ankthi ta siguron qysh me librin e shkruar lirshëm, me dashuri, me mprehtësi, me saktësi, me hapësirë dhe dritë, me pasuri gjuhësore që të lë mbresa.

Ankthi, sipas specialistëve të kësaj fushe, është një dukuri e zakonshme, si shumë e shumë të tjera, por që shfaqet me një larmi dhe thellësi emocionesh,me vënien e organizmit të njeriut në ato forma vepruese që janë të mundimshme; shkurt, është "një gjendje psikike e ndërgjegjshme, e shfaqur kur një individ ka një ndjenjë preokupimi, ose frikë intensive të zgjatur, e lidhur me një stimul specifik të qartë (i brendshëm, ose i jashtëm), ose zhvillohet nga mungesa e përgjigjes përshtatëse të organizimit ndaj një burimi subjektiv stresi". Përkufizimin e mësipërm e vura në thonjëza se është i hartuesit të parathënies, Prof. dr. Lutfi Alia, por autori gjen mënyra dhe forma të tjera – më shkurt, më saktë, më qartë - për ta thënë çfarë është ankthi, për ta dalluar atë nga frika. Dhe për këtë u drejtohet kollozëve të botës që janë marrë me këto probleme, thëniet e të cilëve në këtë libër sillen shumë natyrshëm, në vendin e duhur, në kohën e duhur dhe me cilësinë e duhur, dhe



Libri në mënyrë shumë elegante dëshmon ose sjell mesazhin se në këtë botë tonën, humanizmi i mjekut ka po aq rëndësi sa edhe ndihma që duhet të japin vetë pacientët, jo si të tillë (kur bëhen pacientë), por si njerëz të ndërgjegjshëm për rolin që kanë në cilësinë e jetës dhe në gjatësinë e saj.

bëhen kështu pjesë organike e librit. Autori jep përkufizimin e DSM 5 (Manuali Diagnostiko-Statistik i çrregullimeve Mendore): "Frika është përgjigjie emocionale ndaj një kërcënimi real apo të përceptuar, ndërsa ankthi është ndjesia e një parashikimi ndaj një kërcënimi të pritshëm në të ardhmen". Kjo është referenca e parë e autorit në këtë librër. Pastaj vijojnë 136 të tilla, të gjitha nga personalitet të rëndësishme të shkencës botërore ose nga botime e forume që janë marrë dhe merren me shëndetin mendor, duke e orientuar shkencën me të dhëna dhe konkluzione të reja dhe interesante. Kjo dëshmon se libri është shumë shkencor, shumë i argumentuar.Por literatura në një vepër shkencore është njera anë, përdorimi i saj me vend dhe efikasitet është ana tjetër shumë e rëndësishme. Libri nuk është literatura që ke përdorur ti si autor. Literatura kudo është e pranishme, por e "padukshme". E vë në thonjëza këtë fjalë sepse literatura nuk duhet përdorur në fromë citimesh pa fund, ku në një faqe teksti gjysma e saj të jetë me citime dhe gjysma me fjalën e autorit. Kjo mënyrë paraqitjeje i heq veprës jo vetëm origjinalitetin, por edhe unitetin, që vjen nga mosrespektimi i raportit të fjalës së autorit me referencat që ai përdor. Dr. Sadik Lala u referohet autorëve në mënyrë shumë elegante.

Kapitulli i parë merret me "Përshkrimin e përgjithshëm", ku jepen njohuri për ankthin në tërësi. Ankthi dhe frika paraqiten si dy gjendje që jo vetëm janë të lidhura ngushtë me njera-tjetrën, por edhe me karaktersitika të njejta fiziologjike. Ankthi e përgatit trupin që të kundërpërgjigjet ndaj një veprimi të mundëshëm të rrezikshëm. Kemi dy lloj ankthesh: ankthin e zakonshëm ose normal dhe ankthin patologjik që është më i dëmshëm për individin sepse dëmton funksionet e tij. Simptomat e ankthit janë si të shumë sëmundjeve të tjera, që shfaqen me çrregullime që kanë intensitet dhe ndryshueshmëri nga një individ në një tjetër. Ankthi i zakonshëm ose ankthi normal "mund të konceptohet si një reagim normal përshtatjeje, i cili ka cilësinë e ruajtjes së jetës dhe është një paralajmërues ndaj kërcënimeve të dëmtimit trupor, dhimbjes, pafuqisë..." Kurse ankthi patologjik, ndryshe nga ankthi kalimtar, karakterizohet nga "një nivel i lartë simptomash e ankesash, të cilat vazhdojnë të jenë të qëndrueshme në kohë, dhe shoqërohen me strategji specifike të sjelljes, si p.sh.,me shmangie nga këto situata". Në këtë kapitull jepen njohuri të sakta dhe në mënyrë shumë të thjeshtë dhe të qartë për simptomat e ankthit, çrregullimet e tij, klasifikimin e çrregullimeve dhe kriteret diagnostike.

"Ankthi dhe stili i jetës", është një kapitull interesant shkruar me gjuhën e një shkrimtari erudit për një problem shumë të rëndësishëm që ka të bëjë me cilësinë e të jetuarit. Ky problem, për mendimin tim, për herë të parë bëhet i qartë dhe paraqitet me të gjithë peshën që meriton. Duke i mëshuar idesë se çrregullimet e ankthit janë të parandalueshme dhe të trajtueshme, autori nënvizon domosdoshmërinë për të pasur një stil jetese të shëndetshëm si bazë për të gjitha llojet e shëndeteve, duke përfshirë këtu shëndetin mendor. Vënia e trupit në lëvizje, lufta kundër jetës sedentare, veprimtaria e vazhdueshme e njeriut, të qenurit aktiv edhe si trup edhe si mendje, shërbejnë si faktorë për të mposhtur çdo lloj depresioni dhe për të fituar atë cilësi të jetës për të cilën ka nevojë njeriu. Regjimi ushqimor, thotë autori, ka rëndësi të veçantë, duke i dhënë jetë aksiomës së njohur që mishërohet në pyetjen: "A dimë të hamë, a dimë të ushqehemi?", që nuk janë e njejta gjë dhe ku njerëzit paraqiten më profanë se para gjithçkaje tjetër. Ne duhet të hamë ato ushqime për të cilat organizmi ynë ka nevojë, thekson autori, dhe për këtë shtrohet problemi që organizmi "duhet njohur", duke filluar nga grupi i gjakut dhe nga mënyra se si na funksionojnë të gjitha organet me veprimtari të rëndësishme jetësore. "Dietologët rekomandojnë lloje të ndryshme ushqimi për individët sipas grupeve të ndryshme të gjakut. P.sh. personat me grup të gjakut "0" kanë përmbajtje të lartë aciditeti në stomak dhe e tresin lehtë mishin. Gjithashtu tek ky grup vihet re një tendencë për nivele të ulta të hormoneve Tiroides dhe funksionin e paqëndrushëm të gjëndrës Tiroide, të cilat shkaktojnë probleme metabolike dhe favorizojnë shtimin në peshë". Po kështu vazhdohet me të gjitha grupet e gjakut që shumë njerëz nuk e dinë as cilit grup i përkasin. Ky libër i shkruar kaq bukur dhe me humanizëm të madh, na dëshmon se sa pak "humanë" jemi ndaj vetes sonë, sa injorantë paraqitemi, ndonëse vishemi me shije dhe kemi kapardisje të tjera në jetën e përditshme. Autori rekomandon "një ekzaminim fizik mjekësor, për të përcaktuar nëse ankthi juaj është i lidhur me ndonjë sëmundje fizike dhe përjashtimi i mundëshëm i abuzimit me substanca dhe depresionit të cilat shpesh herë bashkekzistojnë mes tyre". Ne shqiptarët, që jemi një popull kaq "politik", që na intereson çdo gjë e tjetrit, deri tek hollësitë më të vogla, që hymë në jetën e tjetrit kaq thellë dhe kaq pa vend dhe paturpësisht, nuk hyjmë aspak "në jetën tonë, në shëndetin tonë" dhe nuk dimë aspak se çfarë ndodh në organizmin tonë derisa "pëlcet boba", dhe sëmundja bëhet e atillë sa nuk ka kush të matet me të. Vetëm këtë mision të kryej ky libër, ka kryer shumë.

Py ky libër të mëson plot gjëra të tjera; ai të jep njohuri shumë të thella për "Metodologjinë e trajtimit të parimeve të përgjithshme, të çrregullimeve që sjell ankthi, duke rekomanduar konceptin e trajtimit psikoterapik, trajtimin me barna, dhe mjekimin e kombinuar, si tre opsione bazë për trajtimin e sëmundjes. "Qëllimi i çdo trajtimi, - thotë autori, - është të ulë intensitetin dhe shpeshtësinë e simptomave të ankthit, duke rritur kështu aftësinë për të funksionuar sa më normalisht" dhe si vazhdim i kësaj pune "Shkatërrimi i këtyre skemave të gabuara të gjykimit, është elementi bazë i punës së këshilluesit dhe psikologut klinik". Probleme të tilla si "Marrja e anamnezës", "Trajtimi i historisë së çrregullimit aktual", "Historia psikiatrike e të së shkuarës", "Historia e sëmundjeve të kaluara", "Historia e përdorimit të barnave mjekësore", "Historia familjare dhe sociale" janë pjesë përbërëse të këtij kapitulli dhe që kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për trajtimin e ankthit por të çdo sëmundjeje tjetër që gjendet e fshehur "në rrugën e ekzaminimeve të gjithanshme". Ky është një kapitull shumë shkencor që merret me trajtimin jo të sëmundjeve të veçanta, por të arganizmit të njeriut si tërësi, ku sëmundje të veçanta vetëm në saj të trajtimit sistematik gjejnë shërimin e mundshëm. Gjithë mesazhi i këtij kapitullit dhe i librit në tërësi është që të mos e lëmë jetën e njeriut në dorë të urgjencave dhe të analizave të kryera në kushte alarmi, por t'ia nënshtrojmë atë një studimi analitik, sistematik, të përhershëm, duke krijuar edhe kushtet për një gjë të tillë.

Libri i Dr. Sadik Lalës është me një aparat të tërë shkencor ndihmës për zbërthimin e tij dhe për konfirmimin shkencor të gjithçkaje që është pohuar. Ky aparat zë 30 faqet e fundit të librit dhe fillon me "Listën e fobive", vijon me "Kodimi i diagnozave të ankthit sipas ICD-10-CM, duke trajtuar këtu çrregullimin e ankthit sipas fobive, llojet e fobive, fobi nga situata të ndryshme, çrregullimi ankthit social etj. Referencat zënë shumë faqe të këtij libri dhe ato tregojnë më së miri peshën e tij. Autori u drejtohet autorëve të shquar të botës mbarë, me libra të plotë dhe me artikuj shkencorë, ku problemi i ankthit trajtohet në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme. Rreth njëqind e pesëdhjetë referime janë një bibliotekë e tërë me ajkën e shkencës botërore. Kjo dëshmon për punën kolosale të autorit. Libri "Ankthi" vjen kështu në shqip përmes Dr.Lalës si një punë e jashtëzakonshme e gjithë përvojës botërore në përmirësimin e shëndetit mendor, i cili, për shkak të kushteve të njeriut shqiptar, ka ardhur duke u keqësuar vazhdimisht. Libri i Dr.Lalës nuk është vetëm një vepër mjekësore shkencore, por edhe një Mision, një Apel që të bëhet shumë më tepër për cilësinë e jetës së njeriut, për shëndetin e tij mendor. Në fund, disa faqe zë indeksi i librit që e bën atë më të lehtë në përdorim.

Libri i Dr. Lalës në tërësi është një punë e mirëfilltë shkencore, por edhe me vlera të mëdha humane, që kërkon, synon dhe rekomandon që njeriu të ngrihet në atë lartësi që jo vetëm të mposhtë ankthin dhe stresin, por edhe shumë sëmundje të tjera nëse ai bëhet palë me mjekësinë, nëse ata luftojnë bashkë. Libri në mënyrë shumë elegante dëshmon ose sjell mesazhin se në këtë botë tonën, humanizmi i mjekut ka po aq rëndësi sa edhe ndihma që duhet të japin vetë pacientët, jo si të tillë (kur bëhen pacientë), por si njerëz të ndërgjegjshëm për rolin që kanë në cilësinë e jetës dhe në gjatësinë e saj.

"*Pas shiut*" dhe "*Zjarri është Blu*", dy botime të reja nga Fatmir Terziu

libra të rinj

Terziu vazhdon të botohet **në** gjuhën angleze dhe **disa gjuhë** të tjera





Fatmir Terziu është vlerësuar si më produktivi, më cilësori i kohëve të fundit, si e ka cilësuar shkrimtari Novruz Abilekaj si "bleta shqiptare e letrave" apo si e kanë vlerësuar Prof.Dr. Zyhdi Dervishi dhe Prof.Dr. Eshref Ymeri si kritikun më të mirë të letrave shqipe, kritikun e "rrjeshtit të parë".

Nga **Luan DEDA**

Pas botimit të librave studimorë **"***Disimetria, Universaliteti, Oksimoroni, (Anti)misigonia***"** (2016), dhe atij në gjuhën angleze **"***Writing the dictatorship: reuse of myth in Ismail Kadare's work***"** (2016) shkrimtari, studiuesi dhe kritiku shqiptar, Fatmir Terziu, vjen dhe me dy libra të tjerë në fushën e poezisë dhe të tregimit të shkurtër, duke shtuar kështu në tridhjetë numrin e botimeve të tij. Vëllimi poetik **"***Pas shiut***"** dhe vëllimi me tregime **"***Zjarri është Blu***"** janë në vetvete metafora që pasohen nga jetëditësia dhe bagazhi intelektual që mirëfill dimensionin e një krijimtarie që konkuron në mjedisin e gjerë dhe atë ku sot krijimtaria shqiptare prej kohësh kërkon shtratin e saj të munguar.

Poezia e vëllimit poetik **"***Pas shiut***"** ende pa nisur mirë udhëtimin e saj tek lexuesi ka marë nota të larta vlerësimi nga poetë e profesionalistë të kësaj fushe. Vangjush Ziko, poet dhe Profesor i letrësisë shqiptare shprehet se "Poezia e Fatmir Terziut, e thellë dhe e mençur në gjykimet e saj". Rruga e poezisë është e gjatë, është traga nëpër të cilën ec poeti, fillon nga një shteg, apo më mirë, shtigjet mbeten pas të mbuluara me bar dhe vjen një çast kur ato bëhen rrugë dhe kur poezia shikon horizontin që e ndjell për të vazhduar më tej.

Sipas Zikos, "Poezitë e këtyre viteve të fundit e kanë nxjerrë poetin në rrugën e tij për ku kanë synuar ato shtigje. Fatmir Terziu po ec në këtë rrugë, që është rruga e tij dhe e poezisë së meditimit të veshur metaforikisht, të shtruar, rrëfimtar dhe përgjithësues, ku kujtimi ngarkohet me mallin e së shkuarës dhe dritën e së tashmes, me përgjegjesine e artikulimit të të vërtetave të jetës personale dhe asaj shoqërore, si një përvojë dhe dedikim. Ritmi i poezisë mban ritmin e pulsit të një krijuesi të angazhuar për vete dhe për të tjerët, bashkëkohësit, detaji jetësor, ndodhia mbresëlënëse, tharmi i gjykimit dhe vizioni bashkëkohor i të parit të jetës i japin ngjyrimin emocional; gjuha kërkon fjalën nga fjalori i përditshmërisë, më kryesorja, e ngarkuar me emocionin e vet, me ngjyrë, jo e zbehtë."

Poezia bëhet kështu, sintezë e kohës, e mallit, e dashurisë birësore, ka erën dirsës dhe aromën e punës së lodhshme dhe fisnike, të bujarisë dhe të mikpritjes; tema mund të jetë nga e kaluara apo nga e tashmja, kohët e mbresave shkrihen me kohën e krijimit, më të veçantën e ligjërimit poetik, ku përqasja kohore kërkon jo vetëm epitetin apo metaforën e gjetur bukur, por edhe antitezën, sepse kohët mund të ngjasin emocionalisht, por të kontrastojnë midis tyre, gjithshtu, ashtu si edhe kujtimi dhe harresa, dashuria dhe xhelozia, errësira dhe drita të gjitha të lashta sa vetë njeriu, sa vetë jeta. Ziko shton se "Në këtë cikël Fatmir Terziu vjen me gjithë bagazhin e tij disavjeçar krijues poetik; ai ka dalë në atë rrugë të ëndërruar nga muza e tij, në rrugën e poezisë meditative, lirike dhe epike, njëkohësisht, mediteuse dhe përshkruese, emocionuese dhe mbresëlënëse, e thellë dhe e mençur në gjykimet e saj. Një rrugëtim poetik i suksesshëm."

Vëllimi me tregime **"***Zjarri është Blu***"** vjen në një kohë që tregimi shqiptar duket se po ristrukturohet në një formë më adekuate dhe premtuese për nota të larta vlerash. Shkrimtari Faruk Myrtaj shprehet se "Proza e Terziut, as që e ka dëshirën të ngjajë me prozat e tjera të kohës shqiptare". Sipas tij duket qartë, si autor, sjell sa më shumë informacion, për çdo gjë, kërkon ta bëjë sa më të ditur e të kënduar lexuesin, gjithë sa di vetë dëshiron t'ja ofroj atij... Jetët dhe emrat e personazheve dhe njerëzve që kanë pasur kontakt, hyjnë në të shkruarat pa teklif, në një dukje të paorganizuar, siç është jeta: fatet mpleksen me njëri tjetrin aksidentalisht, si karierat, si krimet, si dashuritë...". Më tej për prozën e Fatmir Terziut, Myrtaj shton se është "Prozë që intrigon".

Ai shprehet "Po më intrigon jo pak kjo prozë. Më pëlqen të shkruarit. Ka siguri. Kontroll i përpiktë fjale. Veti prozatorësh të pjekur. Përgjegjësi fjale." Kështu që vëllimet e lartcituara që do të udhëtojnë tek lexuesi shqiptar dhe ai britanik tashmë kanë hapur dhe një sipar tjetër të botimit të këtij autori dhe në gjuhë të tjera.

TERZIU NË GJUHËN E TJETRIT

Shkrimtari, studiuesi dhe kritiku shqiptar, Fatmir Terziu, vazhdon të botohet dhe në gjuhën angleze. Këtë periudhë ai është botuar dhe përzgjedhur dhe nga revista akademike **"***The Galway Review***"** që botohet në Irlandë. Poezitë e poetit shqiptar kanë treguar një interes të madh kulturor dhe mbi të gjitha **"***Kisha e syve të mi***"** (The church of my eyes) vazhdon të mbetet një nga poezitë që shton dhe vazhdon të shtojë interesimin e mjaft kritikëve për vetë veçorinë e saj shprehëse. Poezi të tjera si **"***Jerm***"** (Delirum); **"***Reklamë për Atdheun***"** (Advert for the Fatherland) janë botuar si një kërkesë e vazhdueshme në rritje e poezisë së këtij poeti shqiptar që përditë e më shumë me veprat dhe emrin e tij krijon një urë lidhëse mes kulturave, shqiptare dhe atyre anglishtfolëse. Këto poezi të shkëputura nga **"***The Galway Review***"** ishin dhe në mjedisin letrar të nxënësve të "*Ernest Bevin College***"** në Londër, në një Kolegj ku ai ka qenë prej disa vitesh dhe Governor i procesit akademik-administrativ.

Poezi të tjera të këtij autori janë botuar në gjuhën angleze dhe në revistën amerikane **"***Ann Arbor Review***"**. Poezia **"***Takat***"** (Stilettos) ka shfaqur një interes kulturor dhe mjaft dimensional të asaj që ndërlidhet me memorjen kulturore dhe aspektualitetin e traditës dhe transmetimit kulturor tek brezat. Elementi tradicional femëror dhe aspektualiteti filozofik që vjen nga simbolika e "Takave" femërore gjen një shprehje mjaft urëlidhëse të kulturave, ku tradita shqiptare shërben si një formë ndërgjegjësimi.

Mjaft poezi të këtij poeti janë dhe në Antologjinë poetike **"***Eaggles***"** e vetme të ndërtuar ndonjëherë në mjedisin Britanik dhe që përfshin rreth dyzetë poetë shqiptarë që nga Kadare, Arapi, Shehu e deri tek më të rrinjtë e talentuar. Kjo Antologji që ndodhet dhe në "British Library" ka bërë që poezitë e autorit Terziu të kërkohen edhe në mjedise ku vazhdojnë të ndjehen interesa poetikë që ndërlidhin kulturat, dhe me mjaft interes pasqyrojnë kulturën shqiptare. Poeti Fatmir Terziu i ka prezantuar këto poezi në mjaft evenimente britanike, ku marrin pjesë poetë më me emër të ditëve tona.

Disa dhjetra e dhjetra poezi në gjuhën angleze janë seleksionuar, botuar e vlerësuar edhe nga **"***Poetry Soup***"**, **"***Poetry International***"** e mjaft të tjera. **"***Poetry International***"** është një nga revistat më të vjetra dhe më të respektuara letrare në botë që është dedikuar posaçërisht për poezinë dhe poetikën nga e gjithë bota. Gjatë viteve, kjo revistë ka publikuar punën nga autorë të tillë si nobelistët Derek Walcott, Wislawa Szymborska, Jose Saramago, Eugenio Montale, Gabriela Mistral, Tomas Transtromer, Ëole Soyinka, Seamus Heaney, Pablo Neruda, dhe të shumë të tjerë.

Kohë më parë autori ka fituar dhe një çmim nga konkursi i BBC me tematikën e prozës së shkurtër, ku tregimi i tij **"***Hija Diamond***"** (Ghost Diamond) u vlerësua dhe meritoi çmimin e parë. Ky tregim i shkurtër u vlerësua dhe i hapi rrugën mjaft të tjerëve të cilët autori me stilin e tij i ka paraqitur në disa nga vëllimet e tij, që në fillim i paraqet në Gjuhën Shqipe për lexuesit shqiptarë e më pas në gjuhë të tjera, e sidomos në Gjuhën Angleze. Me një nga këto lloj tregimesh autori u nominua për Çmimin Letrar Kombëtar shqiptar për Letërsinë në vitin 2012, pikërisht për **"***Rrëfenjat e xha Avramit***"**, vëllim i cili u përzgjodh dhe u botua nga "Filara" në Tiranë dhe për të cilin shkruan e shprehën autorë të tjerë, si Faslli Haliti.

Autori krahas poezisë, tregimit të shkurtër kohët e fundit ka në proces botimi dhe dy romane të tij të prezantuara dhe në gjuhën shqipe, mjaft të vlerësuara nga kritika. Ai gjithashtu ka në proces botimi me "Sage Publications" edhe studimin akademik **"***Diktatorshipi: Miti dhe Memorja në Letërsinë Shqiptare***"**. Ai është prezantuar në mjedisin britanik edhe me filma të metrazhit të shkurtër, si "One egg"; (Një vezë); "Pencil and computer" (Lapsi dhe kompjuteri), që janë publikuar nga BBC dhe ndodhen në arkivën e BBC, si dhe disa filma të tjerë si **"***Clouds of smoke***"**, i cili u realizua në bashkëpunim me Departamentin Britanik të Bujqësisë, Ushqimit dhe BBC-së dhe që u vlerësua me dy çmime, përshirë atë në Festivalin e Filmit të Bombeit në Indi.

Mjaft ese, punë shkencore të autorit janë botuar në mjaft revista akademike të avancuara. Kështu ai ka trajtuar në këto revista akademike dhe ka analizuar në mënyrë shkencore rolin e letërsisë dhe kulturës krijuese shqiptare mes një gjuhe të vjetër për të ndërtuar ura kulturore dhe për të forcuar besimin se letrësia shqiptare meriton vëmendjen më të madhe në botë. Fatmir Terziu është botuar dhe në gjuhë të tjera. Ai është botuar në gjuhën rumune, maqedonase dhe në disa të tjera.

Krahas punës së tij të përditshme akademike dhe shkencore, ai merret dhe me botimin e mjaft autorëve shqiptarë më në zë në revistën e tij "Fjala e Lirë" në Londër dhe në gazetën "Albanian News". Kështu sipas vlerësimeve që vijnë nga akademikë britanikë, si Prof Dr Anna Reading, Dr Jenny Oëen, Suzanne Scaffe, Richard Dacre, Robert Adams e mjaft e mjaft të tjerë, ndjejmë kënaqësinë të themi se Dr Fatmir Terziu është sot një nga figurat më të kompletuara në mesin e atyre shqiptarëve që kurrë nuk e ndajnë Atdheun e tyre të dashur Shqipërinë, dhe pse jetojnë e punojnë me familjet e tyre shembullore në mjedise të tjera.

Mjafton të bësh një kërkim të shkurtër në motorin kërkues online dhe do të ndjesh kënaqësinë që të jep veprimtaria dhe angazhimi i autorit të mirrënjohur shqiptar Fatmir Terziu. Më tutje të bësh një kërkim në arkivën e British Library, që mban arkivën më të pasur në botë, dhe natyrshëm do të gjesh dhjetra tituj librash të ndryshëm që mbajnë emrin e Fatmir Terziut. Librat, krijimtaria e Terziut dhe mjaft të tjera janë bërë objekt i librave, kërkimeve, referenvcave dhe studimeve të shumta si në Britani të Madhe dhe në Shqipëri. Në librin studimor "Global Art Cinema: Neë Theories and Histories" të edituar nga Rosalind Galt, Karl Schoonover, është edhe referincimi nga studimi shkencor i Fatmir Terziut **"***Parametric Narration in Norman Wisdom Films***"**. Ndërkohë referenca të tjera ka për studimet e Terziut në lidhje me Filmat e Paul Watson. Në mjedisn shqiptar studiuesja dhe krijuesja Mimoza Cufaj Rexhvelaj, ka marë në konsideratë në punimin e saj shkensot të Masterit poezinë e Fatmir Terziut. Ajo në mbrojtjen e saj për etnokulturë ka theksuar se po sjell diçka të re në tempullin e dijes dhe shton se "Fatmir Terziu i këndon poezisë me melodinë e shpirtit të dhimbjes, mallit që djeg gjoksin në mungesë, për shumë kohë të atdheut. Ai, qorton kohën dhe padrejtësitë e bëra nga historia, nga njerëzit që pranuan në heshtje shtypjen dhe diktaturën, ku në muret e çara valëviten ëndrrat e vrara, që bëjnë sehir si relikte të vjetra. Por ai nuk fle, ai zgjon shpresat për ditën e re, për fillim e ri. Fatmir Terziu, Ambasador i poezisë, shpalos vlerat e artit duke bërë të njohur vendin tonë të vogël por që ka dhënë shumë për letërsinë, duke shpalosur krijimtarinë dhe duke u vlerësuar me çmim. Mjeshtër i penës, puna e tij është vlerësuar nga shtypi dhe kritika e kohës, është i pëlqyer nga lexuesi, i cili gjen veten në vargjet e Fatmirit, sidomos lexuesi që jeton jashtë, duke shuar mallin dhe dhimbjen, që ka për vendlindjen". Studiuesja tjetër shqiptare Shresa Gjergji (PhD) ka botuar një studim të saj në revistën shkencore "Anglisticum" një pjesë të studimit të saj të doktoraturës kushtuar këtij autori **"***Poetry and Comparative Literature, Metaphorical Consequences in Fatmir Terziu's Poetry***"**. Mbi krijtarinë e reth krijimtarisë së Fatmir Terziut ka mjaft referenca, shkrime, studime dhe angazhime të tjera në disa gjuhë të Botës. Ky do të jetë një objekt tjetër shkrimi.

Ai është vlerësuar si më produktivi, më cilësori i kohëve të fundit, si e ka cilësuar shkrimtari Novruz Abilekaj si "bleta shqiptare e letrave" apo si e kanë vlerësuar Prof.Dr. Zyhdi Dervishi dhe Prof.Dr. Eshref Ymeri si kritikun më të mirë të letrave shqipe, kritikun e "rrjeshtit të parë". Për të shkrimtari Faruk Myrtaj shprehet "Proza e Terziut, as që e ka dëshirën të ngjajë me prozat e tjera të kohës shqiptare", apo dhe ajo që thekson poeti Agim Shehu: "Terziu është poet i kohës moderne, një Lorka i vërtetë".



Nevruzi - "Ditë e re" - si **festë** populloré **pagane**

Nga **Abdurahim ASHIKU**

Dita e Sulltan Nevruzit është një festë me përmasa botërore. E fryrë si festë fetare, si ngjarje e lidhur me lindjen e Baba Aliut dhe të degëzimit të islamizmit në bektashizëm, për këtë flitet e shkruhet shumë pak si ditë dhe festë e vjetër pagane, shumë më e thellë në histori se sa të lindte krishterimi, islamizmi, budizmi e të tjera. Nevruzi në kalendarët popullorë të popujve të ndryshëm njihet me emrat Navruz, Novruz, Nevruzi, Sullta, Sulltan Nevruz, Yeni Gun (Ditë e re), Martdokruzu (9 mars) etj. Sipas studiuesve të ndryshëm emri vjen nga persishtja: Nev (i ri, e re) dhe Ruz (ditë). Ka kuptimin e ditës së re dhe në aspektin mitologjik kremtohej si Dita e Vitit të Ri ndërpopujt që banonin në Azinë Lindore dhe Qendrore, Anadoll, Siberi, në Ballkan , Persi etj. Sipas kalendarit gregorian Dita e Nevruzit bie më 22 mars (më 9 mars sipas atij julian) në ekuinoksin pranveror kur dita dhe nata barazohen në kohë. Shqiptarët katolikë, sipas kalendarit kishtar, më 25 mars kremtojnë festën e quajtur "Lajmërimi i Zotit" por edhe "Dita e Zojës dhe "Zonja Nunciatë". Dita e 25 marsit në popull njihet edhe si "Dita e këmborëve" ose "Dita e zileve", ditë në të cilën, sipas traditës popullore, fëmijët dilnin me zile duke dëbuar gjarpërinjtë. Ky zakon, sipas Robert Elsie është pagan parakristian i cili është ruajtur edhe në disa vende dhe tek popuj të Ballkanit. Nga studimi "Pasqyrimi i pranverës dhe Nevruzit në artin iranian" veçoj: *"Kjo festë e lashtë me gjithë kalimin e shekujve, nuk e ka humbur ngjyrën dhe vlerën e saj. Në kuadrin e kësaj feste të lashtë, ekziston edhe ceremonia e 'Nevruz'hani' (kënga e pranverës), e cila aktualisht aplikohet gjerësisht në rajonet në veri dhe në jug të vargmalit Alborz, por vërehet edhe në disa fshatra të larta. Në këtë ceremoni këngëtarët, poetët dhe muzikantët krijojnë një rreth të gjerë duke kënduar krijimet më të reja artistike kushtuar stinës së bukur të pranverës. Në disa zona të Iranit pas realizimit të ceremonisë së këngës së pranverës, grupet teatrale ekzekutojnë shfaqje artistike dhe gazmore, ku të gjitha këto programe kanë në epiqendër bukuritë dhe haretë e stinës së pranverës. Në të gjitha periudhat, përgatitja e njerëzve për ardhjen e Nevruzit ka qenë e shoqëruar me gëzim dhe organizimi i ceremonive të ndryshme të shoqëruara me muzikë dhe këngë për Nevruzin, kanë qenë pjesë e traditës së kësaj feste. Në ditët e fundit të vitit, iranianët me blerjen e gjërave të ndryshme dhe me zbukurimin e vetvetes, shtëpisë, qyteteve dhe fshatrave, dalin në pritje të ardhjes së vitit të ri. Të gjitha këto janë të mishëruara me të kaluarën kulturore, kombëtare dhe fetare të këtij populli dhe vazhdojnë të përsëriten në të njëjtën formë. Për shekuj me radhë, iranianët, Nevruzin e festojnë si një festë të madhe të Krijimit dhe si simbol i gjelbërimit dhe ringjalljes së natyrës. Kjo traditë vazhdoi edhe pas periudhës islame dhe pranimit të islamit nga iranianët dhe pasi u mishërua me disa tradita islame, mori edhe kuptim fetar...."*

Në Shqipëri Dita e Nevruzit si ditë e lidhur me Baba Aliun dhe me bektashizmin, kremtohet në mbarë vendin, kryesisht në zona bektashiane. Nën emrin Dita e Sulltan Nevruzit ajo sot është festë zyrtare fetare, krahas festave të tjera fetare si Pashkët Katolike, Pashkët Ortodokse, Krishtlindjet, Bajrami i Madh dhe Bajrami i Vogël. Dita e Nevruzit si festë pagane, e lidhur me pranverën, me "bukoliket" dhe "gjeorgjiket", bujqësinë dhe blegtorinë,me pemëtarinë e vreshtarinë në veçanti festohet edhe nga banorë të krahinave të ndryshme të Shqipërisë në vlerë të kohëve të lashta mbushur me rite parakristiane. Më poshtë do të merrem me Nevruzin në një vështrimtë gjallë, në atë që e kam jetuar në fëmijëri dhe të paktën edhe sot e vite në vijim jeton në Dibër, në Topallti dhe në Male. Sot në një emision televiziv e jetova edhe nga një banor i vjetër i Martaneshit në ritin që përcolli në dialogun natën e Nevruzit, dialog që me fjalë të tjera ishte i njëjtë me dialogun që do të paraqes më poshtë... Nevruzi në Dibër festohet në varësi nga lartësia gjeografike e vendbanimeve - Nëntë ditë pas Ditës së Verës (Lugina e Drinit të Zi) dhe - Dymbëdhjetë ditë pas Ditës së Verës (në zonën malore), në të dy krahët e lartësisë mbi luginë. Në kujtimet e mia Nevruzi, nga ritet, këngët dhe doket nuk është gjë tjetër veçse një festë populloré thjesht pagane, festë e lidhur me bujqësinë e në veçanti me pemëtarinë, festë e lidhur me thirrjen për t'iu përveshur punës në sektorin jetik të trevës (trevave) që lidhej me bujqësinë. Disa rite si mbledhje e luleve, të shkuarit mbrëmjen e natës së Nevruzit në mulli, ndezja e mullarëve me kashtë e dëllinja para shtëpive, peta (byreku) i Nevruzit dhe ushqime të tjera deri tek therja e gjelit të dytë më të madh të tufës (i pari theret natën e Ditës së Verës), veshjet e lojërat popullore, veç të djemve e veç të vajzave, nuk ndryshojnë nga ato të Natës dhe Ditës së Verës. Ajo që e dallon Nevruzin janë këngët dhe thirrjet e veçanta ndonjëra prej të cilave më është ngjitur në kujtesë dhe me gjithë vitet që më rëndojnë mbi supe nuk më shqitet edhe këtu, larg e larg në mërgim. Kujtoj ndër të tjera mbrëmjet e Natës së Nevruzit, kohën kur me një sëpatë në dorë me një shuk kashte të njomur thekre bridhnim sa tek njëra pemë tek tjetra, sa tek një cung hardhie tek tjetri. Bridhnim bashkë, si familje e me mysafirë. Njeri thërriste e tjetri i përgjigjej.. I pari: Ata pres ?

I dyti: Me kalë e me thes.

I pari: A ta pres or gegë ?

I dyti: Me kalë e me shegë.

I Pari: A ta pres or toskë?

I dyti: Me kalë e me plloskë.

Ipari:A ta pres?

I dyti: Preje...

Ai që mbante sëpatën në dorë, pasi e kthente në të kundërt të pjesës prerëse i mëshonte pemës me tunin e saj duke thirr i ngazëlluar...

- E preva...

Riti vazhdonte me lagie të "plagës" së pemës me një përzierje të pekmezit me erëza e me qerasje me fruta të thata e vezë të ziera... Kështu vazhdonte pemë më pemë e hardhi më hardhi, me këngë e romuze për të përfunduar rreth e qark mullarit të Natës së Nevruzit me këngë e valle, djemsh e vajzash, burrash e grash të fisit . E veçanta e Nevruzit është se ajo shndërrohej në një festë masive njerëzish të një gjaku dhe miqsh që zbrisnin luginës së Drinit e ngjiteshin lartësive të maleve në ditët që e ndanin festën, në "Nëntë Ditë pas Ditës së Verës" (24 mars) dhe në "Dymbëdhjetë Ditë" pas saj (27 mars). Një festë e hershme, pagane, që festohej dy herë e mblidhte bashkë njerëzit e gjakut dhe të fisit shpërndarë në hapësirën dibrane. Riti që përcolla më sipër, dialogu, të bën të mendosh e të arrish në mendimin se Nevruzi, si kohë që lidhet me pranverën dhe ftesën për punë, nga tubimi i njerëzve pranë pemëve dhe hardhive, nuk është gjë tjetër veçse një rit i pemëtarisë dhe vreshtarisë, një thirrje për ti krasitur pemët dhe vreshtat që ata të prodhojnë "me kalë e me shegë", me "Kalë e me plloskë", një thirrje e gjerë me përmasa gjithë Shqipërinë, me Toskë e me Gegë. Kremtimi i Nevruzit në dy data është i lidhur edhe me kohën kur duhet të krasitet pema e vreshti, kur duhet të punohen e të përgatiten për prodhimin e ri. Në luginën e Drinit pemët lulëzojnë e limfa e tyre shpërthen më herët se në zonat e larta malore, ndaj krasitja dhe shërbimet ndaj pemëve duhen bërë më herët. Koha, largësia fizike nga Dibra e treva ku Nevruzi është një festë e thjeshtë populloré, pagane, me krye në lashtësi, ma heq mundësinë të shkruaj më gjerë e më thellë. Ua lë lexuesve radhën që ta vazhdojnë meditimin tim... Për mua, para se Nevruzi të jetë Sulltan Nevruz, festë e bektashinjve, është "Ditë e re), është një festë pagane e lidhur me pemëtarinë dhe vreshtarinë, ashtu siç është Dita e Verës e lidhur me Lulet, ashtu siç është Dita e Shëngjergjit e lidhur me blegtorinë, me...dele e me shqerra... siç këndohet në Dibër e gjetkë...

Athinë 22 mars 2016

Cikël me poezi nga Ilmi Dervishi



Porta e zemrës

MËNGJEZET ME TY

Fillova ditën në mëngjes me ty
Kështu gjithë dita deri në mbrëmje
Më vonë kur gjumi erdhi në sy
Po ty të kisha në mendje.

Ndodh, eh, ngatërrojnë ca me emër
Erë keqe - që lëviz si hije
Përsëri, po ty të kisha në zemër
Ti, betuar në fjalë Perëndie

Është thënë edhe dje e sot
Dhe heshtja flet diçka
Njeriu beson në të madhin Zot
Me dashurinë e Zotin s'ka shaka.

RRËFIM

Për gëzimet e jetës rrëfej
Me dhimbjen - qiell ngrysur
Eh moj jetë, si unë të vrej
Nëpër vite - këmish e grisur.

Flenë trishtimi brenda meje
Me gjumin e letë e me frik
Një buzëqeshje ardh prej teje
Pa i thënë, ai vet ik.

Në më doli mëkati bukur përsëri
Do ia lejoja ti ndodhte vetes,
I djegur në ferr gjithsesi
Po i jep bukuri jetës.

PORTA E ZEMRËS

Të ritrokasësh në portën tënde
Je e tanishmja, në kohë jo dikur
Se dhe larg ke mbetur në mendje
Eh të jem me ty tani, eh sikur!

Heshtja mbulon vetminë gjuhëprerë,
Te porta e zemrës tënde po trokas.
Me dashurin tënde sa e sa herë,
Në djall të vej kush keq të flasë.

Ka një thënie të vjetër dhe sot,
"S'lëvizën gurët e varrit, dashurisë e në kufi".
Betimi yt, eh, në të Madhin Zot,
Shton besimin në dashuri.

LOTI

Më doli loti, e pastaj, pse mos të qaj?
Dhimbjen e dashurin e ndjen dhe guri.
Si vjen e ikën gëzimi, haj e zezë jete haj,
Vjen një çast, që u përlotka edhe burri.

Jetë moj, jetë me dritë-hije bukur,
Me grimca si molekula atomike lumturi.
Kush rroj në këtë botë e vdiq i lumtur
Kush? Më thuaj një të paktën ta di...

E megjithatë jetojmë, e bukur jeta,
Brengat e gëzimet i kanë folenë në shpirt.
Të duash veten te ajo ndjesi si e vërteta,
Që lotin nga faqja ta fshijmë një ditë.

tregim

Rregullon shaminë, tund kokën, pastaj sikur vë buzën në gaz, por vetëm për një çast, vështrimi i syve të verbër i tretet drejt atij asgjëkundit që veç ajo e sheh...

Vazo të thyera

Nga **Artan GJYZEL HASANI**



Kam kaluar oqeanin dhe jam kthyer për pushime në atdhe. Shtëpia e vjetër. Ndoshta jo. E vjetëruar. Bie erë lagështie. Muret të zbërdhuqur. Dritaret e drunjta të brera nga krimbat dhe kripa. Duhen zëvendësuar me të reja. Mes korridorit të ngushtë disa pllaka të krisura. Mobiljet e vjetra dhe bibliotekën i kanë mbuluar pluhurat. Edhe librat sigurisht... Të vetmet rreze dielli që depërtojnë këtë shtëpi duket se bien drejt e mbi një fikus të lartë gjethemadh që gjallon brenda një vazoje, e vjetër dhe e krisur edhe ajo. Por nuk dalloj pluhur në gjethet.

Nënën e gjej si zakonisht të përmalluar dhe fjalëpakë. Gjyshja është bërë dy drehem shpirt. Nëntëdhjetë e kusur vjeç. Stërgjyshe tashmë dhe nëse im bir adoleshent në shkujdesje e sipër do bëjë seks të pakontrolluar me të vluarën e tij ukrainase ka shumë gjasa që gjyshja të bëhet katragjyshe. Nuk ia numërojmë më vitet. E verbër. Prej shumë vitesh lëngon e sëmurë në shtratin e një vdekjeje që çuditërisht vonon.

Kur isha më i ri e më i duruar i shkoja pranë dhe ajo niste e më tregonte ndonjë histori nga të sajat. Por prej kohësh i shmangem kur e shoh që kërkon të më thotë diçka me zë të ulët e fshehurazi të tjerëve...Nuk i afrohem më sepse e di që do më kërkojë ato dy fjalët për te varri i saj. Ka njëzet vjet që m'i kërkon ato dy fjalë. Jam përpjekur me mijëra herë t'ia shkruaj ato dy fjalë, por nuk mundem. Dhe kështu dy fjalët më janë bërë jo si epitafi i varrit të saj, por si të varrit tim. Edhe sot duket sikur do me thotë diçka te tille...

"Më shkruaj dy fjalë e vurmi te varri! Ke shkruar tërë këto libra e vjersha dhe asnjë rresht për gjyshen që të ka rritur...." përsëris unë fjalët e saj dëshpëruese.

"Jo... jo...lëri fjalët e varrit. Nuk t'i kërkoj më ato... Vazhdo e shkruaj për çupërlinat ti, nuk mërzitet mamaja... Do të kërkoj diçka tjetër, por m'u beto që do ta kryesh. Betohu për kokë të tët biri", më thotë prerë dhe, si gjithmonë, me gishtin tregues drejt meje. Betohem sipas traditës për gjënë më të shtrenjtë.

"Këput një degë nga fikusi dhe shko e mbille atje...te vendi...te vendi im, e di ti..." E ka fjalën për varrin e saj.

"Aman moj mama, është shumë larg fshati yt dhe përtoj tani...na çmende me gjithë atë fikus. Aq shumë e do, xhanëm? Gjithandej me vete atë vazo, dreqi ta marrë..."

Pas nja katër orësh arrij në fshatin e saj. Rrëkëllej një birrë të ftohtë, ndërsa me sy mas distancën për në majë të një kodre përtej lumit ku ndodhet vendi. Një gjysmë ore e mirë në këmbë nëpër atë malore është rruga më e shkurtër. Teqeja e braktisur, pothuajse rrëzuar. Nxjerr një lopatë nga bagazhi i makinës dhe me hamendje mbjell degën e fikusit aty ku sipas meje mund të jetë vendi i saj.

Kur kthehem në shtëpi është pothuajse errësirë. Shkoj në dhomën e gjyshes dhe i them që porosinë ia kreva.

"E bëre? E mbolle atje ku të thashë unë? Te vendi?"

"Po moj mama, e mbolla atje ku më the ti, te vendi..."

Më përqafon fort dhe nis të më puthë duart...Ndjehem i bezdisur, por nuk e jap veten. Në një çast të dytë e kuptoj që i kam bërë një nder shumë të madh. Ajo i ka dashur shumë lulet. Madje më duket se gjëja që ka dashur më shumë në jetën e saj kanë qenë lulet. Sidomos atë fikusin.

"Meqë ma kreve porosinë, ulu këtu të të tregoj diçka", më thotë.

"Këtë fikus ma ka sjellë im shoq dikur kur sapo ishim njohur. Ai student e unë një vajzë e vogël fshati. Ai i kamur. I shkolluar. Unë jetime. Vinte nga Arabia... Kairo, ku studionte flamëmadhi dhe ma kish sjellë. Ma kish sjellë për kujtim. Dhe u bë vërtet kujtim. Kujtimi i vetëm. I vetmi. Në fillim e mbolla në një vazo, por u rrit. Vazua u thye nga rrënjët. E mbolla në oborr. Pastaj u rrit dhe u bë pemë. Pemë fikusi. Vitet kaluan. Pleqtë e tim shoqi i gëzoheshin teqesë. Unë fikusit. Por edhe letrave që më dërgonte mavria nga andej. Filloi lufta dhe ai nuk erdhi më me pushime. Mbaroi dhe lufta e ai nuk u kthye më. Nuk e lanë. E quanin armik. Nuk e pashë më. As nëna jote që e kisha në bark atëherë nuk e pa kurrë. Veç tre muaj kam qëndruar me të.

Erdhi një kohë kur gjërat ndryshuan. Për të keq. Teqesë ia hoqën çatinë dhe e bënë depo drithi. Na muarën shtëpi e katandi. Na shpërndanë si zogjtë e korbit dhe muarmë skoretë...Kur po na ngarkonin në makinën ushtarake doja të merrja një degë fikusi me vete. Nuk më lanë. Fikusi mbeti aty, ndanë varreve. Ashtu i gjelbër. Na çuan larg...në veri... në qytetin e ftohtë ku më pas linde ti...

Një ditë në shtëpinë tonë erdhi një burrë nga fshati im. I biri i një fqinjës së dikurshme. Më kish sjellë një degë nga fikusi ynë. Kur kishin prishur teqenë kishin shkatërruar edhe pemët...ullinjtë...vreshtin... Po më pemët ç'patën xhanëm...? Dhe ai e kish marrë një degë nga fikusi im dhe e kish mbjellë të oborri i tij. Dhe meqë puna e kish sjellë që të vinte me shërbim në qytetin tonë kish menduar të më sillte të fala nga e ëma dhe një dege fikusi si kujtim nga shtëpia ime."

Gjyshja hesht dhe mbyll sytë për pak çaste. Më kujtohet se sa shumë i lutej Zotit kur unë isha fëmijë që një ditë të ishte e lirë e të kthehej në vendlindjen e saj.

"Dua të shkoj në fshatin tim qoftë edhe për disa orë. Më ka marrë malli. Po më shqyhet zemra. U bënë plot 30 vjet qëkur na përzunë".

"Po është shumë larg fshati yt nga këtu ku jemi, moj mama! Nuk e sheh ku jemi, në majë të hartës?Jemi shumë larg...Shumë larg!", dhe i tregoja hartën.

"Larg është, por ka dhe më larg... ka dhe më larg", pëshpëriste plaka e shkretë dhe vështrimi i zhytej drejt një asgjëkundi që veç ajo e shihte.

Pasi mbushet me frymë mirë dhe rregullon jastëkun pas kurrizit të dobët, gjyshja vazhdon:

"Nuk di a do zërë. Bën shumë ftohtë këtu te ky qytet ku jeton ti tani". Kështu më tha ai burri. Por fikusi zuri. U rrit edhe ai dhe u bë trung i trashë. Përsëri ma theu vazon. E mbolla në një vazo më të madhe. Por vazot thyheshin nga rrënjët e forta. Thyheshin. Se fikusi i ka rrënjët shumë të forta. U bë si pemë. Si ajo që kisha në fshat. Por në qytet nuk kisha oborr. Dhe zura t'ia pres degët dhe t'ua dhuroja njerëzve. Të njohur e të panjohur. E ata i mbillnin, kush nëpër vazo e kush nëpër oborre. Dimri dhe bora ua vyshkte atyre që i mbillnin në oborr, dhe kështu në pranverë vinin e kërkonin filiza të rinj dhe ua jepja....Ai qytet verior nuk kishte parë kurrë më parë një bimë të tillë. Vitet kaluan. Shumë vite përsëri. Fikusi u plak e bashkë me të u plaka edhe unë.

Një ditë prej ditësh kohët ndryshuan prapë. Kish ardhur koha që zogjtë e korbit të ktheheshin. Dhe u kthyem në jug, buzë detit në vendlindje. U ngritëm me ç'kishim e ç'nuk kishim dhe erdhëm këtu. Lulet që më zbukuronin ballkonin ua dhurova të njohurve të atij qyteti verior ku jetova shumicën e jetës sime. Mora me vete vetëm fikusin. U vendosëm në qytet. Zumë këtë shtëpi me qira. Të nesërmen shkova në fshat bashkë me tët ëmë. Ec e ec e s'kish të sosur... Teqeja dhe shtëpia ishin braktisur, pothuajse rrëzuar...Eh...ç'të them aman...jetë plot vuajtje. Dhe plot kujtime. Varrit do ia tregoj.... Ja edhe pak...Po shkoj njëqind vjeçe tani. Mavria im vdiq atje larg, por as varri nuk i dihet. I dihet...afër piramidave e ka se aty afër banonte, por ne nuk do ia dimë se ku e ka... Sikur një brinjë të tij të kisha tani këtu... Një kockë të tij...ta mbaja ja këtu, në gjoks. Dhe ti më thua është larg. Eh, evlati im, ka dhe më larg...ka dhe më larg..."

Hesht. E ka mbaruar rrëfimin.

Kam mbetur pa fjalë. Duket e lehtësuar. Mund të vdesë e qetë kur të dojë paskëtaj.

Fikusi e pret atje. Te vendi.

Rregullon shaminë, tund kokën, pastaj sikur vë buzën në gaz, por vetëm për një çast, vështrimi i syve të verbër i tretet drejt atij asgjëkundit që veç ajo e sheh, dy lot i rrokullisen faqeve të fishkura, ndërsa mua, si gjithnjë në raste të tilla, më vjen ndërmend që kur isha i vogël kujtoja se të verbërit nuk mund të qajnë...

(2010) © Autori

Keni ndonje shqetesim per te ndare me komunitetin?
SHKRUANI NË GAZETË! BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

homazh

Drita Zhulali *përcillte përmes mësimit* **shpresë dhe besim**

Nga **Emrie SKUKA***

Që në nisje, shkrimi për mësuese Dritën nuk doja të ishte në llojin e një nekrologjie. As në llojin e një lamtumire, sepse emri i mësuesve si ajo, janë të pranishme në udhëtimin e gjatë shpirtëror të shumë e shumë brezave.

Me disa mësues dhe ish-nxënës të shkollës 9-vjeçare "Demir Gashi", në prag të 100-vjetorit të shkollës së parë shqipe, e kishim vendosur se do të shkonim në shtëpinë e saj për ta uruar, sepse ishte mësuesja më në moshë. Por, si gjithmonë, kujtojmë se disa njerëz do të jetojnë aq sa duam ne dhe harrojmë se jeta gjithmonë është rrezik.

7 Marsi tashmë ka hyrë në mes nesh si festë popullore dhe është kjo arsyeja që na sjell më pranë emrave që janë lidhur pazgjidhshmërisht me këtë festë, sidomos të atyre që largohen nga kjo botë rishtas. Atëherë kujtohesh se të mungon kryefjala e urimit që ke bërë ndër vite, qoftë ky mësuesi i klasës së parë apo i afërmi yt që të mungon.

Fjala është dhe ka magji. Por magjia e botës së një mësueseje sillet e ngjizet përzier me atë të nënës. Kjo sepse, fëmija që ti e kap përdore dhe e ul në bangë për herë të parë, të vështron dhe të lutet pa zë: "Mos ma lësho dorën!" Është kjo një ndjenjë e treguar nga shumë ish nxënës të mësuese Dritës.

Dashuria që mësuesi fal për nxënësit e tij, as nuk mund të matet, as nuk kursehet. Ndaj breza të shumtë vizatuan në mendje e shpirt jo vetëm pamjen e mësueses së tyre, por edhe shpirtin e saj.

Në kujtimet që i shkroi me dorën e saj për 100-vjetorin e shkollës, tregon se e nisi punën kur ishte me moshë e re dhe nënë e re, sëbashku me bashkëshortin Shemsi Zhulali. Për përgjegjësitë që kishte në familje, fëmijët e vegjël, prindërit e bashkëshortit në moshë, vendosja dhe ushtrimi i mësuesisë në Veri të vendit, në Gurrë të Madhe në Klos, ishte disa herë më e vështirë. Lëvizjet e shumta nëpër fshatra të Dibrës si në Ostren të Madh, në Gollobordë, Gjoricë, Maqellarë, Allejbegi, Sohodoll do t'i përballonte me rininë e saj, me dashurinë për të ndihmuar në arsimimin e vendit, si edhe me ndihmën e bashkëshortit. Përpjekja për të zhdukur analfabetizmin ishte më shumë se detyrë e përgjegjësi e mësuesve të atyre viteve. Në fshatrat ku kanë qenë, akoma e kujtojnë për atë sjellje njerëzore e dashuri që u falte, jo vetëm nxënësve, por edhe banorëve të fshatrave në të cilat jetoi e punoi.

Nga viti 1951-52 ajo jetoi me familjen në qytetin e Peshkopisë dhe ishte mësuese në shkollën "Demir Gashi" deri sa doli në pension.Shkollat ku punoi ishin dhe strehë banimi për familjen. Ky perjetim nga një vajzë e rritur në një qytet si Gjirokastra me shumë përgjegjësi të shtuar në familje, të mendosh dhe gjendjen e fshatrave në ato vite, ishte dhjetëfish më i vështirë. Në përpjekje për të përballuar vështirësitë, Drita e Shemsi Zhulali mësuan se koha është si malet, vetëm përballje ke me to. Kjo ishte e zakonshme për shumë vite. Mësuesit strehoheshin në shkollë edhe me fëmijë të vegjël apo të porsalindur. Shpesh ndahej salloni i shkollës në fund të korridorit me çfarë të mundej. Të mendosh që nuk kishte as ujë e as banja në shkollë. Këto ishin mësuesit e atyre viteve, madje kjo situatë ka zgjatur në disa zona të thella gjer në vitet '90. Për brezat e ditëve tona as që mendohet.



Mësuese Drita mori vlerësimin se ishte mbartëse e çmuar e mesazhit se "Përpjekja për t'u shkolluar, është përpjekje për të jetuar dhe për të qenë i lirë".

Drita Zhulali ishte përvoja e mirë e kësaj shkolle dhe e këtij qyteti. Ishte pjesë e asaj tradite intelektuale, të cilën e përfaqësoi në punë dhe në familje, sepse donte të dëshmonte se ishte pjesë e shoqërisë së civilizuar që kishte nevojë për shpresë e për motiv.

Në kujtimet për shkollën "Demir Gashi" mësuese Drita ruan kujtime të një pune të lodhshme, por që i ka dhënë shumë kënaqësi. Kujton jo vetëm për veten, por për të gjithë kolektivin. Kujton me mall e respekt të gjithë punën e përkushtimin e drejtuesve Islam Vani, Riza Manjani, Hilmi Sadiku, Ismail Erebara, Adem Shehu, Nevrez Manjani, Shemsi Manjani etj. Kujton të gjitha shoqet që kishin ardhur nga rrethet e tjera dhe punuan me shumë përkushtim. Emrat e Ervehesë, Margaritës, Diamandës, Shahe, Maria, Ismete, Ermioni, i kujton për metodat e reja të mësimdhënies dhe ndihmën ndaj të rinjve. Kujton mësueset e reja që shkelën në atë shkollë dhe i dhanë mësimdhënies gjithë përkushtimin e tyre për dije e kulturë si: Dilbere Hoxha, Naferide Shehu, Natasha Ashiku, Zinete Hoxha, Fatmira Shahini etj.

Kur tregon për përmirësimin e kushteve të punës, rregullimin e shkollës, kujtimin me shumë mall të shokëve e shoqeve të punës, kuptojmë se mësuese Drita donte të thoshte se parajsa është tek vetja jote, kur din të vlerësosh të tjerët. Për këtë përmend mësuesit që lanë gjurm në historinë e kësaj shkolle dhe më gjerë si Hava Hoxha, Kumrie Shehu, Sanije Zeneli etj. Aty janë edhe nxënësit shumë të mirë, por edhe ata që "e kanë lodhur pak".

Drita Zhulali ishte përvoja e mirë e kësaj shkolle dhe e këtij qyteti. Ishte pjesë e asaj tradite intelektuale, të cilën e përfaqësoi në punë dhe në familje, sepse donte të dëshmonte se ishte pjesë e shoqërisë së civilizuar që kishte nevojë për shpresë e për motiv.

Rruga drejt dijes që të gjithë mësuesit e këtij brezi i ftonin nxënësit, ishin amanete sociale. Ndaj arsimimi i të gjithë fëmijëve të saj, me të gjitha vështirësitë e kohës që jetuan, ushqyen moralin se shkollimi ishte shenjë hyjnore nga të cilat duhet të orientohen brezat, pse jo edhe epokat.

E ulur në vitet e thella të moshës, kujtoi me shumë respekt e mall Peshkopinë, të gjithë njerëzit që e rrethuan, kujtoi bujarinë me të cilën e rrethuan Dibranët. Edhe ky qytet, Bashkia e Peshkopisë, e nderoi në maj të vitit 2015 me titullin "Nderi i qytetit", përpos vlerësimeve të tjera që ajo mbante si "Mësuese e dalluar", "Urdhëri i punës", urdhëri "Naim Frashëri".

Në nderimin qytetar dibran, mësuese Drita mori vlerësimin se ishte mbartëse e çmuar e mesazhit se "Përpjekja për t'u shkolluar, është përpjekje për të jetuar dhe për të qenë i lirë".

Familja, të afërmit, të njohurit, ish nxënës e ish kolegë, nuk e uruan sivjet sipas një tradite gati 70-vjecare. Është e vështirë të mësohesh me klimën e heshtjes e të vdekjes. Por të qenit mësues i shumë brezave, do tua lehtësojë këtë dhembje familjarëve dhe të njohurve, sepse shumë shpesh do t'ia dëgjojnë emrin në biseda, kujtime, libra, përvjetore.

Është muaji mars. Sapo ka kaluar 7 Marsi... Dua të të kujtoj dhe ta uroj: U kujtofsh me të mira mësuesja jonë!

** Mësuese e Shkollës "Demir Gashi"*

Meleq Kaloshi, njeriu **dinjitoz e fisnik** në diktaturë dhe demokraci



Lamtumirë Meleq! Vetëm pak ditë më parë u ndave nga ne për të fluturuar drejt një bote tjetër miku im, drejt një bote të panjohur.

Një ikje pa kthim nga një jetë që mizorisht u tregua e pamëshirshme me ty. Një jetë e filluar nëpër kampe përqendrimi, të ngjashme me ato të nazistëve, teksa, diku, jashtë kufijve tanë, i këputej jeta në mes, në pranverën e saj, babait Dan Kaloshit, heroit legjendar të Brigadës së Pestë, tmerrit të pushtuesve nazifashistë. Vetëm se e donte jetën, familjen, lirinë e Shqipërinë.

Eh miku im! Errësira e qetësia vdekjeprurese e fushave të përqendrimit shthureshin nga gjallëria e zërat e tua të hareshëm, që nuk donin t'ia dinin për ferrin ku ju kishin zhytur. Jeta vazhdonte. Si një zog i ndrojtur, por këmbëngulës, ëndërroje e kërkoje ajrin e lirisë. Më pas, si një zgalem i turreshe qiejve të lirisë.

Dibranët e tu të admironin gjer në kufinjtë e mitit. Finesa, eleganca, krenaria e guximi ishin disa nga vitytet që Perëndia ti kish dhuruar me bujari. Por monstrat e kohës së diktaturës nuk e duronin shkëlqimin tënd. I verbonte drita rrezëllitëse që përhapte trupi e shpirti yt... Ato ta penguan vrapimin, ti vranë ëndrrat rinore, ta vodhën edhe dashurinë. Por nuk ti përthyen dot flatrat.

Ti vazhdove fluturimin pa e kthyer kokën pas, pa u përkulur, pa u deformuar. Dhe së fundi e përjetove flladin e lirisë që të kish munguar për afro gjysmë shekulli.

Aroma e lirisë nuk të dehu dhe ti nuk abuzove me të. Ty nuk të morën peng instiktet e vetëmburrjes, të urrejtjes e hakmarrjes. Engjëjt e dritës triumfuan mbi demonët e errësirës. Fisnik e dinjitoz në diktaturë, fisnik e dinjitoz në demokraci. Një model i papërsëritshëm!

Dhe befas na ike, duke na lënë të zhytur në trishtim e dhimbje. E ne nuk të thamë dot lamtumirë! Lagështia e dheut dhe errësira nuk mund të ndalin kujtimet për ty, ndaj s'të themi prapë lamtumirë se do të shihemi përsëri. Shpejt a vonë do vijmë edhe ne aty, të takohemi e të çmallemi me ty!

Lavderim SHEHU

Pavdekësía

(Prof. Mahmud Hysës)

Ç'paska sot kjo Dibra Jote
Që me gojë fare nuk flet?
Të përcolli burrë me nam
Të shtrirë e symbyllur po të pret!

Letërsinë e vjetër shqiptare
Na e mësove me zell e dashuri
Priftërinj, dhaskalë e bejtexhi
I bëre tok në Krestomaci

Pal Engjëlli e Dhaskal Todri
Barleti, Budi e Variboba
Bogdani, Çami, Bardhi e Nezimi
Kuvendonin shtruar te Voskopoja

Ligjërimet përplot ëmbëlsi
Vendosmëria e burrave të motit
Librat e brumosur me urtësi
Të japin jetë në PAVDEKËSI

Bedri TAHIRI

Galicë, 18 mars 2016

reklamë

Klinika Mjekësore
"VENIS"



KLINIKA MJEKËSORE "VENIS",

e ka nisur aktivitetin e saj në fillim të vitit 2007, me nismën e Dr.Sadik H.Lala. **Klinika mjekësore "VENIS"** është klinika e parë private e Shëndetit Mendor në Shqipëri, e licencuar nga Ministria e Shëndetësisë, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) si një aktivitet i tatueshëm. Fillimisht aktiviteti i saj nisi si një klinikë me shtretër, në të cilën kryheshin të gjitha aktivitetet, shtrime në klinikë, ekzaminime, vizita dhe konsulta etj. Aktualisht aktiviteti i ynë është shërbim ambulator gjithëpërfshirës në fushën e shëndetit mendor, Qendër edukimi dhe informimi mbi të drejtat e pacientëve duke reflektuar më së miri eksperiencën dhe orientimet më bashkëkohore në këtë fushë, bazuar në ligjin e shëndetit mendor te shtetit shqiptar. Në klinikën "VENIS" ofrohet një shërbim i standarteve bashkëkohore si përsa i përket diagnostikimit dhe opsioneve të trajtimit mjekësor jo vetem me skemat e mjekimeve më të reja me barna por dhe me aplikimin e terapisë biologjike të elektrokonvulsoterapise ECT-Thymatron IV (Teknologjia më bashkëkohore), për trajtimin e pacientëve, te të cilët trajtimi i mëparshëm me barna nuk ka dhënë rezultatet e duhura.

ECT Thymatron IV është shërbim i çertifikuar sipas normave ndërkombëtare me ISO 13485 me çertificatën CMDCAS nga Somatics, LLC. Terapia me ECT si një shërbim i avancuar i klinikës tonë, e sanksionuar edhe në Ligjin e ri të Shëndetit Mendor Shqiptar (Prill 2012).

1. DIAGNOSTIKIM

Procesi i diagnostikimit të çrregullimeve psikologjike apo psikiatrike realizohet pas një ekzaminimi të kujdesshëm nga specialistët e shëndetit mendor të cilët janë psikiatrit ose psikologët klinikë. Qendra jonë ka për qëllim që t`i ofrojë popullatës, pacientëve, individëve dhe familjarëve, ndihmë sa më profesionale si dhe mbështetje të gjithanëshme psikologjike profesionale në trajtimin e çrregullieve të të gjitha llojeve, duke respektuar gjithnjë dallimet kulturore dhe duke mos u ndikuar nga statusi social i individëve që kanë nevojë për shërbimin tonë.

2. TRAJTIM I DEPRESIONEVE REZISTENTE

Në veçori e punës në klinikën tonë është trajtimi i depresioneve dhe psikozave rezistente ndaj trajtimit me barna. Procedura e ECT-së është një procedurë që realizohet vetëm në klinikën "VENIS" në Shqipëri dhe në trojet e tjera shqiptare. Trajtimi me Thymatron është varianti më bashkëkohor i terapisë së ECT-së që ekziston sot në të gjitha vendet e zhvilluara. Për informacione më të detajuara apo formularët përkatës informohuni në rubrikën përkatës në këtë faqe ose mund të kontaktoni në adresën e e-mail-it ose në numrat e kontaktit.

Mos kini paragjykime!
Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

Nga anketimet e bëra nga OBSH-ja në Shqipëri, afro 75 % e të intervistuarve shqiptarë shprehen se problemet nga të cilat shqiptarët preken më shumë janë janë STRESI ANKTHI dhe DEPRESIONI por edhe nga komplikimet e përdorimit të ALKOOLIT.

3. TRAJTIM MJEKËSOR

Në klinikët tonë ruhet privatësia e individit, respektohen dhe mirëkuptohen orientimi seksual, përkatësia etnike, gjinore, apo preferencat fetare. Kompetenca profesionale dhe kulturore e stafit dhe stili i komunikimit, përbën bazën e suksesit tonë modest në punën tonë, për të ruajtur një shërbim cilësor profesional, strategji bashkëkohore mjekimi me barna dhe mbështetje morale, duke promovuar kështu bazat e forta dinjitetit, mirëqënjes shpirtërore dhe në rritjen e besimit në mbështetjen dhe bashkëpunimin tonë reciprok.

4. KONSULENCË PROFESIONALE LIGJORE

Klinika mjekësore "VENIS" ju ofron informim dhe ndihmë konkrete ligjore mbi të drejtat e pacientëve, si psh, mbrojtje profesionale ligjore për të drejtat e personave me çrregullimeve mendore, pacientët që kanë probleme me ligjin apo për personat që sëmuren gjatë periudhës së vuajtjes së dënimeve ligjore apo gjatë pritjes së marrjes së vendimit, si dhe ju ofron orientimet dhe konsulencën e duhur për respektimin e të drejtave ligjore të pacientit bazuar në aktet ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare. Qendra e Shëndetit Mendor "VENIS" dhe stafi është i angazhuar në respektimin e të gjitha të drejtave që rrjedhin nga aktet ndërkombëtare, si p.sh., Deklarata e Lisbonës, Ligji mbi Shëndetin mendor, etj.

MOS KINI PARAGJYKIME!

Sa më herët të kërkohet ndihma e specializuar, aq më shpejt trajtohen çrregullimet e çdo lloji.

Për këdo është e dhimbshme dhe traumatike kur konstaton se ai vetë ose një i afërm vuan nga ndonjë sëmundje. Në fushën e mjekësisë se përgjithshme problem i informimit është më I thjeshtë se ka analiza dhe ekzaminime specifike që të orientojnë drejt dhe shpejt në në kohë në drejtim të diagnozës. Në sferën e shëndetit mendor numri i ekzaminimeve specifike si ato laboratorike dhe ekzaminuese është shumë më i kufizuar. Shumë çrregullime fillojnë me simptoma të përgjithshme si ankth, pagjumësi dhimbje etj të cilat nuk janë karakteristikë tipike e ndonjë sëmundje të vecantë. Na qëllon shpesh që shumë persona vijnë te psikiatri pasi kanë bërë një pafundësi analizash e vizitash që nga mjeku I familjes te gastrologu, te kardiologu etj, ndërkohë që një ekzaminim I kujdesshëm nga mjeku psikiatër konstaton thjesht një çrregullim ankthi të trajtueshëm pa problem. Konstatimi në kohë ka të bëjë shumë dhe me mbarëvajtjen e trajtimit mjekësor dhe evitimin e abuzimit të mundshëm të barnave të marrë krejt pakriter veçanerisht të qetësuesve të cilët kanë një potencial të lartë për varësi. Akoma më i rëndë bëhet situate dhe mosfunksionimi i mirë i individit për ata që kanë me probleme të rënda të shëndetit mendor , të cilat duke shtuar dhe mungesën e njohurive në këtë fushë, e bëjnë gjëndjen edhe më dramatike. Çrregullimet e këtij lloji nuk kanë analiza specifike për tu diagnostikuar, vetëm komunikimi me specialistin përkatës ju mundëson diagnozë të saktë dhe ndihmën e duhur në kohë. Në jetën e përditëshme mund të na qëllojë që të jemi anksiozë,të mos na zërë gjumi të irritohemi por kur kjo gjëndje rëndohet dhe komplikohet me simptoma të tjera dhe na pengon në punën tonë vetem atëherë drejtohemi tek mjeku. Familjarët tanë shqetësohen, në raste më ekstreme shokohen nga e papritura e sjelljeve të çuditshme dhe kërkojnë me ngulm shpjegime për gjëra që nuk i dinë ,për gjëra që mund ti dinin, po të kishin qënë më të informuar, ose po të kishin komunikuar në kohën e duhur me specialistët e shëndetit mendor.

Shoqëria shqiptare, në tranzicionin e saj zgjatur dhe të dhimbshëm përsëri manifeston forcën vitale për të përballuar sfidat e jetës, por fatkeqësisht në shoqërinë tonë ka akoma "turp" dhe paragjykime për problemet e shëndetit mendor. **Nga anketimet e bëra nga OBSH-ja në Shqipëri, afro 75 % e të intervistuarve shqiptarë shprehen se problemet nga të cilat shqiptarët preken më shumë janë janë STRESI ANKTHI dhe DEPRESIONI por edhe nga komplikimet e përdorimit të ALKOOLIT.**

"Venis" ju ofron mbështetjen e duhur. Klinika ofron shërbimet e saj vetëm në ditët e javës
Orari: 08:00 - 16:00 E Shtunë, E Diel dhe Festat zyrtare: PUSHIM

Vizitat kryhen me planifikim paraprak.

Kontakt: Sekretaria: **04 2400 669** dhe **068 23 96287** E-mail: **sadikhlala@gmail.com**